

BIBLIOTEKA

BBH-32
P55

HASAN M. PETRELA



NE MESHIREN
E NJEREZVE
(NOVELE)

TIRANE 1959

8SH-32
P55

HASAN M. PETRELA

BIBLIOTEKA E SHIETIT
GJEROKASTER 26390

SHËNIMI MË DOKTORIN N. SH. BOTIMEVË NËN KOMUNISTËN
PËR PËRSHPEJTËSH TË PËRSHPEJTOHET NË KËTË LIBRI

NË MËSHIRËN E NJERËZVE

(NOVELË)



3003

N.Sh. Botimeve «Naim Frashëri»

TIRANË, 1959



HASAN PETRELA

Shkrimtari i ri HASAN PETRELA lindi në Tiranë, në vitin 1927. Rrjedh nga një shtresë e varfër fshatare. Fëmininë ai e kaloi në varfëri, aq sa u detyrua të lejë shkollën fillore për të siguruar kafshatën e gojës, duke punuar si shegert, etj.

Gjatë luftës nacional çlirimtare ai u pranua në rininë komuniste. Mori pjesë në radhët e ushtrisë nacional çlirimtare. Është dekoruar me medaljen e Kujimit, të Trimërisë dhe të Çlirimit.

Në vitin 1955 mbaroi Institutin e Lartë Pedagogjik katër vjeçar (fakultetin e historisë). Qysh nga viti 1949 punon si gazetar.

Aktivitetin letrar e filloi në vitin 1947-1948. Në fillim ai botoi skica të vogla — përshkrime, pastaj tregime nga e kaluara dhe realiteti i kohë së sotme. Në vitin 1955 ai fitoi çmimin e dytë në konkursin e shpallur nga komiteti qëndror i rinisë.

Vepra më serioze e tij është novela: «Në mëshirën e njerëzve» që fitoi çmimin e tretë në konkursin e shpallur me rastin e dyzet vjetorit të revolucionit socialist të Tëtorit.

*Shokëve të vegjëlisë me të
cili ët ndava kafshatën e gojës,
me dashuri.*

Autori

I

Thonë se jeta është këngë. Por ka këngë gjëzimi dhe këngë hidhërimi. Disa jetën e kanë kaluar në qetësi e në rehati të plotë, ca të tjerë kanë vuajtur e hequr shumë, si krimbi ndën gur.

Po unë? E kush jam unë? A vlen që unë tu tregoj se si jetuam ne, (në u quajtë të jeteuar), si e kaluam rimi-në tonë (në u quajtë rini!).

Unë mendoj po, vlen. Unë do të tregoj vetëm ato gjëra që kam parë ose dëgjuar vetë, pa u shtuar asnje presje, pa u bërë asnje zbukurim.

II

Më vjen më mbarë ta nis nga shkolla. Ndërtesa e shkollës sonë ish me tulla të kuqe, të pabojatisura. Ajo gjëndej në lindje të Tiranës, përballë një ëmbëltoreje të vogël. Tek kjo ëmbëltore ne shpesh herë blenim kallama sheqeri të kuq, e i zoti i saj, një lumjan me trup të madh, që mbante çidikë të ngushta, na hiqte prej veshi kur kujtonte se po e hutonim për t'i vjedhur ndonjë gjel she-

qeri. Po kur i tregonim greshin, ai na përkëdhelte dhe na ledhatonte...

Në atë shkollë unë kalova plot katër vjet. Vitin e pestë s'e krevat dot.

Ishte ditë prilli, ditë e bukur dhe e ngrohtë. Po vra-poja pas një fluture, kur më lajmëruan se im atë, usta, ish rrëzuar nga çatia e një ndërtese. Nxitova për në shtëpi. Atje kish plasur poterja. Nëna s'dij ku kish vajtur, ndërsa unë, si djali më i madh, u turra nëpër rrugët e qytetit. Ku ta gjëja babanë?...

Kur u ktheva në shtëpi, atë e kishin shtrirë në hajat; ish fare i zbetë. Nëna lutej me lot ndër sy që ta çonin në spital, kurse babaj lëvizte vetëm vetullat në shenjë kundërshtimi.

Më vonë, në vizitën që iu bë, mjeku tha se i janë thyer tre fije brinjë dhe këmba e djathët i është dërmuar fare... Në këto rrethana pra, u përcaktua edhe fati im. U vendos që të lija shkollën për t'u pajtuar shërbëtor!... Ahere isha 12 vjeç...

II

Nëna erdhi në shkollë dhe bisedoi me drejtorin që të më çrrëgjistronin përgjithmonë.

— Si? — pyeti drejtori me habi.

— Nga halli, zoti drejtor! — tha nëna.

— Më dhimset ky djalë! — foli drejtori pas pak, i kredhur në menjtime. — Me mësimet ka shkuar gjithmonë mirë: është ca çapkën, po prap seprap kisha besim tek ky. Pastaj më duket si e tepërt që ta pajtoni yzmeqar qysh: në këtë moshë!...

Fjalët e tjera të drejtorit nuk i ndëgjova më. Syt m'u errësuan; më vinte për të qarë kur mendoja se do të isha shërbëtor dhe se do të ndahesha nga shkolla, nga librat dhe nga shokët e mij të dashur!...

Drejtori më vështroi përmes xhamave të syzave dhe më tha si një prind:

— Përpiku të bëhesh djalë i mirë. Nuk je vetëm ti që po e braktis shkollën; si ti ka me qindra!

Unë dhe nëna s'thamë gjysëm fjale, po ikën ngadalë, si fshehurazi, sikur të kishim bërë ndonjë faj. Kur u lar-guam, e ktheva përsëri kokën nga shkolla dhe i thashë-asaj: lamtumirë, shkollë e dashur, lamtumirë përgjith-monë!...

III

Të nesërmen më paraqitën tek zotnia që do t'i shër-beja. Ai ishte pasticier, një burrë i shkurtër, po trashaman, më ca sy si të maces; sapo hymë, më hodhi një vështrim hetonjës. Pastaj duke më ardhur rrötull, filloi të flasë me një zë të trashë basi:

— Duket se është pak inatçi, fëmi, ë? !...

Nëna buzëqeshi dhe e pyeti:

— Po ku e kuptoni ju?

— Tek flokët, ja, këtu mbi ballë, flokët e tij formojnë një tufë me qime t'ashpra. Të tillë njerëz janë kockë-fortë...

Mu duk se pasticieri kish pirë se i qelbej goja.

— Sepse njerzit, — vazhdoi ai, — janë si kafshët. Ka kafshë të buta dhe t'egra. Për shëmbëll ka kuaj të butë e kuaj të egër. Kështu ngjet edhe me njerëzit. Nejse, në qoftë inatçi, tamthat e veta do të pëlcasë! Unë dua që me myshteritë të sillet urtë e butë, të mos ketë dorë, (këtu ai e preu fjalen dhe m'i nguli ato syt e tij të vegjël në një ményrë të tillë që më frikësuani)... se dora është vesi më i poshtër që mund të ketë njeriu...

— Sa për atë!... — ndërhyjni nëna.

— Nuk thashë se është i tillë, po gjërat t'i bisedojmë qysh tani, më mirë. Ja, kapedan, ky është dyqani im; atje tej, pas perdes është kuzhina ku bëjmë pastat; atje ti do të kesh mjaft punë. Do të mësosh zanat, e atëherë, mbasë do të bëhesh edhe ti, si të them, esnaf!

Ai e tërroqi nënën më një anë e i tha diçka në vesh, pastaj u avit tek unë e më foli me zërin e tij të vrazhdë: — Puna këtu është orar pa orar; do të të takojë të punosh 10 orë, por ka ditë, sidomos në raste festash, kur do të punosh edhe 14 orë rrësht. Paratë do t'ja dorëzoj nënës krye çdo jave. Tani, kapedan, eja me mua, në guzhinë, përtë filluar punën. Ç'ke që je kaq i dëshpëruar? . . .

Nëna vuri dorën e sajë mbi supin tim dhe më tha si me lutje: shko bir, fillojë punën. . .

Unë vajta në guzhinë. Guzhina ishte e vogël, si një köridor i ngushtë. Në të djathtë ishin dy a tre kazane të mëdhej.

— Këtu nuk do të jesh vetëm, — më tha ustaj — unë kam edhe një cirak tjetër, po tani për tani ai nuk vjen në punë. . .

Dësha ta pyes përsë ai nuk vinte në punë tani për tani, po ustaj m'a preu: — shiko, kapedan: merre këtë pecen dhe fillo e pastro kazanet. Si të mbarosh, më lajnëro. —

E mora pecen në dorë dhe fillova të pastroj kazanet. Kuzhina m'u dukte si varr. Një erë e qelbur, një erë e rëndë guzhine më bënte gati të villojë. Po më mbante shpresa se shpejt do të mësohesha me këtë erë të keqe.

Si i pastrova kazanet, ustaj më tha: — Dëgjo, kapedan, mua nuk më pëlqen të më thërrasin as zotni, as usta. Më thirr me emër. Më quajnë Mehmet. Kështu, pra. Tani me që s'ke më punë, eja të më fërkosh pak shpatullat. Jam i dërmuar nga lodhja. . . Shko dhe ule qepenin se ora vajti 12.

Unë ula qepenin ndërsa ai vajti e u shtri në guzhinë, mbi një krevat me susta. Në fillim atë njeri e doja, sepse duke më marrë në punë më bëri një nder të madhe, po më vonë e mora inat. Kur e fërkonja, duart e mijë të vogla zhyteshin në trupin e tij gjithë tul, e ai i pushtuar nga kënaqësija, rënkonte si një derr. E fërkoja një kohë të gjatë e ai s'më thosh mjaft se u lodhe.

— Ja, shikoje dhe vetë, — ankohej orë e çast, — punë s'ka, mungon paraja, ka krizë, qesatillëk... Kurse ti, në krye të javës do rrögën. Zoti e di se si do të mbarojmë!...

Unë doja të dija, cili ishte ai tjetri që punonte në dyqan. Këtë gjë e mësova, por pas tri ditësh, kur bëfas u fut në kuzhinë një djalë me dorë të lindhur. Më buzëqeshi me dashuri, dhe kur ustaj iku, filluan një bisedë të përzémërt. E quanin Jusuf, ishte nga Peshkopja, kish të ditë që s'punonte, mbasi i qe derdhur kazani me ujë të nxehjtë e i kish përvëluar dorën e djathëtë dhe pothuaj se tërë këmbën e majtë. Po megjithëkëtë, edhe gjatë këtyre ditëve, ustaj nuk e kish lënë rehat: i kish dhënë një dhi race për ta kullotur.

— Ustaj më tha se vjen nga shkolla, ë? — më pyeti Jusufi.

— Po, vij nga shkolla.

— Të pëlqente shkolla?

— Shumë!

— Kurse mua aspak. Ku ka si zanati! Njeriu mëson një zanat dhe për 10 vjet bëhet usta.

— Sa kohë ke që punon këtu?

— Shtatë vjet.

— Domethënë edhe tre vjet ti bëhe usta, ë?

Jusufi më vështroi me dyshim dhe tha duke tundur kokën si i pa kënaqur:

— Që të bëhesh usta, duhet kapital, kurse mua kapitali më mungon.

— Po ke shtatë vjet që punon, ti duhet të kesh ruajtur para!...

— Eh, more vëlla! Kësaj i thonë shtatë vjet në kurbet, — një verë në det!... Kur më mori në fillim isha 14 vjeç. Aherë më qe zotuar se do të më bënte djalë të shpirtit, se do të më martonte se do të më jepte rrrogë të mirë. Kjo gjë mua më leverdiste se isha jetim...

Isufi lëpiu buzët dhe ra në mejtime.

Po e keqja më e madhe ishte se ustaj i kish mësuar ca vese shumë të këqia: Isufi fliste shumë për femra, ish tinzar, mburrej se dinte çdo gjë; mua më shiste mendje, kurse përpara ustajt ishte në gjëndje të bënte çdo poshtërsi. Një ditë erdhi në dyqan një vajzë e re, me çarçaf; ustaj na bëri shenj që të futeshim në guzhinë. Q'andej në pamë se si ustaj i sillej me urtësi e përkëdhelje, i mbushi një qeskë me bombona dhe filloi ta vështrojë plot zjarr. Vajza, një syzezë dhe faqekuqe, nxori paratë, po ustaj i tha: — Mbai, o xhan, ato i ke peshqesh nga unë...

— S'ke turp që flet kështu?! — tingëlloi zëri i zëmëruar i vajzës dhe pamë që bombonat u shpërndanë mbi xhamin e banakut.

— Prisni, mos u zëmëroni, unë...

— Maskara! — e ndërpreu ajo. — Je dhe burrë i nartuar!...

Ustaj ngriu në vënd. Vajza iku dhe ne dolëm nga guzhina, si për ta ngushulluar ustanë.

— Po ju?! — na bërtiti me një zë të vrazhdë. — Pastaj duke i lëshuar krahët t'i varen poshtë, foli me një ton të dëshpëruar:

— A e patë ç'kurvë që është? Unë e njoh, e njoh mirlë atë... C'e do! Më mori erzin kurva...

Befas syt'e tij flakruan. — Shiko — i tha Isufit me një etje ujku — do të të jap pesë lekë sikur ta kapësh në udhë ta shash, ta poshtrosh...

— Po sikur të thërrasë?

— Hajde, mos kij frikë, më ke mua.

Isufi vrapi pas vajzës. I vajti pranë e i ra me bryl, pastaj i shkeli synë. Vajza e shtyu. Edhe ai e shtyu. Ajo desh të largohej, po ai e shau.

Ustaj kish dalë në mes të rrugës, dhe me duart e vëna në vithet e kërcyera, qeshte me gjithë shpirt. Atëhere dolën në udhë edhe tregtarë të tjerë, dhe e mjera vajzë u gjënd ngushtë. Uli kokën e ja shkrepit të qarit, pa ditur ç'të bëjë. Dikush ndërhyri për ta qetësuar atë, po ustaj vrapi e i tha:

— Ty ç'të duhet?... Le të vrasin veten po të duan, ajo éshtë vajzë rrugash.

— Ashtu? — pyeti si me çudi një burrë me gjyslykë.

— Po, po, e njoh unë, éshtë kurvë me patentë... — vijoi ustaj.

Ustaj po çpifte me paturpësinë më të madhe. Fytyra e tij gjithë tul, kish marrë shprehje gjëzimi. Ato sytë e tij të vegjël lëviznin gjithë lezet, ndërsa grushtet i kish mbledhur shuk, dhe i entuziasmuar nga suksesi, i përplaste shpesh herë njerin mbi tjetrin, pa ditur se ç'bënte.

Kur erdhi Isufi, ustaj i buzëqeshi me djallëzi dhe i rrahu supet në shenjë mirënjoheje. Pastaj i tha, duke e shikuar shtrembët me ato sytë e tij të vegjël:

— Duhej t'ja kiske ngritur çarçafin që t'i dukeshin shalët...

— Po edhe aq sa bëra qe mjaft!...

— Po jo për pesë lekë ama!... — dhe mbylli njerin sy.

Isufi heshti.

— Nejse, për të marrë të kesh tek unë, — i tha ustaj dhe u fut në kuzhinë. Pas tij vajtëm dhe ne, dhe filluan punën. Unë mbushja kazanet me ujë, Isufi thyente vezë dhe të bardhën e tyre e hidhëtë në një tas të madh, dhe pastaj fillonte dhe e rrihëtë deri sa e bënte shuk, si top dëbore.

Mua s'më hiqej nga mendja ngjarja me vajzën. Doja ta pyesja Isufin përsë e bëri të qajë atë vajzën e mjerë,

po meqë ustaj rrinte aty, nuk kisha mundësi ta hap këtë bisedë

Ustaj si u lodh duke ngjeshur brumët e pastave, tha befas:

— Po dal pak, se më dhëmb koka. Ju vazhdoni punën. Po tu lodh dora, Isuf, jepja këtij. Le të mësohet edhe ky të rrahë vezë...

Ustaj dolli, dhe unë e pyeta Isufin:

— Pse u solle ashtu me atë vajzën?

Ai e ktheu kokën nga unë dhe tha, duke i rënë ballit me shuplakë:

— Pse? Sepse jam i poshtër, po, jam i poshtër. Më njyen pesë lekët që s'mi dha!

Pështyu me inat dhe vijoi:

— Sa herë ma ka punuar kështu, aq të mira qofshin!

— Largohu më mirë! — e këshillova.

— E ku të vete? Të gjithë ustallarët janë si ky, bile më të këqinj. Të paktën me këtë jam mësuar.

Pa më shikuar, duke vazhduar të rrahë vezë, thoshte ngadalë:

— Po edhe ustaj s'i ka mirë punët. Kohët e fundit i ka hypur shumë rakia. Ka pesë fëmijë në shtëpi dhe s'pyet fare për ta. A e pe? Kërkon vajza, gra të huaja. Dhe më ngatërron kot së koti me punë të tilla!...

Heshti dhe pastaj vijoi të më fliste për gjëra të thella duke kujtuar se unë i dija të gjitha të fshehat e kësaj bote: — Kështu është kjo botë, more vëlla. Dikush e ka të mirën e dikush jo. Unë, për shëmbull, të kisha një grua që të më donte, do t'i falja zemrën, po ja se grata nuk më duan. I shëmtuar nuk jam, po paraja vendos. Të kisha një dyqan të vogël, ti bëja nja 10 napolona, dhe me 10 napolona gjëja vajzën më të bukur të Tiranës!...

Sytë e tij ndizeshin nga një afsh i zjarrtë, i brëndshëm. Ishte shumë-shumë 20 vjeç, kishte trup të gjatë dhe një fytyrë të lezetëshme; flokë-verdhë, sy-larush, hunda i vinte pak me majë.

Si pa gjë të keq, nisi të këndojë, me një zë të ëmbël
prej tenori:

«As ma fal, moj, dashurinë;
zemra ime se ç'u dogj...»

Kur këndonte, kokën e ngrinte përpjetë si rosak, sytë i mbyllte përgjysëm dhe dukej sikur shkrihej i téri. Ky ishte një nga ata qindra të rinj të dëshëruar për të pasur një dashnore...

* * *

Ustaj u kthye i bërë tapë. Sytë i ishin futur edhe ca më thellë, buzët i qenë shtrëmbëuar, goja i qelbej dhe fjalët i delnin me zor, sikur i hiqte zvarë:

— Shikon, djem, ejani uluni këtu, — ti je fëmi, — më thosh mua, — ti Isuf, më dëgjo. Ja, tani që piva, koka s'më dhemb më dhe trupin e kam si fildish. Rakinë e ka falë zoti. Bixhozi është i keq. Bixhozi të qit në diell, o vëlla, Isuf, mos luaj bixhoz. Të këshilloj si babë. Raki pi, bixhoz mos luaj. È? Si thua?

Isufi tundte kokën. Ustaj kalonte kodër më kodër: — Folë, Isuf, a ke ndonjë ankesë prej meje? Jemi njerëz, dreqi e di, ndoshta na takon të vdesim tak fap, duke ecur, por mua nuk më pëlqen të shkoj në varr borxhli, nuk dua që atje të jap hesap përpara teje.

Lëpinte buzët, thithte cigaren, ndizëj flakë dhe thosh duke pështyrë në tokë:

— E ku dini ju ç'ështëjeta! Kam qenë shumë i prapë, ku s'kam vajtur unë për të jetuar? aQark i kam rënë dynjasë, kam qenë në Stamboll, në Selanik, në Manastir dhe në Bosnjë. Në Selanik sharrova pas një gruaje të ve, po ika se atje ka shumë çifutër dhe është zor të bësh prokopi; është si në Kavajë... — Ti, — mu drejtua mua, — shko dhe vështro punën, qafir, kush të tha të dëgjosh bisedën tonë? Isufin e kam si ortak, kurse ti je çirak; hala s'ke kalbur shpërganjët...

Vija re se Isufin e gëzonin këto fjalë. I pëlqente të mburrej, të tregohej pérpara meje se gjoja ish zëvëndës i ustajt, me qëllim që mua të më kish gjithmonë nën urdhëra. Po unë kisha vëndosur, se në këtë dyqan nuk mund të shkoja gjatë. S'më pëlqente as puna, as njerzit. Ajo era e qelbur e peces që pastroja kazanet më mundonte tepër, kurse ustaj më neveritej gjithnjë më shumë. Isufin e mora inat qysh nga ngjarja me vajzën.

Ata më dukeshin njerëz të çuditshëm, njerëz që unë nuk mund t'i kuptoja. Vrisja mendjen me veten time, përsë në mes të babajt tim dhe ustajt kish një ndryshim kaq të madh. Babaj ish njeri që mendonte krejt ndryshe nga ustaj. Kurrë nuk e kisha dëgjuar të fliste keq për njerzit, të ankohej makar edhe për jetën që ish aqë e egër për të; kish mbetur sakat përgjithmonë, pa asnje të ardhur, me dy fëmijë në shtëpi (unë dhe motra) dhe nëna ime e dashur që tani ka filluar të punojë edhe ajo si rrobalarëse nëpër familjet e pasanikëve.

Mua më pëlqente të bridhja rrugëve, të shkoja në pyll ose tek Ura e Brrarit dhe atje, të shihja peshqit e vegjël duke kërcyer gjith gaz, ose të dëgjoja kukuakut e bret-kocave; të gjitha këto ma përkëdhelnin shpirtin.

Shpesh herë takonte që ustaj, duke vënë re se unë ëndërroja ashtu më këmbë, më thosh me një zë të butë: — Ti s'je për çirak, o kapedan. Ty të pëlqeijnë më shumë shejtanllëqet. Unë e dij se çfarë mendon ti tanë. Ta them? Të kesh një llastik dhe të dalësh për gjah, ose të kesh një paqetë cigare dhe t'u japësh shokëve cigare, duke i vënë në provë pale kush e thith më shumë tymin e duhanit!...

Në fjalët e tij kishte diçka të vërtetë. Po unë nuk i thoja gjysëm fjalë atij, sepse kisha frikë mos më dëbonë nga puna.

Disa herë kisha vendosur të bëhesha llustraxhi ose hamall, por përsëri hiqja dorë, pasi puna e hamallit lypte fuqi, dhe se llustraxhi kish aqë shumë, sa endeshin gjithë ditën pa punë si «qej kasapësh», siç thosh ustaj. Po përpiqesha që pérpara se të largohesha nga ai, të gjeja ndonjë punë tjetër sa për të mos mbetur udhëve.

IV

Ustaj kish një mik të ngushtë: ky ishte xhandari Veli Hajdari, një burrë i gjatë dhe i hollë, me fytyrë gjithmonë të ngrysur. Në dyqan vinte gati' çdo ditë, dhe futesh me ustanë në guzhinë ku bisedonin orë të tëra, kushedi se për çfarë.

Kur unë, për një arsy e ose një tjetër, hyja në guzhinë, ai shpesh e ndërpriste bisedën dhe më vështronë duke u munduar t'i jap fytyrës një pamje edhe më të rreptë. Në fillim unë e pata shumë frikë këtë «gushëkuq», po pastaj fillova të mësohem me të, ashtu si u mësova me ustanë, me Isufin e me të tjerët.

Kur më thosh «e di vetë ti» unë nënkuptoja se Veliu donte çaj me limon, ndërsa kur donte kafe, më thosh: — një sade.

Ky njeri për shumë gjëra fliste me një gjuhë të tijë që vetëm ata që e njihnin e kuptionin.

— Sot, — i thosh një ditë ustajt, — sollën në karakoll një penkuq që kish qëlluar me pëllëmbë një tregëtar, e t'i kemi hequr një dru që s'do ta harrojë kurrë!

— Ç'është penkuqi? — e pyeta unë.

Veliu më shikoi me ato sytë e tij si sy qeni, dhe më tha, duke më pickuar llapën e veshit:

— Tjetër herë mos të pyesësh për gjëra që s'të përkasin, more vesh?

— Po.

— Jo po, por si urdhëron të thuash. Kësaj here po ta tregoj se çdo të thotë penkuq: penkuq i thonë jevgut. More vesh?

— Po.

— Jo, po, por si urdhëron, qen misri! More vesh?!

— Si urdhëron...

— Kështu pra!

Veliu disa herë vishej civil. Në dimër mbante një pallto të madhe, këpucët i fuste në galloshe dhe ecte sikur

shkelte mbi vezë; në verë vishtë një xhaketë kafe, me mën-gët pak të shkurtëra për krahët e tij të gjatë.

Ustaj thosh se Veliu jetonte keq. Rroga s'i mjaftonte me që kish gjashtë fëmijë në ngarkim, dhe veç kësaj i pël-qente ta njomte gërmazin me një gotë raki çdo mbrëmje.

— A ke ndonjë meze të mirë sonte? — e pyeste ustanë.

Ustaj, po të ndodhej në orë të mira, më dërgonte mua tek kasapi pér të blerë mëlçi dhe zemër, pastaj vetë ai i pastronte, shkonte në furrë dhe i pikte me kujdes. Në darkë ja shtronin në guzhinë dhe rrinin duke u fjalosur gjer vonë.

Njeri nga ne, unë ose Isufi, duhej të rrinte aty, në dyqan, gjer sa ata të mbaronin së piri. Kur delnin, e mbanin shëshoqin pér krahu; ustaj më jepte urdhër ta mbyllja mirë qepenin, dhe kur unë ikja, ai ulej dhe e kontrollonte përsëri me dorën e tij.

Më vonë mora vesh se Veliu kish marrëdhënje financiare me ustanë. Ustaj i blente rogën Veliut, me një përqindje fitimi.

— Xhandarët i shesin rrogat, — më thosh Isufi në vesh.

— Po pse?

— Sepse ua paguajnë një herë në tre katër muaj... kurse ata kanë nevojë qdo ditë pér pare.

S'e kuptoja cili ish shkaku i vërtetë që atyre ua paguanin rrogën një herë në tre katër muaj.

Kur Veliu nuk vinte pér 5-6 ditë (kjo ngjiste shumë rrallë) ditën e enjte paraqitej tek ustaj e shoqja e Veliut, një grua e hollë dhe pa dhëmbë, dhe ustaj i jepte një dollar, ose ja merrte trajsen dhe shkonte tek millshitësi pér të blerë 15-20 kg. miell misri.

Një ditë, Veliu erdhi vet'i dyti. Shoku i tij ish një tetar i shkurtër, qimezi, me buzë të trasha si afrikan. Siç biseduam me ustanë, ky nxori portofolin dhe i dha tetarit dy napolona. Tetari nënshkroi një diftesë, të cilën ustaj e palosi dhe e futi në portofol. Kur tetari u largua, Veliu buzëqeshi me djallëzi dhe i tha ustajt:

2619
BIBLIOTEKA
3093
SHTETI

— Po të isha në vëndin tënd, do të mirreshia yetem me fajde. Dhe nuk do të përzihesha me asnje njeri tjetër, veçse me xendarët.

— S'është keq, — buzëqeshi edhe ustaj, — mund ta fillojmë një punë të tillë.

Kështu, qysh nga ajo ditë, ustaj im u bë, si të thuash llogaritari i xendarëve. S'kish ditë që të mos vinin tre katër xendarë të dërguar nga njeri tjetri për të lënë peng rrrogat e tyre. Shumë prej tyre ishin pijanecë, goja u qelbej erë raki, hudhra e qepë, po ustaj as që i vinte re këto. Ai u merrte me kujdes diftesat. Në çdo 3-4 muaj, paraqitej në qark-komandë dhe kundrejt dëftesave mbledhë të hollat.

Veliu vinte më dendur në dyqan dhe sa herë që vin-te, gjithmonë sillte lajme të ndryshme, lajme të hidhura, trishtuese.

— Sot në mëngjez gjetëm një djalë të ri që kish varur vëten.

— Pse? — pyeste me habi ustaj.

— Kish qenë student në gjimnaz; pasi kish mbaruar shkollën s'i kishin dhënë punë, dhe kështu nga dëshpërimi i dha fund jetës. Kish lënë edhe një letër...

— Po një gjë e tillë ndodhi edhe përpara dy ditësh, apo jo?

— Po, ai ish nga Korça, kurse ky i sotmi është nga Elbasani. Ç'dreqin kërkojnë këta të rinj?! Brënda kë-tyre tre muajve kanë ndodhur më tepër se 40 vëtrvrasje të tillë...

Unë dridhesha kur dëgjoja një bisedë të tillë. Veliu fliste për këto gjëra si për të gjitha të tjerat, kurse ustaj dukej si i prekur... Herë pas here më hidhte një vështrim pyetës, pastaj më thosh me një zë të butë:

— Ke bérë mirë që u largove nga shkolla, do të kishe përfunduar në litar po të mbaroje gjimnazin. Të pak-tën kështu si çirak, je më i sigurt në jetë. Për çirakë gjithmonë do të ketë nevojë, kurse për shkollarë jo, apo

jo? Kjo është si një e një bëjnë dy. Ja, unë s'kam shkollë, por llogaritë i bëj më mirë se një profesor; mjafton që njeriu të jetë i pasur, pa të gjitha të tjerat ndreqen.

Gjatë gjithë kohës që ndenja në këtë dyqan, mësova shumë të fshehta që ndodhnin çdo ditë, prapa mureve të shtëpijkeve tonë, të fshehta, të cilat turbullonin mendjen e njerëzve.

— Pas një mungese prej tri ditësh, Veliu i thosh ustajt:

— Vdiqa pér gjumë, pér fjalë të nderit!

— Pse?

— Po kërkojmë qark të kapim ata që shajnë ministrat.

— Shajnë ministrat? — pyeti ustaj i habitur.

— Po, janë disa njerëz që hedhin letra në postë me adresë të ministrave. Çfarë nuk shkruajnë.

— Folë hajér Veli! — murmuriti i tmerruar ustaj.

— Nuk lenë gjë pa u thënë, u numërojnë të këqijat që kanë bërë; kryeministrit Koço Kotës, i thonë se do ta vrasin po qe se ai nuk bën një ndërrim të politikës...

— Ashtu? Po emër a shënojnë?

— Të shënonin emër është punë e lehtë, po s'e bëjnë këtë gjë. Firmosin «Dora e zezë». Hajde merre vesh ti ku bije ky katund!... Është mobilizuar gjithë xhandërmërija dhe s'po i zbulojnë dot...

Unë bëja sikur kryeja ndonjë punë, po mëndjen e kisha aty, tek fjalët e Veliut. Çuditeshha se si kishte njerëz aq të guximshëm, sa t'u shkruanin letra të tillë ministrave! Veliu trofullinte si një kalë dhe ustaj i thosh:

— A thue do t'i kapni?

— Sigurisht do t'i zëjmë. Kush ka shpëtuar nga duart tonë? Po ama edhe ata janë kopila; ngjet, bie fjala, që sot hedhin një letër dhe heshtin pér dy muaj rresht, kurse ne lodhemi aq shumë, sa kur vjen fundi, fillojmë e mërzitemi. — S'do të hedhin më, — mendojmë ne. — Po, po të nesërmen, dy letra të tjera, njera ministrit të Brëndëshëm Musa Jukës, tjetra gjeneral Prenk Previzit... Ahere xhandarmëria përsëri në këmbë... Kështu vazhdon puna pér shumë kohë. Burgun e kemi mbushur plot me të dyshimtë, shumë njerëz janë rrahuar pér vdekje...

Në sytë e Velut duket lodhja dhe mërzia. Ai rri një copë herë pa folur fare, këmbë mbi këmbë, pastaj nis e flet si nëpër gjumë:

— Kur mejtoj thellë, shpesh herë më duket sikur bëjmë faj të madh që i gjurmojmë kaqë shumë njerëzit. Këta kanë nevojë për punë, dhe ta merr mendja, kur s'ke, do të shash, do të ulurish, se dhe qeni që është qen, ulurin po të mos i japësh të hajë. Kështu është, po s'ke ç'të bësh, dikush është xhandar, dikush nëpunës, tjetri punëtor, sejcili është i detyruar të kryejë detyrën e tij.

Heshti përsëri, pastaj përsëri shtoi: — Ç'të bësh, kështu e ka kjo jetë!...

Kur ikte ai, ustaj më këshillonte:

— Mos folë me njeri për këto që dëgjove; ndryshe do ta pësosh keq!... dhe mos kujto se Veliu është aqë shpirt mirë sa shitet, edhe mua është gati të më dërgojë në litar, po qe se dyshon, bile edhe të jatin!...

VI

Një të shtunë pas dite, erdhën në dyqan shokët e mi, Xhemal Dibra dhe Sandër Cicka. Me ta kam bërë katër vjet shkollë, dhe kemi patur shoqëri të ngushtë. Xhemali është nja një ose dy vjet më i madh se unë, çun mjaft i zgjuar, por tepër i dhënë pas prapësive; pinte duhan si një i madh, mbante llastik në xhep dhe ishte gati të përleshej me cilindo, mjafton që t'i mbushej mendja. S'kishte babë, kur se e éma, e re dhe e fuqishme, nga nevoja ish martuar me një të pensionuar, plak njeri, ish shërbëtor i bashkisë.

Xhemali më tregoi me mburrje se edhe ai ish larguar përgjithmonë nga shkolla, e se kish ardhur ta ndihmoja për të gjetur punë. Sandri, i rrëmbyer nga gjëzimi që shkaktojnë këto aventura tek fëmijët, e ndiqte pas Xhemalin, me shpresë se edhe ai, një ditë, do t'ja mbushte mëndjen prindërve të vet për ta hequr nga shkolla. Për t'i provuar se mos talleshin me mua u thashë të kthehen në shkollë.

Leri ato, se s'na e kthen dot mëndjen! — ma preu

jo? Kjo është si një e një bëjnë dy. Ja, unë s'kam shkollë, por llogaritë i bëj më mirë se një profesor; mjafton që njeriu të jetë i pasur, pa të gjitha të tjerat ndreqen.

Gjatë gjithë kohës që ndenja në këtë dyqan, mësova shumë të fshehta që ndodhnin çdo ditë, prapa mureve të shtëpijave tonë, të fshehta, të cilat turbullonin mendjen e njerëzve.

— Pas një mungese prej tri ditësh, Veliu i thosh ustajt:

— Vdiqa për gjumë, për fjalë të nderit!

— Pse?

— Po kërkojmë qark të kapim ata që shajnë ministrat.

— Shajnë ministrat? — pyeti ustaj i habitur.

— Po, janë disa njerëz që hedhin letra në postë me adresë të ministrale. Çfarë nuk shkruajnë.

— Folë hajër Veli! — murmuriti i tmerruar ustaj.

— Nuk lenë gjë pa u thënë, u numërojnë të këqijat që kanë bërë; kryeministrit Koço Kotës, i thonë se do ta vrasin po qe se ai nuk bën një ndërrim të politikës...

— Ashtu? Po emër a shënojnë?

— Të shënonin emër është punë e lehtë, po s'e bëjnë këtë gjë. Firmosin «Dora e zezë». Hajde merre vesh ti ku bije ky katund!... Është mobilizuar gjithë xhandërmërija dhe s'po i zbulojnë dot...

Unë bëja sikur kryeja ndonjë punë, po mëndjen e kisha aty, tek fjalët e Veliut. Çuditesha se si kishte njerëz aq të guximshëm, sa t'u shkruanin letra të tillë ministrale! Veliu trofullinte si një kalë dhe ustaj i thosh:

— A thue do t'i kapni?

— Sigurisht do t'i zëjmë. Kush ka shpëtuar nga duart-tona? Po ama edhe ata janë kopila; ngjet, bie fjala, që sot hedhin një letër dhe heshtin për dy muaj rresht, kurse ne lodhemi aq shumë, sa kur vjen fundi, fillojmë e mërzitemi. — S'do të hedhin më, — mendojmë ne. — Po, potted nesërmen, dy letra të tjera, njera ministrit të Brëndëshëm Musa Jukës, tjetra gjeneral Prenk Previzit... Ahore xhandarmëria përsëri në këmbë... Kështu vazhdon puna për shumë kohë. Burgun e kemi mbushur plot me të dyshimtë, shumë njerëz janë rrahur për vdekje...

Në sytë e Veliut duket lodhja dhe mërzia. Ai rri një copë herë pa folur fare, këmbë mbi këmbë, pastaj nis e flet si nëpër gjumë:

— Kur mejtoj thellë, shpesh herë më duket sikur bëjmë faj të madh që i gjurmojmë kaqë shumë njerëzit. Këta kanë nevojë për punë, dhe ta merr mendja, kur s'ke, do të shash, do të ulurish, se dhe qeni që është qen, ulurin po të mos i japësh të hajë. Kështu është, po s'ke ç'të bësh, dikush është xhandar, dikush nëpunës, tjetri punëtor, sejcili është i detyruar të kryejë detyrën e tij.

Heshti përsëri, pastaj përsëri shtoi: — Ç'të bësh, kështu e ka kjo jetë!...

Kur ikte ai, ustaj më këshillonte:

— Mos folë me njeri pér këto që dëgjove; ndryshe do ta pësosh keq!... dhe mos kujto se Veliu është aqë shpirt mirë sa shitet, edhe mua është gati të më dërgojë në litar, po qe se dyshon, bile edhe të jatin!...

VI

Një të shtunë pas dite, erdhën në dyqan shokët e mi, Xhemal Dibra dhe Sandër Cicka. Me ta kam bëre katër vjet shkollë, dhe kemi patur shoqëri të ngushtë. Xhemali është një ose dy vjet më i madh se unë, çun mjaft i zgjuar, por tepër i dhënë pas prapësive; pinte duhan si një i madh, mbante llastik në xhep dhe ishte gati të përleshej me cilindo, mjafton që t'i mbushej mendja. S'kishte babë, kur se e éma, e re dhe e fuqishme, nga nevoja ish martuar me një të pensionuar, plak njeri, ish shërbëtor i bashkisë.

Xhemali më tregoi me mburrje se edhe ai ish larguar përgjithmonë nga shkolla, e se kish ardhur ta ndihmoja pér të gjetur punë. Sandri, i rrëmbyer nga gjëzimi që shkaktojnë këto aventura tek fëmijët, e ndiqte pas Xhemalin, me shpresë se edhe ai, një ditë, do t'ja mbushte mëndjen prindërve të vet pér ta hequr nga shkolla. Për t'i provuar se mos talleshin me mua u thashë të kthehen në shkollë.

Leri ato, se s'na e kthen dot mëndjen! — ma preu

Xhemali. Ç'e dua unë shkollën? Mcs do të bëhem gushkuq apo prefekt? Ku ka si njeriu që bredh, që fiton vetë para, që vete nga të dojë!... Ja, për shëmbull, sot isha në lumë, i dhashë një të larë, oh, oh! — (u shtriq dhe téshtiu me krenari).

Mua më qante shpirti pér ato që tregonte Xhemali. Dëshiroja që edhe unë të zhytesha në ujin e freskët të Lanës me Përru, të dilja bashkë me shumë shokë të tjerë udhëvë të Tiranës, dhe të ndeshesha me fëmijët e largjeve të tjera, deri sa të griseshim nga rrrobat dhe faqet të na bëheshin gjithë gjak. Po ja se dashuria pér nënë më pengonte.

Befas, vura re se ndërsa po bisedoja me ata, ustaj ish afruar në rrëzë të derës dhe po na përgjonte. I bëra shenjë Xhemalit dhe Sandrit që të iknin, po ata, duke mos më kuptuar, vazhdonin të flisnin shtruar. Ahere ustaj doli, pështyu gjithë inat mbi kalldrëm, më hodhi një vështrim kërcënonjës, dhe më pyeti më zë të ulët, por të vrazhdë:

— Hë, kapetan, cilët janë këta?

— Shokët e shkollës, — iu përgjigja unë.

— Pse kanë ardhur? — Zëri i tij sa vinte bëhej më i ashpër.

— Hic, u qëlloi rruga këtej.

— U qëlloi rruga, apo pér të qëruar ndonjë gjë?! Dhe duke iu drejtuar atyre, u bërtiti dhe u tha, me njerën dorë gati pér t'i qëlluar: — Shporruni këtej, hajdutë të vegjël! Dhe ti futu brënda, në mos po shko me ata! Pastaj mbylli njerin sy, siç bënte zakonisht kur zemërohej. Ndërkaoq pashë se edhe Xhemali s'kish ndërmënd të lagohej pa e thënë fjalën e tij. S'u tund fare nga vëndi, më shikoi dhë m'u duk sikur po më pyeste me atë vështrimin e tij të zgjuar: «Ta nxjerr llastikun dhe t'ja thyej xhamet?».

Unë u futa brënda pa bërë zë, dhe ustaj më ndoqi pas, po ja se shpejt u dëgjuan fjalët e Xhemalit:

— Pér ato që the, do të bëhesh pishman, more vesh? Ne s'jemi hajdutë!...

Ustaj vrapoi dhe ata ua mbathën këmbëve. Kur erdhi, më zuri nga veshët; m'i tërhoqi aqë shumë, sa me zor arrita të qëndroj në majë të gishtave të këmbëve. S'fiste, po kafshonte gjuhën; si dukej priste se mos do t'i kundërshtoja. Po unë e durova dhëmbjen dhe s'kisha ndërmënd as të ankohesha fare.

Pastaj m'i lëshoi veshët e më tha: — Shko e lajmëro nënën që të vijë t'i jap kusurin që të takon dhe të më hi-qesh këtej... Kur të rritesh, mbase do të grabisësh edhe shtëpitë e huaja. Shko!...

Syt'e mi u mbushën më lot. Fjala «shko», më tingëlloi rëndë; m'u duk sikur tani përpara meje, ish hapur një greminë. Ku të shkoja? Në shtëpi? Po prindërit e shkretë prisnin prej meje, t'u tregoja gjëra të mira e jo se më kishin dëbuar! I rash ndër këmbë dhe fillova t'i luttem që të më mbante, të kish mëshirë për mua dhe i premtova se punën do ta kryenja akoma më mirë. Po ai nuk tundej fare. Dëgjonte lutjet e mijë, i pëlgente të shihte një njeri të gjunjëzuar dhe çfrynte gjithë inatë.

— Ka marrë fund kjo punë! — thosh duke trokitur gishtrinjtë e duarve mbi xhamin e banakut.

Ahere edhe mua më kërceu gjaku mbi kokë:

— Mirë pra, nem hesapin, — i thash.

Ustaj i çuditur nga guximi im, më shikoi plot habi. Tundi kokën duke menduar diçka me vete dhe pastaj foli me fjalë të çkoqura mirë:

— Ama kështu, ë? !... Lotët tuaja paskan qenë gjennjeshtra; më lumtë që s'e hëngra kilon për okë! Shko e thirr nënën!...

— S'ka nevojë të thërras nënën, nem hakun dhe unë iki...

Ai e kish mbyllur njerin sy, fytyra e tij po zverdhej dalëngadalë dhe shihja se tek ai po ngjallej një zemërim i madh. Lëshoi një fishkullimë të gjatë dhe tha si me përtesë:

— Shko e më bjer nënën këtu se përndryshe...

Ai nuk arriti ta mbarojë fjalën, sepse një mi i ndezur flakë u fut në dyqanin tonë. Ustaj, i tmerruar, lëshoi

një klithmë dhe duke më zënë për supi, thirri: — miu i ndezur, shpejt ta kapim se na e dogji dyqanin.

Miu, si një top i zjarrtë, përplasej qosh më qosh dyqanit, u fut nën raftin ku mbanim kajmaklijet, dhe, duke mos gjetur dot shpëtim, u ngjit me një shpejtësi të habitëshme, mbi dritare, pastaj në mur dhe kërceu në tavan.

— Medet se më fiku! — thirri ustaj duke shkulur flokët.

Ustaj m'u dhimb. Vajta në guzhinë, hypa mbi oxhak, pastaj me mundim zërtheva një kapak prej dërrasash, dhe dola në tavan. Eca me këmbë e duar nëpër errësirë, dhe pashë se miu, i bërë shkrum e hi, kish mbetur aty, mbi tavan, dhe vazhdonte të digjej akoma. S'do mend, sikur të mos kisha vajtur me kohë, do të ishin djegur blozët e pastaj drrasat e tavanit, e kështu i gjithë dyqani.

Kur zbrita, ustaj më mori me përkëdhelje, më fshiu kokën e faqet me përparsen e tij, sepse bloza më kish bërë si arap, dhe më tha me një zë të dredhur:

— Tani e tregove se të kam besnik. A e fike mirë? Si, s'ke lenë asnje shkëndijë sipër? Të lumtë, po pse s'ma solle atë mi që do t'i punonja qindin. Ai i poshtër desh më nxorri në udhë të madhe!...

Në dyqan kishin ardhur plot njerëz, tregëtarë dhe esnafë të udhës sonë, të cilët qeshnin, dhe njeri prej tyre, një burrë me brekushe të bardha, me qeleshe, të gjatë e me qestek sahati, që i varej nga qafa deri në brez, thosh me dialekthin e tij tiranas:

— Saliu i dha flakën miut në dyqon të tij e miu tu turr dik drejt për drejt dyqonit tem, po unë e mora vesh kte. I zuna derën e dyqonit e ja përmblodha me shqelm miut të kuq e miu ja dha fësht ke dyqoni i Mehmetit. Shyqyr që pate çirakun se i pate me la durët më dyqonin, o Met...

E pashë se ustajt i vinte rëndë kur qeshnin ata fqijt e tij, tregtarë që s'ja donin të mirën shoshoqit, prandaj u foli me një zë pak të ashpër:

— Edhe sikur tē më digjej dyqani, juve ç'u duhet? Po mos harroni se Saliu që e lëshoi miun tē djegur nuk do t'i shkonte tē shpëtonte lehtë.

— E drejtë.

— Po a nuk dini ju se nē Stamboll është djegur një pazar i tërë nga nji mi i vetëm? !... vazhdonte ustaj.

— Ke cirak tē mirë, o Met! — ja priti dikush.

Pashë se shumë prej tyre m'i kishin hedhur sytë, po ustaj, duke mos dashur që unë tē dëgjoja lëvdatat, më urdhëroi që tē futesha nē kuzhinë. Pastaj erdhi pranë meje, u suall rrrotull nëpër kuzhinë dhe thosh ngadalë, sikur ankohej:

— Qesatliku i bën tē gjitha këto, o kapedan! Tregëtarët s'kanë me se merren, prandaj u pëlqen tē tallen me mijtë e djegur: kur s'do dreqi e t'u japi flakën!...

Fliste duke shikuar vendin, nga ku isha ngjitur unë dhe shtonte i pakënaqur:

— Sikur e paske çqyer tepër kapakun! E? Bela e belave po i sillet kokës s'ime! Po ç'të keqe kam bërë unë? Perendisë i falem, me njerzit jam i drejtë, po belatë s'po më hiqen që s'po më hiqen!...

Heshti, më ktheu ngadalë nga ana e tij, dhe më pyeti si me lutje:

— Më thuaj tē vërtetën, ç'kuptim kishin ato fjalët e shokut tënd: «Do tē bëhesh pishman»? E pse tē bëhem pishman. Mos kanë ndërmend tē më thyejnë dyqanin? !...

I spjegova se që tē dy janë djem tē mirë, po ustaj i ngrysi vetullat dhe tha duke i shoqëruar fjalët me një pshërëtimë tē gjatë:

— S'besoj tē jetë ashtu! Ai djali i gjatë kish sy hajduti. Për këto gjëra unë do tē vej në dijeni edhe Velinë... ahere...

Dhe iku duke venë duart njera mbi tjetrën sikur desh tē më thosh:

— Aherë do tē shohësh cili jam unë!...

VII.

Veliu erdhi në mbrëmje; ish gjysëm i dejur; sytë i lëviznin me përtesë. Ustaj sapo kish dalë; dhe Veliu më urdhëroi të shkoja ta kërkoja.

— Ta gjesh me doemos, more vesh?

Isufi për t'i bërë qejfin, shtoi se mund ta gjeja në mihanen e Dylit, ose në shtëpi.

Veliu e rrotulloi kokën me përtesë, si një ka, dhe i tha Isufit, me gjuhën e trashur nga pija:

— Mirë pra, shko dhe kërkoje ti me që e gjen më shpejt.

Kur iku Isufi, Veliu më thirri pranë dhe më tha ngadalë, duke shikuar nga dera:

— Sonte do të na mbarosh një punë të vogël, si thua? Do të shpriesh një letër në shtëpinë e një mikut, more vesh?

— Si urdhëron.

— Ashtu, djal i mirë.

Gojën e mbante gjysëm të hapur, dhe kur merrte frymë, gërmazi i fishkullonte. Përpara vetrinës sonë, rrëshqisnin hijet e injerëzve që vejnë e vijnë; Veliu i ndiqte me sytë e tyre, dhe mua më dukej, sikur ai do të vdiste nga çasti në çast, ashtu siç vdiq dy vjet më parë, në mes të udhës, një burrë shtrembaluq, i cili, duke ecur, qëndroi befas, përplasi këmbët, i doli shkumbë nga goja dhe dha shpirt...

Parafytyrimi i kësaj skenë më tronditi pak dhe Veliu më pyeti:

— Ç'ke që e lëviz kokën si harabel?

— Kam frikë.

— Nga se?

— Nuk e di.

— Shyqyr që kë frikë, ndryshe do të bëheshe kriminel i madh.

Erdhi ustaj. Veliu i bëri shenjë me kokë dhe të dy shkuuan në kuzhinë.

Isufi më tha ngadalë:

— Sonte lot diçka.

— Çfarë?

— Ajo nuk dihet; besoj se diç duan të vjedhin ose të vrasin ndonjë. Ustanë e gjeta në mihane dhe kur i thashë se e kërkonte Veliu, vura re se nuk i erdhi mirë. Udhës më thosh: — Ky Veliu është ngatërrestar i madh. Zoti më ruajtë prej tij!..

Pas dhjetë minutash dolën të dy. Përpara ecën Veliu me atë hapin e tij serbes.

Kur duallën, Veliu më bëri shenjë që t'i shkoja nga pas. Ai ecte me çap serbes dhe qëndrontë katër pesë metra larg meje, rrallë e këthente kokën për të parë në po e ndiqnja. Kur më shihte, më shkelte synë që të mos mërzitesha. Unë nuk kuptoja se ku po më shpinte. Dy tri herë u mata të iki me vrap, drejt e në shtëpi, po përsëri më mbante kureshtja për të mësuar se çfarë do të ngjiste. Ecëm nëpër pazarin e vjetër dhe dualëm në rrugën e Durrësit. Veliu e nderonin shumë burra me dorë në zemër, kurse ai, u përgjigjej duke tundur kokën, ose duke ngritur vetëm dy gishtërinjt në strehën e kapelës.

Kur mbërritëm në një rrugicë pa krye, Veliu hodhi një vështrim prej kusari, pastaj më bëri shenjë t'i afrohesha dhe më tha, duke më treguar me gisht portën e tre-të që gjendej në të majtë të rrugicës:

— Bjeri tri herë me radhë. Në të daltë burrë, i thuaj se kërkoj shtëpinë e Rifat Mazllumi.

— Po cili është ky Rifat Mazllumi? —

— Hajvan! — Dhe më shtërngoi në sup me ato duart e tij të forta. Bëj ashtu si po të them unë! Në të daltë grua, i thuaj Veliu prët. Gruaja do të vijë me ty dhe ti do ta përcjellësh në dyqan, fute në guzhinë. More vesh?

— Si urdhëron.

— Ahere nisu, mos u tremb! Unë të pres tek miha-neja e millit.

Trokita tri herë në portë. Më dukej se po trokisja në zemrën time. Dëgjova ca hapa të lehta përtetj portës. Pastaj një heshtje varri. Një lakuriq nate vinte rrötull meje, sikur po përgjonte të fshehtat që po bëja unë.

— S'kaluan as 10 sekonda, dhe një zë i dobët gruaje, pyeti:

— Kush éshtë?

— Hape — i thashë.

Një çelës u përpoq të futej në bravë. Pastaj çelësi u rrotullua dhe dera u hap. Para meje qëndronte një grua. Ajo kish hedhur mbi kokë një çarçaf të zi. Kur më pa se unë isha i vogël, më tërroqi brënda dhe pa folur gjysëm fjale, më shpuri në një dhomë. Dhma ish e varfër, po e pastër. Gruaja e hoqi çarçafin dhe ahene u zbulua fytyra e sajë, një fytyrë e butë dhe e hijëshme.

Duke mbajtur vesh si me frikë, më pyeti:

— Kush të dërgoi?

— Veliu pret.

— E ç'të tha?

— Që të vish me mua.

— E mjera unë! Po si mund të vij?

Fytyrën e saj të trandafiltë e mbuloi përnjëherësh një hije trishtimi.

Unë e pyeta i mallëngjyer:

— Çfarë e ke Veliun?

— Kurgjë, — më tha ajo duke kërkuar në fytyrën time përkrahje; oh more vëlla, ti s'e din si qëndrojnë punët!...

Erdh dhe u ul pranë meje; dorën m'a hodhi në qafë dhe duke shikuar në faqen e murit, nisi të qajë në hesh-tje.

Unë s'po kuptoja në isha në èndër apo zgjuar. U ngrita nga një diçka që më goditi mu në zemër, po ajo gruaja më solli në vete:

— Rri edhe pak, më këshillo si të veproj.

— Këshillohu me Veliun më mirë.

— Ah, Veliu!... Ai katil po ma shkatëron jetën!...

— Po pse?

— Unë jam e martuar, more vëlla; megjithse jam e martuar, më ka rënë në qafë një kapter i xhandarmërisë; ka plot tre muaj që ai me shokët e tij s'lenë gjë pa më bërë, më kërcënojnë me letra; një natë ai kapteri desh të futej me zor në shtëpinë time. Unë e mjera nuk

guxoja t'ja tregoj burrit, se ai është gjaknxehtë dhe kam frikë se puna do të mbarojë me vrasje. E, si thua ti? A nuk është gjynah t'i bëhesh havale një gruaje të martuar!?

Sytë e saj sikur kërkonin të qetësohen në fytyrën time.

— Maskarejtë — murmurita unë.

— Mendo sikur një gjë e tillë t'i ndodhte motrës sate...

— Do t'i kisha vrarë si qenër! — përsërita unë i zemëruar në kulm.

Ajo më shtërngoi me dashuri. — E, si më këshillon? Ç'të bëj?

— Thuaja burrit! — (me këtë fjalë kisha qejf që burri i saj, t'u jepte nga një plumb kokës si Veliut dhe kapterit).

— Ashtu thua? — pyeti ajo duke fshirë lotët.

— Po, po, do të jetë njiqind herë më mirë.

— Po sikur të vritten?

— Le të dalë, ku të dalë...

— Po ahene më keq do të jetë për mua, apo jo?...

Ne femrat e mjera!...

Sa shumë më pikëlluan këto fjalë. Përpara meje qëndronte një grua,jeta e së cilës ish në rrezik. Ajo po ndiqej kot nga Veliu dhe shokët e tij dhe kjo gjë më zemëronte pa masë. Të kisha fuqi do t'i kapja për fytat aq njerëz të poshtër dhe do t'i shtërngoja deri sa t'u dilte shpirti. Asaj i thashë që ta kyçte mirë portën dhe Veliun do ta gënjeja se më kish dalë burri e jo gruaja.

E shkreta grua! Më përqafroi me ngrohtësi, pastaj hapi një sepet të vjetër dhe nxori dy kokrra vezë.

— Na, merri! — mu lut ajo, — nga unë, motra jote.

Nuk guxova ta kundërshtoj. Qysh në fillim ajo më kish fituar zemrën. I mora vezët dhe ika me nxitim. Ajo më shoqëroi gjer te porta, dhe ndjeva, për të fundit herë, ngrohtësinë e frysës së saj, që shpërndalët në fytyrën time, si aromë karafili.

Eca nja tre hapa, dhe ja, kyçi u rrötulla me kujdes.

— Natën e mirë, o motra ime! — murmurita më vete.

Dikush po vinte në drejtimin tim. Po sikur të ish Veliu? Shkova rrezës së muri me frikë.

Njeriu as më vuri re fare — dukej se ish i pirë — dhe unë dola në udhën kryesore. Ndjeja një gëzim, po isha edhe shumë i shqetsuar; një frikë po zgjohej në thellësitë e gjoksit tim.

Shumë kohë luftova me vetvetën: të shkoj a të mos shkoj tek Veliu? Më në fund, vendosa të shkoj, se ai me siguri do të vinte të nesërmen në dyqan, dhe dreqi e di se çfarë avazesh do të më nxirrte.

Veliu ishte në mehanë dhe kish zenë vënd përkarshi derës; pérpara kish një gotë me raki dhe pér meze një kofshë gjeli.

Më të ishte ustaj dhe një kapter. Sigurisht ai kapteri, pér të cilin më kish folur ajo gruaja.

— Eh? — më pyeti Veliu, vetëm me lëvizjen e vetullave të tij.

— Doli burrë, — i thashë.

— Po pse u vonove kaq shumë! Mistrec!

— Sëpse më kapi dhe që duke më hequr një dru të mirë...

— Ai burri?

— Po, është xhahil i madh ai!... E njoh, qenin e njoh — foli ai kapteri me nji zë të trashë dhe gëlltiti një gërgëllimë raki. — Po në e zënsha, pér flamur, do t'ja bëj shpinën më të butë se barkun....

Pijetorja gumëzhinte, atmosfera ish e prishur nga tyimi i duhanit dhe era e alkolit. Dikush pérplaste grushtin në tavolinë, një tjetër po pérpiqej të gjente fillin e një melodije, ndërsa një burrë topall e tërhiqte kamarijerin nga xhaketa.

— Mustafë, pse s'e solle gotën t'ime?...

Veliu më tha:

— Mirë, tani shko, nesër merremi vesh...

Sikur u lirova nga burgu. Ora kish vajtur 10. Qielli ishte i kthjelltë dhe ajri i ftohtë. Vajta në shtëpi me njëmijë mendime në kokë.

Isufi filloi tē nGREJË shumë kurthe kundra meje. Ai kishte frikë se mos unë bëhesha më i dashur se ai në sytë e ustajt, e atëherë ustaj mund që ta dëbonte, mbasi puna sa vinte pakësohej. Kur ai dëgjoi se unë kisha shpëtar dyqanin nga rreziku i zjarrit, nisi tē më vështronë me inat dhe mundohej tē më zinte në gabime.

— Pse s'i ke pastruar mirë kazanet sot? Pastat kanë marrë erë dhe kjo për fajin tënd...

Një ditë, dëgjova që po i thosh ustajt, në kuzhinë:

Kot që e mbajmë atë, më mirë ta hëqim, pa punën e tij e bëj se e bëj unë...

Atëherë m'u kujtua se shpesh, Isufi më kishte vënë në prova tē ndryshme për tē m'a hedhur:

— Sikur tē marr me lejen tënde një kile sheqer, ç'do tē bëje — më pyeti një ditë.

— Nuk do tē tē lija.

— Po pse?

— Sepse sheqeri është i ustajt.

— Po sikur ta merrja? — Isufi largoi tufën e flokëve tē verdha, që i ra mbi ballë.

— Po ta bënje këtë, do tē lajmëroja ustanë.

Ai heshti, pështyu përmes dhëmbëve tē tij tē rrallë dhe tundi kokën duke murmuritur sikur i fliste vetes: s'e besoja se tij je djalë i tillë!... Pastaj shtoi duke më shtyrë! — Tani shko e lajmëro ustanë për këto që biseduam dhe ai tē ka për tē dhënë bakshish.

E ndjeva veten tē fyter nga këto fjalë. U largova prej tij dhe vazhdova punën.

Në mbrëmje, kur e mbyllëm dyqanin, ai erdhi me mua. Unë kisha vendosur tē mos i flisja më, po ai më shtiu krahun, dhe më tha: — Hajt tē shohësh ku banoj unë...

* * *

Isufi banonte në një barangë tē vjetër, tutje, në la⁴ gjen e Tabakëve, sipër shtëpisë tē evgjitetëve. Në një qoshe ishin shtruar culet e fjetjes, aty pranë dukej një valixhe

e vjetër dërrase, që kish marrë një të çarë mes për mes; pak më tej, një katruve ujë, një tas prej balte dhe një lugë pis ishin hedhur pa kujdes në tokë. Të katër fajet e dërrasave ishin mbushur me gazeta dhe reklama kinemajë.

— E njeh këtë artistin? — më pyeti Isufi me kreneri, — është Bobstèle, kurse ky është Bambu, ai atje Buk Zhones. Unë vdes pas Bambut. Është i fortë, i shkathëtë, sa e gjithë policia s'e zë dot. Të isha edhe unë si Bambu!...

— Po në valixhe çfarë ke? e pyeta s'dij qysh.

U ul në gjunjë, tërroqi valixhen, nxori një spango nga qafa, ku kish varur një çelës të vogël, dhe me të hapi valixhen. Aty pashë nja dy fanella të vjetra, disa ndërresa të tjera të mbrendëshme, një copë bukë të mykur dhe një diçka si pako. E mori këtë pako në dorë; ma rrotulloi nja dy herë përpara syve dhe më pyeti: — A e din se çfarë kam këtu?

— Karamale — thashë unë.

— Jo.

— Sallam atëhere!

— Sallamin e hanë vetëm kaurët... Do të ta tregoj?

— Prit se kam për ta gjetur vetë. Kafe, pra!

— Uuuu, sa larg shkove tan! — Ti pandeh se unë jam i varfër, ë? Ndëgojoje, — dhe filloj të tundi pakon.

— Ç'është? e pyeta.

Isufi e nxori gjoksin përpara dhe, duke u munduar t'i japë vetes hije të rëndë tha: — Këtu kam florinjtë. Gjithsejtë 325. M'i ka lënë gjyshja si trashëgim.

— Pse zgërdhihe? — më pyeti dhe më shtyu me inat.

— Shko, mor laskuriq, ku di ti se ç'janë florinjtë!...

Pastaj e futi kutinë në valice, e më tha, pa më shikuar fare, me një ton serjoz: — Kur të kesh nevojë të madhe, eja dhe më kërko ndihmë.

U rrotullua nga unë dhe shtoi duke e ulur zënë. — Mos e bisedo me njeri këtë çështje, se këtu, pranë nesh, bafojnë nja 3-4 beqarë që t'i qërojnë leckat. Janë të varfër dhe të zotë që të ngjeshin me hu. Unë u kam ardhur shpesh në ndihmë, prandaj edhe më duan shumë...

— E me se merren ata?

— Me ç'tu vijë për dore. Punojnë me kazëm, në behar shkojnë fshatrave dhe kosisin për fshatarët dhe këta u japid diçka.

Befas më hypi një gaz i madh, sepse pashë fotografinë e mbretit Zog pranë një reklame që paraqiste një grua gjysëm lakuriq. Mbreti, me atë fytyrën e tij delikate, të mprehet, me mustaqet spic dhe me ato sytë e zinxh dhe të lënduar, dukej sikur po i lutej asaj gruas, ose sikur po e përgjonte.

— Ç'ke që e përqesh mbretin? — m'u kërcënuar Isufi.

— Mos ke dashur t'i martosh?

— Teveqel! — më tha dhe shikoi me frikë rrëth e rrötull. Po të na ketë dëgjuar njeri, na piu e zeza, në litar na shpunë qysh sonte...

Edhe unë fillova të dridhem. I bëra shenjë Isufit se mos na kanë dëgjuar ata beqarët dhe ai më tha, duke më shtuar frikën: — Njeri prej tyre e ka mik mbretin dhe mund t'i tregojë.

Heshta. Dëgjonja se si më rrihte zemra me forcë, po edhe çuditesha se ai punëtori të kishte mik mbretin dhe të vuante aq shumë!

Isufi u kollit rëndë-rëndë dhe foli me mburrje: — Edhe unë e kam mik mbretin.

— Po pse e ke aq frikë atëhere?

Duke mos ditur ç'të thotë, u përgjegj, si i mërzitur:

— Ta lëmë këtë bisedë tanë, është e ndaluar të flasësh për mbretin.

— Pse? — e pyeta unë, me sy të mbërthyer mbi fotografinë.

— Në t'u ka mbushur mendja të vesh në litar, folë atëhere, po më mirë shko se u bë vonë. Edhe unë dua të flej, se nesër do të ngrihemi shpejt...

U nisa të ikë, por ai më thirri edhe më tha me zë sikur qante:

— Njerin prej nesh, ustaj do ta largojë doemos. Ti ke prindër, të paktën s'je vetëm, si unë. Po unë ku të vete? Jam njeri pa njeri!

— Edhe ti ke mik mbretin, — i thashë.

— Oh, kam mbretin! Kush ma bëri mik atë? !... Janë të rrallë ata që e njohin mbretin; sa për veten time as e kam parë ndonjë herë.

— Pse më gënjeve pra?

— Hiç, ashtu koi, sa për t'u tallur... — Isufi fliste qetë, dhe si me pikëllim.

— T'a kisha mik mbretin, nuk do të roja kështu si rroj. Njoh një xhandar, është matjan, veç ta shohësh ç'jetë të mirë që bën ai, dhe është një tutkun që s'e ka shokun. Ai e ka mik mbretin...

Fjalët e Isufit, sikur jehonin nga një shpellë e thellë dhe unë dëgjoj, me keqardhje, zërin e tij të butë dhe të hollë, si zë gruaje:

— Nuk dij se si do ta kaloj këtë jetë! Të kisha mundësi të ikja fare nga Shqipëra, më mirë do të qe. Po ja se më duhen para!

— Po florinjtë që ke, pse nuk i vë në punë?

— Florinjtë! As në ëndër s'kam parë florij, ti je i vogël, prandaj unë qesh me ty. Ç'të bësh? Më mirë të qeshësh se sa të qajsh! Të kisha florinj do të isha martuar me vajzën më të bukur të Tiranës. Çfarë kam në kuti? ...

Ai heshti dhe e tërhoqi përsëri valixhen. E hapi me kujdes dhe nxori atë pakon. Më shikoi se mos i thoja gjë unë, dhe kur e kuptoi se dëshëroja ta shihja atë ç'ka fshihej aty, tha duke e hapur:

— Ja se ç'kam këtu!...

U çuditë kur para syve të mi, u çfaq fotografia e një gruaje të ligë. Ishte fare lëkuriq, e shtrirë mbi një krevat, me gjitë e mëdhenj që i vareshin deri në bark.

— Ja, kjo është pullumbesa ime, — tha Isufi dhe e shikoi fotografinë me ata sytë e tij të ndezur prush. E puthi me afsh, diçka i murmuriti, sikur ajo ta dëgjonte, dhe si e palosi me kujdes, e vuri në kuti dhe më pyeti me buzën në gaz:

— A të pëlqeу?

— Aspak!...

— Ti je i vogël, po kur të rritesh, do të më japësh të drejtë. Ajo është dashnorja ime e fshehtë. Me të flë,

dhe nga që mendoj gjithnjë pér tē, më duket sikur jeton me tē vërtetë. Emérin ja kam ngjitur Pullumbeshë. A tē pëlqen?

Ai fliste, kurse unë dëgjoja pa ja vënë veshin më fjalëve tē tij. Kisha dëgjuar shumë gjëra mbi gratë e liga, po ja se ajo fotografia më kish hutuar shumë.

Ika dhe gjithë rrugës mendonja mbi jetën dhe mbi njërexit duke vështruar yjet dhe qiellin, që ngrihej mbi mua, si një kupë e pafund, plot shkëndija tē zjarra.

VIII.

Të nesërmien nuk vajta më në punë.

Nëna më pyeti tinës babajt:

Më se do tē merresh tan?

Në zërin e saj dalloja një farë frike, megjithëse ajo kurrë nuk më ka mësuar tē jem frikacak.

— Kam pér tē fituar më shumë para, — i thashë pëditur se si më erdhën këto fjalë.

Ajo më shikoi si me dyshim dhe tundi kokën duke psherëtitur. E mjera nënë, kish tē drejtë! Ku do tē fitoja më shumë para? !...

Babaj as që më pyeti fare pse u largova nga puna, veçse i kish thënë nënës, me lot ndër sy:

— Kam frikë se do tē marrë udhë tē keqe...

Këto gjëra, nëna m'i tregoi kur ramë pér tē fjetur. Rrnim pranë e pranë njeri tjetrit, bisedonim shumë ngadalë, po pér çudi, kuptoheshim pa qenë nevoja ta përsërisim dy herë një fjalë. Unë mundoheshat shoh nënën kur më fliste, po nje që ish shumë errët, s'e dalloja dot. Fjalët e sajë ishin shumë prekëse, ato ngjiteshin thellë në trurin tim e jam i bindur se nuk kam pér t'i harruar kurrë. Kur fliste, afshi i saj i ngrohët përplasej në fytyrën time, dhe unë e ndjej veten tē lumtur. Fjalët e saj më mbushin me guxim:

— Ti, bir, do tē rritesh dhe do tē bëhesh burrë. Pa do tē martohesh dhe do tē kesh fëmijë, kurse unë,

e rrëthuar me mbesa e nipër do të vazhdoj të punoj gjersa
të më lejë fuqija, pastaj do të më mbajsh ti, ë?

Unë s'flisja, po i mbështjellë me një bataniqe të
vjetër, rrija e dëgjoja.

Nëna më pyeste:

— Të mori gjumi?

— Jo, po dëgjoj...

Ajo niste përsëri, me një zë që shpërndahej në
shpirtin tim, si një burim i kulluar:

— Ne gjithmonë kemi qenë të varfër. Im atë, ndjesë
pastë, ka vdekur në Hindi ose Jemen. Shkoi atje bedel
për 30 mexhide. Ku është Hindi dhe Jemeni? Shumë
larg, bir, atje ku buka piqet në diell. Njerëzit atje janë
arapër dhe thonë se nuk kanë dy sy si ne, por një të
madh në ballë. Turqia na merrte ushtar burrat dhe i
shpinte andej larg... — Mos, i lutej nëna ime, — mos
ikë, o burrë, se na more në qafë! Po babaj i thosh: —
Lermë, grua, se 30 mexhidet bëjnë më shumë se koka
ime. — Dhe kështu ai vajti. E pritëm se mos kthehej,
po s'u kthyë më. Nga 200 veta që vajtën, vetëm 3 ardhën.
Babaj na kish dërguar një boçe me gjeth kënaje, dhe si
kujtum, brezat e tij. Unë jam rritur jetime, o bir, si ajo
batha që mbin në udhë!...

Nënës i zihej gërmazi, fliste me zor, dhe kur unë e
zgjasja dorën, shikoja se syt e saj ishin njomur me lot.

— Mos qajë, nanë, mos... — i lutesha unë dhe më
plaste vaji. Më vinte keq për gjyshin që pér të ushqyer
nënën time vdiq aqë larg, por më keq më vjen pér nënën
kur dëgjon rënkimet e zemrës së sajë...

Kur u zgjova, nëna kish vajtur në punë. Akoma është
i ngrohtë vëndi ku ka fjetur ajo, dhe unë, hidhem e futem
në vënd të saj; s'dij sepse kundërmimi i culave të nënës
më jep një kënaqësi të çuditëshme; mbi to e ndjej vetëm
të pushtuar nga diçka që më rrit dhe më forcon.

Tutje, flen motra ime e vogël. Është 6 vjeçë. E ka
nxjerrë kokën e saj të rrumbullaktë jashtë jorganit — një
jorgan i vjetër dhe plot arna sipër — dhe vazhdon të
ëndërojë në një gjumë të thellë. Babaj është ngritur dhe
qëndron mbi krevatin e tij që i shëmbëllen një varke.

(Pér krevat babaj ka vënë dy arka vajguri, dhe një dërrasë të gjatë sipër tyre). Ai pi duhan esull dhe kollitet sa e gjithë shtëpia gjëmon.

Shtëpia jonë, éshtë e vogël dhe e vjetër. Çatia vendevënde éshtë e zbuluar; në dimër q'andej hyn era e ftohtë akull dhe ne mbulohemi dhe shtërnghohemi pranë njeri tjetrit, sepse mërdhahimë shumë. Kur bjen shumë shi, dyshemeja e dhomës sonë mbushet plot me ujë, në pellgun e ujit enden copra letrash ose nallanet e vogla të motrës. Atëhere babaj që qëndron mbi krevat si një korb i zi, jep urdhëra, me zërin e tij të ngjirur: — Shpejtoni, hiqeni hasrën, ngrini postiqen se e arriti uji...

Mbaj mend se si një natë janari, ra aqë shumë shi, sa uji cekte pér pak krevatin e babajt. Gjërat më me vlerë (një cilte, dy jastiqe, një jorgan dhe çarçafin e nënës), i vumë mbi krevat dhe nga frika u mblodhëm pranë babajt dhe luteshim me zë të ulët:

— O zot i madh, na shpëto, o zot i mirë, na ruaj!...

Nëna, që dinte shumë syre, filloj të thosh ato më të rendësishmet. Këto fjalë arabisht të cilave ne nuk ua dinim kuptimin, na mbushnin me kurajë dhe na ndihmonin shumë. Unë, pér veten time, kisha besim të madh në fuqinë e atyre fjalëve. Besoja se në këtë botë éshtë një fuqi e madhe që rregullon punët, dhe se kjo fuqi i ndihmon njerzit e mirë kur ata gjënden në hall të madh.

Atë natë e kaluan ashtu në këmbë, duke u dridhur dhe duke u lutur...

* * *

Përmes të çarave të çatisë, hynë rrezet e para të die llit. Ato ranë në mur si shufra t'arta, dhe njera prej tyre, shëndrit, mbi fytyrën e motrës. Faqet ajo i ka të zbeta dhe flokët ngjyrë gruri. Sa shumë më dhimbset motra! Eshtë e vogël dhe e sëmurë. Nuk dijmë nga se vuani, sepse nuk kemi para pér ta çuar te mijeku. Plaka Mude, i hotë se ka nevojë pér ushqim të mirë, sidomos pér mjaltë dhe qumëشت. Po ku t'i marrim?

Unë deri atëhere, vetëm dy herë kisha ngrenë mjaltë.

Motra u zgjua befas. I përpëliti sytë e saj të zez dhe më pyeti si nëpër gjumë.

— Iku néna?

— Po, iku.

— Pse s'më mori dhe mua?

— Edhe ti i duhesh!

— Unë do të mbaj vajzën e zonjës, Nedretin. Ajo do tē më japë një fustan të bukur për bajram.

— Mirë, nesër do të të marrë...

Babaj dëgjon bisedën tonë; kokën e mban tëposhtë dhe kur e zë kolla, bie përmbyss. Herë-herë, e hedh shikimin e tij mbi mua, po unë e mbuloj fare kokën, ose bëj sikur jam në gjumë. Po ai e kupton këtë. Atëherë mua më vjen inat me veten, sepse nuk jam aq i zoti sa të fshehdikka.

— Dëgjo! — më tha babaj duke e ngritur gishtin e dorës në hava. — Po të kërkojnë shokët, a dëgjon si po fishkëllojnë?

U ngrita me vrap, po babaj më thirri dhe më foli me një ton të rëndë që s'e kisha dëgjuar kurrë:

— Ku do të vesh? Mos more, bëhu i hajrit! A nuk shikon se si po jetojmë ne?

Heshti dhe e zuri një kollë e gjatë. U skuq flakë në fytyrë, damarët e fyfit iu jeshiluan, nga syt i kullonin lotë.

— Unë do të punoj! — i thashë.

Babaj e vuri dorën e tij në kokën time dhe filloj të më përkëdhelë. Gishterinjtë e tij të forta si shkopinj, përshkonin flokët e mijë të dëndura; motra ish ngritur dhe e pështetur mbi brylin në jastëk, po na shikonte gjithë frikë.

Babaj më foli me zérin e tij të zbutur:

— Shko ku të duash, ju jeni të pafajshëm!...

Përsëri e pushtoi një kollë e gjatë, dhe unë u largova me që më dukej se qenia ime aty, ja lëndonte zemrën.

IX.

Vendosa tē shkoj nē pyll. Atje unë e ndjej veten tē lumtur. Shkrihem i tēri kur këmbët mē zhyten nē barin e njomë, ose kur dëgjoj tē lehurat e një zagari...

Që t'i gëzoja edhe prindërit, mendova se do tē ishte mirë sikur tē përgatitja një barrë karthija.

Pylli ndriste i tēri. Mbi tē derdheshin plot shkëlqim rrezet e diellit.

Cdo gjë rrëth e përqak tē magjeps. Fryn një fllad i freskët që më gudulis nën gushë; gjethet e dushqeve duket sikur vallzojnë.

Unë eci pa kujdes, po kur më kërcet një karthije nën këmbë, hi'dhem përpjetë sepse kujtoj se mos shkela mbi gjarpër. Ç'është e vërteta, gjarpijtë i kam shumë frikë...

Dikush më thirri me emër. Vështrova me kujdes rrëth e rrotull; po nuk pashë asgjë. Më pushtoi një frikë e madhe, sidomos kur më ranë ndër ment tregimet e nënës dhe tē shokëve mbi shejtanin, e përgjithësisht mbi shpirrat e këqij. Më kishin thënë se shejtani paraqitet si njeri dhe mundohet tē tē gënjejë me lajka dhe ta mbush mendjen doemos. Bile, kisha dëgjuar se si, një herë, shejtani ish bërë si vllau i një djali dhe kështu e kish marrë me vete dhe e kish shpënë nē një pallat tē bukur; atje i kish dhënë tē hajë gjëra tē ëmbla dhe e kish vënë nē gjumë. Kur ish zgjuar, edhe djali ish bërë shejtani...

Zëri u përsërit edhe një herë dhe unë thirra kot:

— Të pashë, në daç eja se unë po iki...

Pas ferrave, doli Xhemali dhe kjo më gëzoi shumë.

— Po ti, — e pyeta.

— E mora vesh se je këtu dhe ardha.

— Do mbledhish karthija?

— Jo, do tē bëj një kasolle dhe do tē banoj këtu. Tani verë është, dhe nē pyll njeriu bën pallë, apo jo?

Fillova ta shikoj me vëmëndje dhe me dyshim.

— Po sikur ky tē jetë shejtani? — mendoja.

— Unë po iki — i thashë, — se më presin nē shtëpi.

— Rri edhe ca, ke kohë, tani do të vijnë edhe kalanjtë e tjerë dhe do të luajmë kusarçë.

Kur më tha se do të vijnë edhe të tjerë, fillova të qetësohem. Xhemali nxori llastikun nga xhepi dhe filloj të kontrollojë pyllin për zogj. — Ti — më tha mua — shko andej, anës përrojt, se atje duhet të jetë fshehur ndonjë avdosk. Të vrasësh tre prej tyre dhe ja ku na doli dreka...

Unë bëra ashtu siç tha ai, dhe me një hu në dorë u bija ferrave mbarë. — Shiko, në të daltë ndonjë lepur, mos luaj fare nga vendi. Dëgjo! — më fliste ai që nga lart, — vetëm duhet të fishkullosh dhe lepuri ndalet në vënd; aherë vij unë dhe e qëlloj...

Lepura kish plot në këto anë, por që të kapeshin me duar, më dukej gjë shumë e vështirë. Po me gjithëkëtë, unë vështroja me vëmendje drizat, disa herë bëja si qen, dhe qëllaja sa mundja me gur dhe me hu.

Xhemali ecën sipër mbi bregun e përrojt me llastikun në dorë. Kur dyshon, e zgjat kokën pas ndonjë dushku, si ajo breshka që fillon të hajë bostan, pastaj bie në gjunjë, matet të shtjerë, po përsëri zvariset bar-kazi dhe mua ma bën me dorë. E kuptoj se duhet të qëndroj. Ndalem në vënd dhe ahere vendoset një qetësi aq e madhe, sa ke qejf vetëm të shohësh dhe të dëgjosh. Befas lëviz ferra. Xhemali shikon nga unë dhe më pyet me një zë shumë të ngadalshëm:

— A e pe ku ra?

— Cili?

— Shapka.

— Jo, s'passhë gjë.

— Të placin sytë! Do të gjuajmë apo jo?! — inatoset ai dhe bén sikur ikën.

— Po ti pse s'e vrave? — e ngacmoj unë.

— Sa u mata, ajo iku...

— Aherë do të ketë renë atje poshtë...

— Pa tjetër!...

Unë e kuptoj se Xhemali s'ka parë shapkë me sy, po për t'i bërë qejfin, zë e kërkoj. Ferrat janë të shpeshta dhe disa herë më duhet të futem nëpër vënde

shumë të rrezikëshme, atje ku rrrobat të grisen. Duke ecur nëpër ferra duket sikur po bëj diçka që të tjerët nuk munden; kur ferrat më ngjiten në këmishë, unë shkoj përparrë më me forcë.

Aty këtu shoh grumbuj me lule; ndalem e i shikoj me dashuri, pastaj shtrihem barkas e u marr erë. Lulet i dua shumë. Ato janë stolitë më të bukura të natyrës. Kur isha në shkollë dhe kur në fund të vtit shkonim për piknik, shpesh veçohesha nga të tjerët dhe shkoja larg, thellë në pyll, për të mbledhur lule për mësonjësin e klasës sime. I bëja një buqetë të mirë. Ai, më falenderonte, unë ilkja, pastaj e përgjoja se çfarë do të bënte me lulet e mia. Ai u mburrej kolegëve të tij:

— Shikoni ç'më suallën nxënësit e mij! —

Mësueset vraponin tek ai dhe i luteshin t'u jepte disa. Mësuesi im, që i respektonte shumë gratë, ua jepte lulet duke i ngacmuar:

—Po ju jeni vetë lule, mori vajza!...

Mësueset qeshnin me gjithë shpirt. Unë krenohesha me veten time, sepse shkak i gjëzimit të tyre u bënë lulet e mijë...

Dhe ja, tani që po gjuaj me Xhemalin, gjej shumë lule të tillë me ngjyra të forta e të bukura, si ato që mblidhja për mësuesin tim. S'di pse më pushton një mallëngjim i madh, dhe kam vetëm një dëshirë: dua të rrij një kohë të gjatë pranë luleve të mijë të dashura!...

X.

Dy vjet më vonë. Gjatë këtyre dy vjetëve kishin ndodhur shumë ngjarje: Ustaj im i parë ish burgosur për arësyte se kish qëlluar me grusht një xhandar, Veliu ish graduar tetar; kurse për Isufin flitej se kish vdekur nga veremi...

Unë tani punoja si shërbëtor në kafenenë e dajës tim, një kafene e vogël, si tunel, që gjëndet në pazarin e vjetër.

Këtu vijnë lloj-lloj njerzish. Disa luajnë bixhoz, ca tē tjerë domino, disa taull. Në një dhomë tē veçantë, luhet me zar.

Në mes këtyre njerëzve, që s'dijnë tē bëjnë gjë tjetër vegse tē thithin duhan, tē pijnë kafe dhe tē flasin fjalë tē ndyta, dita kalon e zbrazët dhe e neveritëshme.

Unë kam ndrruar: tani jam 14 vjeç, jam më i gjatë dhe zëri më është bërë më i trashë; daja më ka blerë një përparse tē bardhë dhe më ka mësuar tē pjek kafe. Kur ai luan xing ose spathish, unë bëj kafe dhe i shpërndaj tavolinë më tavolinë.

Si usta tē dytë, kam një burrë që quhet Xhemal Polka, njeri i mirë dhe i dashur. Është i thyer në moshë, po përsëri i fuqishëm e me shpatulla tē drejta; ka mustaqe tē bardha, tē trasha, tē ngritura përpjetë si veshët e maces, vetullat gjithashtu i ka tē thinjura, tē trasha e tē dëndura. Kurrë nuk di tē zemërohet.

Kur ecën, Xhemali ecën me vështirësi, sikur shkel mbi prush duke u tundur si një varjë, sa andej këtej, sepse këmbët i ka tē mbledhura shuk, Kështu ka lindur.

Mbiemrin «Polka», nuk e kish tē tijnë, po ja kish ngjitur njëri, në një rast kur Xhemali, duke lojtur kumar, kish hedhur dorën e fundit, ose dorën e polkës, siç e quajnë bixhozçijtë. Aherë ai kish humbur ç'kish pasur. Qysh nga ajo ditë e kishin quajtur «Polka» dhe Xhemali ish betuar tē mos luante më as me zarë, as me letra dhe ish têrhequr mënjanë, duke u munduar t'i kalojë ditët e fundit tē jetës së tij, në një punë që t'i siguronte bukën e gojës. Daja e kish marrë pranë vetes, e mbante me tē ngrenë e me tē pirë, rrallë i blinte ndonjë palë këpucë, dhe e lejonte tē flejë në kafene, me që Polka nuk kish as grua, as fëmijë.

Vonë, kur tē gjithë ikin nëpër shtëpitë e tyre, «Polka» e mbulon zjarrin me hi, mbush edhe teneqetë me ujë, pér t'i pasur gati tē nesërmen, dhe bie tē flejë. Të nesërmen ngrihet që më natë, ndez zjarrin dhe hap kafenënë. Myshterinjtë, ca burra tē përgjumur dhe me sy tē buavitur, hyjnë mbrënda, pëshpërisin me një zë tē ngjirur «si u gëdhitë», dhe ulen me një qoshe, atje

në errësirë, duke pritur t'u shpie kafenë ose çajin. Shumë prej tyre nuk paguajnë para, por nxjerrin rabushin dhe unë ose Polka, i bëjmë një vizë me brisk.

Sapo mblidhen katér vetë, bijën shpejt e shpejt në ujdi, dhe fillojnë të luajnë bixhoz. Kur janë tre, rrijnë e presin të katërtin, me një pamje nervoze prej kumarxhijs tē sëmurë. Bisedojnë punë grash, njeri mburret se ka futur në dorë një jevgë, kurse një tjetër shton se ka pirë dy okë raki. Kur vjen i katërti, i bëjnë shenjë me kokë në dëshëron tē luajë bixhoz. Ai, ose pranon aty pér aty, ose rrin dhe mendon cilin prej tyre tē zgjedhë ortak. Si vendoset mbi këtë çështje, Polka u shpie letrat dhe u merr depozitën. Kështu këta njerës vazhdojnë tē luajnë bixhoz gjer natën vonë. Nga që s'hecin tē ditën, ata zverdhen në fytyrë; shpesh herë thérresim me zë tē lartë, si ujqër, bile edhe pérleshen me njeri tjetrin. Kur zihen, tavolinat rrëzuhen, karrikat thyhen dhe shpesh herë, puna mbaron me plagosje tē rënda. Vijnë xhandarët, marrin pérpara shkaktarët, po i lëshojnë pasi u hajnë ndonjë ryshvet, dhe kështu, pas një ose dy orësh, ata kthehen përsëri në kafene. Pas dy tri ditësh, ata i sheh përsëri me njeri tjetrin, sikur tē mos u kishte ndodhur asgjë.

Njerëzit e asaj kohe në përgjithësi ishin tē preqatitür shpirtërisht pér punë tē dobëta, ata ushqeheshin çdo ditë me ligësinë, me shpifjen, me tē këqijat e kumarit dhe në zemrat e tyre pérhapej, si një tufan, dëshira pér t'u rrathur, pér tē çfryrë kundër dikujt, qoftë edhe kundër tē aférme tē tyre. «Polka», lëvizte me habi kokën e tij tē rrumbullaktë, dhe thosh duke shikuar ata që losnin: — Ja, janë gati tē pérleshen edhe njéherë! ...

Unë iki larg, kam frikë se mos haj ndonjë karrike kokës. Pastaj, kur qetësohet gjëndja, Polka më thérret dhe unë vazhdoj punën time: shpérndaj kafe tavolinë më tavolinë dhe kur nuk ka porosira pér kafe, pastroj karriket ose fshij dyshemenë.

— Ke mësuar tē luash bixhoz? — më pyeti një ditë Polka.

— Po.

— Këtu në kafene mësove?

— Jo, në mëhallë.

. Polka heshti dhe u kredh në mendime. Pastaj tha me zë të mallëngjyer.

— E rrënoi vendin kjo murtajë e zezë! — Dhe psherëtiu me afsh?

Të nesërmen, më tregoi me gisht një burrë shkurtalaq, fytyrë kuq:

— A e shikon atë?

— Po.

— Ai është Jemin Reçi. Është pasanik i madh, aga, po tani po bie nga vakti. Është pusht dhe kumarkhi. Ka rënë në grackën e Kumes, një jevgë që e dashuron. Po, e ka gruan dhe çfarë gruaje! Gjëraqinë për ta mbajtur në pëllëmbë!

Dikush porositi një kafe dhe Polka vuri xhezven në zjarr. Unë lava filxhanet, mbusha një gotë ujë uhe shpura kafenë.

Jemini i kafshon buzët me nervozitet, dhembët i kruen me fije hasre dhe pështyn gati çdo çast. Kur luan xing, ato sytë e tij të egër lëvizin në mënyrë misterioze. Sa herë që e sheh ngushtë kundërshtarin, fillon e qesh me një zë të gjerrë duke zbuluar dhëmbët e tij të verdhë prej ari. Flet fjalë të ndyta, dhe me sa shoh unë, të gjithë ja kanë frikën. Shpesh herë e thërret Polkën:

— Polkë, shko te Dyli dhe i thuaj raki për Jeminin. Kusurin mbaje ti.

Polka ikën i gëzuar dhe Jemini shton duke i shikuar të gjithë me një shikim prej djallit:

— Hë, kujt ja mban të luajë me një dollar do-rën? !...

Asnjë s'përgjigjet; janë të rrallë ata që kanë një dollar në xhep. Unë i njoh të gjithë. Ja, tek është ulur këmbëkryq mbi taftaben usta Xhemë Asllani. Pranë tij rri xhamaxhiu, Nikollë Misku, një burrë i hollë dhe i urtë; Nuz Shijaku është marangoz me nam, po s'gjen punë.

— Flori i kam duart, po ç'e do kur s'ke ku t'i pér-dorësh. Mund të bëj një mobilje që të habiteni kur t'i shihni...

Si ky ka dhjetra të tjerë që i masin me pëllëmbë udhët e Tiranës nga që s'gjejnë punë. Prandaj këta njerëz janë gjithmonë të mërzitur, buzët i mbajnë si të kyçura, thua se duan të frenojnë zemërimin që u vlon në krahor...

Herë pas here shoh gra me ferekhe a me çarçaf që e zgjasin më frikë kokën duke kërkuar në kafene burrat e tyre; ndonjerës i ngrihet i shoqi me përtesë të madhe, i afrohet dhe duke kujtar se nuk po e sheh njeri, e pështyn të shoqen mu në fytyrë; ajo ul kokën dhe hesht. Sa keq! O ti i poshtër! Pse e pështyn? — Dua të thërras — Afrohem⁴ pranë tyre, bëj sikur shikoj gjetkë, po veshët i kam tek ata; bile disa herë u qepem pas për të dëgjuar se ç'farë flasin.

— Ke dy ditë që s'vjen në shtëpi — ankohej gruaja e hollë.

— E pse të vij?

— Fëmijët duan bukë!

— Të bëhem unë bukë? S'kam ç'të bëj, punë s'ka.

— Mos rri në kafe të paktën!

— Ku të mbytem?

— Të mjerët ne...

Gruas i rrëshqasin dy pika lot nëpër faqet e verdha dhe i shoqi e shtyn me zëmërim.

Iku e mjera grua; po ku vajti, ku?...

XI.

Edhe disa ditë vjen viti i ri, Shën Vasili. Daja dhe Polka kanë marrë masa për ta pritur festën ashtu si duhet: kanë blerë një dyzinë filxhane, një tabaka, një deng qymyr dhe një ibrik çaj. Ditët e festave, puna shtohet dhe bixhozi kërcet nga mëngjezi në mëngjez.

Polka, i cili më do shumë, më tregon:

— Mbrëmë janë therur më thika, në një mihane.

— Kush?

— A të kujtohet, ai xhamaxhiu?!

— Po.

— E kanë bërë shoshë me thika, për punë grash.

— Dhe vdiq fare?

— S'do mend që vdiq. E paçin më qaf të mjerin Nikollë dhe atij vetë i vaftë shpirti në xhenet...

Polka psherëtiu dhe përsëri filloj punën e tij të zakonshme. Nga që është mësuar me këtë punë, ai din t'i lajë gotat dhe filxhanet pa i shikuar me sy.

Kur punon ai, unë vështroj vendin ku ulej Nikolla. Ja, më duket sikur është përsëri aty, i hollë e i gjatë, me fytyrën gjithmonë të qeshur. Dhe këtë njeri e kanë therë me thika... Përse, përse? !...

Më vjen të thérres, të qaj nga dëshpërimi dhe nga frika. Polka sikur e kupton këtë dhe më pyet:

— Ke qejf të pish një çaj?

Unë nuk dua as çaj, as kurgjë. Ngrihem dhe dal nëpër pazar.

Esnafët rrijnë e sodisin ose bisedojnë me njeri tjetrin. Temat janë po ato: flasin për njerzit, për gratë, për fitimet e njerit ose për humbjet e tjetrit. Gazeta dhe libra nuk lëxojnë, sepse shumica nuk dijnë të lëxojnë. Edhe kur Hiqmeti, biri i një tregëtarit shihet ne gazetë në dorë, e pyesin me ironi:

— È, politikan, ç'lajme na thue nga Evropa?

— Një krizë e madhe është përhapur edhe në Francë, në Angli e Gjermani.

— Ashtu? Sa mirë, pse veç ne të jemi në krizë? Po tjetër ç'kemi?

— Një artikull me titull: «Kriza monetare në Shqipëri».

— Kush e ka shkruar?

— Z.B.

— Cili të jetë ky Z.B.?

— Zyba! — zgërdhihet dikush.

— E çfarë thotë në atë artikull?

— Tregon se shkaku i vetëm i kësaj krize financiare është mungesa e qarkullimit të parasë.

— I paska lujtë fenë eshydibilah, tamam ashtu është, po nuk xhiroi leku, ka krizë.

— Po tjetër lajm ç'kemi?

— Një nënë e quajtur Eftalie Ekonomi paska vrarë vehten për të mos parë në vuajteje fëmijët e saj.

— Nga ishte?

— Nga Vlora.

— I qoftë udhë e mbarë.

Zgërdhien me ata turijt e tyre gjith dhjamë dhe Hiqmeti vazhdon të lexojë me zë të lartë, si një psallt.

— Dëgjojeni këtë artikull: Ku i gjete, ti nëpunës, ose ti që përdor të hollat e shtetit, këto të holla që i ke dhënë më faiz ose i ke bërë pallate, kurse gjithë bota e di se përpara se të kishe këtë punë, ti s'kishe asnjë qindarkë në xhep edhe se rroga edhe shpërblimi tënd mezi mjafton që të ushqesh vehtën dhe familjen?

— Pa shih, pa shih, gazetat filluan të thumbojnë nëpunësit, ë?

— Po tjetër ç'kemi? — pyet me një interesim të madh manifaturisti Xhel Jipi, një burrë me fytyrë të hequr, si shejtor, e që s'i ndan tespijet nga duart.

— Në Tiranë është e ndaluar të vish për të kërkuar punë; kushdo që ka nevojë për punë lutjen ta drejtøjë nga qyteti i tij, në rast të kundërt, po të gjënden të papunë në Tiranë, do të arrestohen si përhapës të vagabondazhit...

— Shumë mirë! — thërret tregëtarı Nuri Abedini, një burrë me bark të madh që dukej sikur i shkonte gjithënjë përpjetë, drejt buzëve. — Shumë mirë, se ta merr mendja, të papunët këtu do të merren me politikë, pastaj...

Fjalën «politikë» nuk e kuptoja dhe për ta mësuar pyeta Polkën. Ky më shikoi shtërbër dhe më pyeti:

— Ç'të duhet ty kjo fjalë?

— Kot, dua t'i dijë kuptimin.

Ai buzëqeshi dhe u mundua t'i japë përkufizimin:

— Politika është që njerzit i heq nga çdo punë tjetër dhe i detyron të merren me libra e gazeta, me punë hafijesh, me politikë, siç i thonë, ose më sakt, politika është

gjëja më e rrezikëshme. A e kupton tani? Ajo të rrashëndra kur të duash...

Heshti dhe si u mendua ca, shtoi:

— Jemini për shëmbëllështë politikan; punë s'bën, po ja mban hattrin edhe vetë Lalë Krosi...

Tutje, daja im, ka hapur kutinë e parave dhe po numuron lekët e fituara gjatë ditës. E shoh se është i zemëruar dhe këtë zemërim nuk mungoi ta çfaqë tek Polka.

— Të gjitha parat' e sotme janë hedhur në arkë? — e pyeti Polkën.

— Po.

— S'më besohet.

— Polka rrudhi supet dhe në fytyrë i ra një hije turpi

— S'më besohet, o Polkë, vetëm 13 lekë, nga mëngjezi e gjër tani? Si është e mundur, ë?

— Ku ta dijë unë i shkreti!...

— Po unë?

Polka përsëri heshti duke rrudhur supet. Daja i tha me ironi:

— Kësajë i thonë: mirë se djathin na e hangri miu, po shëllirën q'dreq e piu? Më duket se ti e bën kështu, o Polkë: një lek në kuti, dy në xhep.

— Më vraftë zoti jo! Për këtë zjarr jo! Këtu shumica rrijnë kot, ti i sheh dhe vetë, me një kafe kalojnë ditën...

— Leri betimet, më mirë më thuaj të drejtën!...

— Të them se kam vjedhur? !...

— Në qoftë se po, pse mos ta thuash?

Polka lëvizi kokën me habi. Vetullat e tij u bashkuan.

— S'të pëlqejnë fjalët e mijë? — e pyeti daja dhe e qëlloi në sup me bishtin e fshesës.

Polka s'lëvizi, as nuk kundërshtoi fare. Daja e qëlloi edhe njëherë. Pastaj iku, duke murmuritur me vvetvete. Më vonë, më pyeti mua:

— Po ti pse s'e ruan arkën, apo je bërë mashë e Polkës? !...

— Polka nuk vjedh! — i thashë unë.

— Të gjithë vjedhin në këtë botë; kush më shumë

kush më pak, ti duhet t'i bësh sytë katër... së je njeriu im...

Isha i bindur se Polka pas asaj ngjarje, do largohej përgjithmonë, po ja se ai as e zuri në gojë një gjë të tillë. Vetëm mua më thosh, me një zë të pikëlluar:

— Eh, more bir, si janë njerzit! Po ti mos u mërzit. Jeta nuk do të qëndrojë gjithmonë kështu. Jeta është si uji, ecën, rrjedh, ndryshon. Ti nuk do të kesh fatin tim, ishalla, më shpresë të Zotit!...

Ndënji ashtu një copë herë me kurrizin të këthyer nga zjarri dhe vijoi me një pikëllim më të madh, sikur fjalët i buronin nga thelbi i zëmrës:

— Njeriu është si kërpudha. Mbiva as unë s'dij përsë, jetova 60 e kusur vjet në këtë jallane, brodha qark nëpër të gjitha anët, po fundi?! E shoh se vdekja po më afrohet...

— Po ti je akoma i fortë!

Polka më vështroi me sytë e tij të dashur dhe foli me një zë sikur qante.

— Zoti ishalla më merr shpirtin pa zënë shtratin, se po të sëmurem, s'ka se kush më sjell edhe një gotë ujë. Në spital? Spitali do para, mor bir!...

— Një kafe — se kush thirri andej nga fundi.

Polka, u këhye pa qejf, si një vegël e kurdisur, dhe vuri xhezven në zjarr. Nga që flaka i binte në fytyrë, syt' e tij shndrishin si dy thënjgjij.

E zbrazi kafenë në filxhan dhe unë e shpura. Njeriu që kish porositur kafenë, një burrë topolak me nofulla të gjera, e quajnë Sefedin, por shkurt i thërrasin Sefë. Ky, me nji zë të hollë dhe të mërzitshëm, u tregonte disave se si kish marrë sifilis, se si gabimisht ja kish ngjitur gruas së vet, dhe se si tanë po rrekej t'ja jepte edhe një jevge që këndonte në kafe Vera. Të gjithë e dëgjonin me vëmëndje, disa e lavdëromin, ca të tjerë rrinin dhe e vështronin me një farë neverije dhe mëshire...

Befas, erdhì Jemini dhe muhabeti u ndërpre.

— Kush është për një katërshe? — pyeti ai, duke trokitur me gishtrinj si trumpetë mbi tavolinë. Dolën dy veta, po Sefedini, iu drejtua Jeminit:

— Ta bëjmë një lojë bashkë, një pér një.

— Me nga sa?

— Një frang dorën.

— Jo pesë, a?

— S'e mbaj dot pér besë, hajt dy franga dorën.

— Mirë, lere depozitën.

Me që unë isha aty në këmbë, depozitën m'a dhanë mua. Loja dukej të ish mjaft interesante. Daja dhe shumë të tjerë u grumbulluan ta shihnin se si do të përfundonte.

Sefa vështron me ato syt e tij prej kumarxhiu të regjur, dhe nga sikleti merr frymë si me zor; Jemini duket më i qetë, megjithëse edhe tek ai shihen shënjat e frikës; i shikon njerzit me një farë dyshimi, sikur do t'i pyesi:

— E, si ju duket, kam pér të fituar apo do të humbas?

Qysh në fillim, shansi anoi nga Jemini. Tri herë me rradhë s'e la Sefën të bënte xhap. Sefa po hidhte zarët e dorës së katërt, kur ja, befas, në derë u duk një grua me pamje të trishtuar. Polka e njobu me njëherë:

— E shoqja e Sefës! — murmuriti ai ngadalë.

Ajo bëri pérpara drejt gjindjes. Të gjithë i hapën udhë dhe aherë u duk Sefa, duke shternguar zarët në dorë. Gruaja qëndroi pérpara tij, Sefës se kush i ra me bryll. Ai e rrötulloi kokën nga e majta dhe pa të shoqen. Fytyra e tij u egërsua si shpina e një maceje kur zihet me qenin. Gruaja, duke u munduar të tregohej e urtë, i dha të kuptojë Sefës që të ngrihej. Po ai buzëqeshi në mënyrë aq nervoze, së edhe buzët i dridheshin dhe sytë i lëshonin xixa. Pastaj foli me zémërim:

— Mos ke ardhur të luash një xing? ! . . . Hej, Polkë, një palë letra xingu pér gruan time! . . .

E shoqja, një grua delikate, me sy të buavitur, i tha me të lutur:

— Eja të shkojmë . . .

Sefa e qëlloi në bark, me shpinën e dorës:

— Qërohu, në mos po t'i përshij hundet! . . .

— Po atë ku e lë? — pyeti ajo duke kërkuar në syt e tij të gjejë të vërtetën.

— Shko po të them, rezile!...

Gruas sikur i ra pika në vënd.

— Shko, dhe po qe ndo pak trimëreshë, ashtu siç po paraqitë këtu, më prit më darkë, në shtëpi... Ma njeh fort mirë damarin....

— Ku e shpure jorganin e fëmijëve?! — e pyeti ajo përsëri me zë të mbytur.

— Ajo është puna ime!...

— E ke shitur, ë?

— Shko pra! — Sefa u ngrit dhe i dha një të shtyrë. E shoqja u përplas pas murit. Ferekheja, me të cilën mbulonte trupin, iu hallakat; u duk një përparsë bojë hiri, e punuar me vegjë.

— S'ke turp! — murmuriti ajo.

Sefa u derdh mbi të, si i tërbuar; dikush i doli përpara, po Sefa e shtyu me sa fuqi kish, ahene vrapi Polka dhe ja zuri rrugën. Edhe Polkën e shtyu, bile e kerçënoi me grusht, po Polka s'u hoq. Ndërkaq gruaja ish larguar, duke lenë në vënd nallanet, një palë nallane të vjetra, në faqen e të cilave djersa kish formuar një njollë të zezë.

Pastaj Jemini e tërroi që Sefën dhe përsëri filloj loja, si më parë, vetëm se tanë, gjakrat ishin shumë të indezura. Dukej aqik se së shpejti do të fillonte një përlleshje e re. Mua më dukej se kjo përlleshje sundonte cep më cep Shqipërisë, kudo që kish njerëz.

Sefa, i dëshpëruar filloj të flasë larë e pa larë.

— Pusho aty se t'i derdh trutë! — i bërtiti Jemini.

— Edhe ti shiko lojën! Kështu më pëlqen mua, kam qejfë të shaj!...

— Mirë pra, edhe unë nuk luaj më! — foli Jemini, në zërin e në xhestet e të cilit vihej re një ironi therëse, ironia dërmuese e fitimtarit.

— Do të luajsh që ç'ke me të, se ndryshe...

— Çfarë do të bësh?

— Unë them se duhet të luash.

— Ja, mua s'më pëlqen të luaj.

— Po unë s'të lë se...

— Mos jam gruaja jote unë, more i poshtër?

Jemini i dha një shuplakë fytyrës; Sefa u hodh përpjetë, se ç'tha nëpër dhëmbë dhe doli jashtë duke bërtitur...

Gjysëm ore s'vanë atë e pashë përsëri në kafene duke iu lutur Polkës:

— Kam disa karrike dhe tri kuze bakri për të shitur...

— Po ti e di se unë s'kam familje.

— Jo, thashë sikur të m'i mbanje peng vetëm përsonte. Le të më japësh nga dhjetë franga?

— Asnjë grosh nuk të huaj ty!

— Hë, Polkë, nem se më ndjen zemra se sonte do të fitoj, të betohem ma ndjen zemra. Bile po ta tregojë edhe marifetin, kam përgatitur një palë zarë qyla. Do t'i grij njerzit, për besë, o Polkë, do ti rjep si kecér.

Polka rrinte dhe e vështronë pa folur. Sefa vazhdonte të flasë, gjithnjë me pretime më të mëdha, sepse i dukej se po ja arrinte qëllimit: — Dëgjomë, Polkë, ty kam për të dhënë gjysmat e parave që do të fitoj: kjo do të jetë një shumë e madhe që ty do të ta sigurojë pleqërinë...

— Po në humbësh? — e ndërpren Polka.

— Ja pra, po të le peng karriket dhe katër copë kuze bakri. A nuk të mjaftojnë këto?

Polka rrudhi supet.

Sefa u avit ngadalë dhe i tha me zë të ulët:

— Po të lë gruan, pra, o Polkë, a je i kënaqur tanë.

Polka e shtyu me neveri. — Shko, çou, mos më flit më, dëgjove? Edepsëz!...

Sefa mbeti me krahët të ndeme. Ajo fytyra e tij e vrarë nga sifilisi iu rrudh si një qyp i krisur. Polka përbërtiti përsëri:

— Ik se më dhëmbin sytë kur të shoh!...

Ai iku duke lenë pas një erë të rëndë, si cjad i patredhur.

Polka pështyu pas tij dhe foli duke kërcelluar dhëmbët:

— Hajvani, edepsëzi, s'ka turp! E dëgjove se ç'më iha?

— Jo, — e gënjeva unë.

— Sa mirë, shyqyr që s'e ke dëgjuar se do tē mos e harroje térë jetén dhe mua do tē mē mallkoje që kam tē bëj me tē tillë horra... Eh, kur rri e mendoj, gëzohem që s'jam martuar...

— Horri! — kthehej përsëri tek Sefa, — rezili. Ç'është një ay, ti nuk ja njeh xhënsin atij qen e bir qeni! I ati ka qenë një fajdexhi që e ka rjepur fukaranë! E mbaj mend mirë, si tanis: ishte një shpirtzi që aman o zot! Kur i biri hynte në dyqan, ja ky Sef maskaraj, i jati u thosh tē tjerëve që ishin aty: vështrojeni çfarë sysh tē zgjuar që ka asllani im, keni pér tē parë, po s'u bë zot i térë këtij pazari... — Kur nuk ရှုံး e ta shihte se ç'hallall ka lénë pas, se si vjen rrotull pér tē lenë peng edhe gjërat mē tē nevojëshme tē shtëpisë!.. edhe... — Polka heshti, ra në mendime, pastaj tha duke psherëtirë:

— Mirë thonë se zoti vonon, por kurrë s'harron... Kurrë!

Nata po zbret dhe bashkë me tē edhe tē ftohtit, një tē ftohtë që tē pret fytyrën; pazari zien i téri nga një zhurmë e bezdisëshme: kovaçët rrahin me tèrbim hekurin e skuqur, hamajtë thërrasin me dëshpërim: «Hamalli me radio»; telallet, ca plaka llafazane s'pushojnë si ato gjinkallat, ndërsa një salepxhi, thërret sa mundet:

— Hajde saleb me pite.

Hamejtë e ngacmojnë salepxhinë me fjalë tē ndyta.

Shpirtërat e këtyre njerëzve që bredhin pa qëllim në-për pazar janë pushtuar nga nervoziteti. Ja dy veta u kacafytën befas si kafshë dhe térë dyqanxhijtë dalin e bëjnë sehir. Të tilla ndeshje ndodhin shumë herë, gati çdo ditë. Unë, Polka dhe daja s'kemi kohë t'i shohim, me që jemi në valën e punës. Duhet tē përgatitemi mirë pér t'i bërë ballë atyre që do ta kalojnë natën e vtit tē ri në kafenenë tonë. Daja ka blerë shtatë palë letra tē reja, fytyra e tij zeshkane, e mprehtë dhe e lodhur nga që ka kaluar një jetë tē zbrazët, ka filluar tē gjallërohet. Mendimi se atë natë mund tē fitojë një shumë tē madhe e gëzonte dhe sytë i shkëlqejnë plot lumburi. Me mëngë tē përveshura gjer në bryl, ai jep udhëzime tē

shpejta; mua më porosit që t'i kem të mbushura katër të neqet me ujë, hoka e kafesë të jetë gjithmonë me sheqer e kafe. Folkën e ka caktuar të pjekë kafe dhe të marrë anallikun.

— Veresija sonte ndalohet për të gjithë! — dha si porosi të fundit.

— S'dij përsë Polka është shumë i pezmatuar; ato vetullat e tij të dëndura, gati sa s'po puqen; balli i është rrudhur jashtëzakonisht dhe mua më duket sikur ai është gati t'ja nisi të qarit. Këtë gjë e vuri re edhe daja, dhe i tha me një zë të butë:

— Ç'ke kështu sonte?

— Asgjë.

— Më duke i dëshpëruar...

— E po njerëz jemi, ndodh që ngatërrohen zorrët e barkut e jo më ne.

Daja ja preu si me brisk:

— Të paktën, këtë zemërim ta lesh për ahere kur s'kemi punë, dhe jo në ditë feste...

Polka u shti sikur s'i dëgjoi këto fjalë: hodhi në oxhak nja dv grushte qvmyr, i mbushi bulçitë gjithë frymë dhe filloj t'i fryejë zjarrit.

XII.

I pari që erdhi në kafene, natën e vitit të ri, ish marrangozi Nuz Shijaku. Pas tij erdhi Bilbil Meta, që u ul mbi taftakun këmbëkryq, nxori kutinë e duhanit dhe më porositi:

— Më bjerë një gotë ujë, o çun!

— Qënke si pa qejf sonte, o Bilbil? — e thumboj daja im.

Bilbili buzëqeshi dhe tha:

— Sonte kam vendosur të mos luaj...

— Megjithë mend? !...

— Po, po, kam ndërmend të pij dhe të shoh të tjetrët. Po ti, o Nuz?

— Edhe unë ashtu si ti, o Bilbil; pse të luaj kur e dij se nuk fitoj?

— Si, s'paske pér ta provuar fatin? — e thumboi pérseri Bilbilin daja im.

— Fatin? Po a ka fat më të mirë se i imi? Hajde fatë, hajde. Fukara, pa babë po më e keqja është se as e di cili ka qënë babaj?

Polkën sikur e sollën në vete këto fjalë. Qëndroi befas me ato këmbët e tij të mbledhura shuk, dhe tha:

— Mos u qaj, o vëlla, se ka edhe më keq...

— Më keq se unë, o Polkë?

— More vëlla, ti s'njeh babën, po unë nuk njoh as babë, as nanë.

— Ah më mirë pér ty! —

— Aq më mirë pér mua? — pyeti Polka me habi.

— Të paktën ti ke të drejtë të mendosh se ke lindur edhe nga një derë bejlerësh dhe kjo të bën të lumtur, kurse unë...

— Lumturia s'është gjë tjetër, veçse një èndër, more vëllezër, — e ndërpren Nuz Shijaku i kredhur në mejtime.

— Ja se kush rron i lumtur, — briti daja im kur pa në derë Milto Zhukon, usta i zoti, një burrë shpatullgjerë, me tamtha krejt të thinjura.

— Ku e keni fjalën? — pyeti Miltua duke u munduar të marrë vesh pér çfar po bisedonin.

— Ne themi se ju kaurrët, jetoni të lumtur.

— Tamam ashtu është! — pohoi Miltua duke buzë-qeshur. — Turku ka lypur dinë e imanë, kaurri pilaf, gra të shëndosha dhe vërë. Bilbibli e ka kot që s'më beson mua...

— Pér çfarë të besoj ty? — e ndërpren me nxitim Bilbili.

— Që ju çalamanët jeni gomarët tonë. Atje në botën tjetër juve do të bëhi gomarë dhe ne do t'ju hypim...

— Shko, mor laskuriq — foli i zemëruar Bilbili.

— Dhe unë kam pér të të zgjedhur ty, o Bilbil, — vazhdonte të tallej Miltua duke u çkulur së qeshuri...

Befas, si një re e zezë, u përhap lajmi se Sefa kish mbytur të shoqen. Nuk më kujtohet kush e tha, po mbaj mend se Polka u bë dyll në fytyrë dhe i mbylli systë përgjysëm, duke murmuritur diçka me vete.

Miltua tha:

— Derri i derrit, paska bërë dy faje: një që e mbyti dhe e dyta që nuk e la të fillojë vitin e ri! Shën Vasili është i shejtë, or vëllezër!...

Daja shtoi:

— Më duket se e ka pasur edhe me barrë! ...

— Ahere paska bërë tre gjynahe dhe ta dini, o burra, se shpirti i tij do të vuajë shumë.

Kur erdhë kapter Selimi, një burrë me fytyrë të gjerë, na e tregoi fije e për pe ngjarjen e shëmtuar. Sefa na kish renë në udhi me Jeminin për t'i lenë peng katër karrikut dhe katër kuzet bakri për 9 franga. Mirëpo kur ky kish vajturi t'i marrë, e shoqja nuk ja kish dhenë. Ahere Sefa i kish hequr një dru të mirë. Po e shoqja meazalla se i çqitej. Sefa ish tërbuar keq; kish kapur sëpatën dhe e kish qëlluar mu në kokë... dhe e mjera grua kish mbeetur e vdekur në vënd.

— Po Sefa ç'u bë?

— E arrestuan.

— Po Jemini?

— Jemini s'ka asnijë faj në këtë mes...

Ra një heshtje e trishtuar, nië heshtje që ta gërvishët shpirtin. Dikush tha: — A fillojmë një katërshe, pa Sefës në rroçkët i goftë...

— Mirë — u dëgjuan dy a tre zëra.

Postat u ndanë. Kumari filloi. Në një gjysëm ore, kafeneja u mbush plot. Polka, i raskapitür nga një lodhje që e pushtoi pas atij lajmi, më porositi:

— Sonte do mos qëndroj gjér në fund; s'e ç'kam këshfu, më ziret fryma dhe në zëmër ndjej një sëkëlldi të madhe.

— Mos kij merak se i bëj unë të gjitha.

Fytyra e Polkës, ajo fytyrë me tipare të dashura, m'u duk sikur kërkonte të më falënderonte. Po unë ika, duke u treguar më i shkathët se çdo herë tjetër.

Ajri prishet, një zhurmë monotone, si koshere ble-tësh, na bie në kokë.

Polka herë herë e zgjat kokën për të parë se si vete kumari dhe më thotë:

— Sonte kushëdi sa familje mirren në qafë, shkatërrrohen për të mos u ndrequr më kurrë, dhe befas syt e tij, me një shkëlqim të kristaltë, sikur erresohen.

— Ç'ke? — e pyes.

— M'u kujtua e shoqja e Sefës; e mjera grua, sa rrojti hoqi si krimbi ndën gur dhe në fund, si shpërblim, mori një sëpatë kokës. Po sikur t'i kisha huajtur Sefës 10 franga, mbasë nuk do ta kish bërë një gjë të tillë, apo jo?

Unë nuk dija ç'ti përgjigjesha.

— Prandaj sonte jam aq i pikëlluar, sa s'bëhet. Po prapë, them se ai vagabond në mos sot, nesër, pa tjetër, aty do të përfundonte!

— Sigurisht.

Polka ndjen një lehtësim në ndërgjegjen e tij.

Dëgjohet një e bërtitur e fortë:

— Shën Vasil, o i poshtë!

Qeshje, pshérëtima dhe mallkime ngrihen si një tufan.

Aty nga ora dymbëdhjetë, në lojë u fut edhe Nuz Shijaku. Në fillim me nga dy lekë dorën, pastaj u bë ortak me Milton dhe loja arriti deri në pesë franga dorën. Miltua rri në këmbë, rra krabun e Nuzit. Kur e lvp puna e këshillon Nuzin, po Nuzi për të mos i ikur shansi, bën gjithmon të kundërtën. Miltua largohet i zemëruar, shkon në një postë tjetër, pastaj vjen tek Polka dhe i thotë:

— E kush ka parë haiër prej Nuzit që të shoh unë...

— Po pse u bëre ortak, rrë?

— Ai ja mbush mendjen edhe diallit vetë!

— Hajt se sonte do të fitoni i tha Polka — se njeriu që nuk bën niet për të loitur, fiton me siguri.

— Dreqi e di! — Miltua nxitoi të shohë se cngjan nië nostën ku luante Nuzi, sepse u dëgjua një zhurmë e madhe.

Vura re, se Miltua u bë dyll në fytyrë. Nuzi me një dorë kish humbur tërë paratë. Po megjithëkëtë, prapë nuk donte ta lironë vendin.

— Po kur s'ke para, ç'rri më? — i tha dikush.

— Njeri prej jush do të më japë hua 10-15 franga.

— Ik, ore, lerna rehat, s'kemi ardhur të ndajmë sadaka këtu; ke apo s'ke?

Ay që fliste ishte një burrë me fytyrë të gjérë, me dy gusha dhe me qafë të trashë, aq të trashë, sa këmisha s'e nxinte. — Apo mos do të lësh peng ndonjë plaçkë?

Veç në lënca xhaketën — tha Nuzi i pushtuar nga flaka e tmerrshme që ngjall kumari për të vazhduar lojën.

Qafëtrashi e shikoi me vrejtje xhaketën dhe i tha:

— Hiqe për 8 lekë.

— Ç'thua, tetë lekë! je në vete?

— Për mua s'bën më tepër.

— Merre për 14 lekë.

Asnjë qindarkë më tepër. Çou tanë, lëshoja vendin një tjetri.

— Po për 12 lekë?

— Asnjë qindarkë më tepër, ta thashië, éshtë e kotë që bëjmë pazarllék.

— Oh, qenke katil i keq! — tha Nuzi duke e shikuar me urrejtje të madhe atë fytyrë të ndotur nga dhjani i tepert.

— A e di ti se më ato 8 lekë mund të na i fitosh paratë të gjithëve?

Nuzi u mendua dhe pastaj, tha:

— Mirë pra, na merre!

Nuzi e hoqi xhaketën nën shtytjen e të tjerëve që prisnin të vazhdojë loja e ndërprerë.

Polka tundi kokën, fërkoj fytyrën e tij me pëllëm-bën e dorës dhe foli, me një pikëllim të madh.

— Allahalla, cili do të jetë fundi i këtij vendi të mjerë? !...

— Cili éshtë ai qafëtrashi? — e pyeta Polkën.

— Éshtë kumarkhi i vjetër, punon në Ministrinë e Financave.

Përsëri buçiti një potere e madhe. Dikush bërtiti:

— Ta rrofshā mjekrén, o Shën Vasil!

— Më like, o Shën Vasil!

Një zë i trashë zotroi mbi të tjerët:

— Në të zënshtë, o Shën Vasil, nuk do të ta rrugë
mjekrén, por do të t'i shkul qimet me piskatore....

* * *

Nuzi i la edhë paratë e xhaketës.

— Po tani ç'do të veshësh? — i qau hallin Polka.

— Ja, kështu do të rrij, — foli Nuzi duke nxjerrë gjuhën jashtë, me të cilën i dha një llüstër buzëve të thara e të çara plasa-plasa, si një tokë e djegur pér shi. Pastaj shtoi, si i menduar:

— Kisha gjithsejt tre dollarë, i pata fituar me një-qindmijë belara, tani i humba në një orë; po lere, unë faqeziu kisha vendosur të mos loja son te: edhe ai dreq kaurri s'm'u nda luaj që luaj!

— Shko, mo, qërohu! — ja priti Miltua, i zemëruar.

Pastaj Nuzi murmuriti i prekur në shpirt:

— Kush i vete gruas në shtëpi pa pallto! A e di, Polkë? Xhaqeti ishte i tim biri që më vdiq dhëndër një viti. Papapa! — mbylli sytë si i turbulluar.

— Do një batanije? — e pyeti Polka.

— Mirë, nema, sa ta hedh krahëve gjer në shtëpi.

Polka nxori nga rafti një batanije të murrtë dhe ja dha duke më porositur mua:

— Shko gjer në shtëpinë e Nuzit dhe kthehu me batanjen. Mos kij merak pér dajën, i them se të shpura unë...

Pranova. Sapo dolëm, Nuzi e hodhi batanjen mbi kurri.

Bënte të ftohtë dhe këtë e shtonte era që frynte nga veriu, një erë e akullt që ta mpin fytyrën. Qielli ishte i errët si pus.

Pér mua ishte hera e parë që rrija kaq vonë dhe kjo më tronditi shumë, m'u duk sikur edhe unë do të kisha të njejtin fat, si këta njerëz të mjerë; herë herë e ndjeja veten krenar që, megjithse i vogël, merrja pjesë në punë të tilla që u takojnë vetëm burrave.

Nuzi çfryu téré udhës, duke murmuritur me vehte
ca fjalë pa kuptim. Unë e pyes:

— A keni fëmijë.

Ai më përgjigjet duke shikuar vetëm përpara, si ai
kali më pergo:

— E ç'punë ka fukaraja? Veç aty e ka mendjen,
tek...

Foli dhe qeshi po vetë. Pastaj, nisi të fishkullojë nga-
dalë, po përnjiherësh heshti, pështyu me zemërim dhe e
shpejtoi çapin.

Ecën pa folur gjer sa mbrritëm në shtëpinë e tij. Nuzi
ë hoqi batanijen dhe ma dha: — Shko tani, natën e
mirë...

— Natën e mirë — dhe ika.

Filloi një shi i imtë, sikur sitej në qiell. U mbësh-
tolla me batanije. Isha i lodhur dhe i raskapurit për gjumë.

Pazvani, një plak, me një kapotë të vjetër, shkon qe-
pen më qepen; një i dejur zvarriset nëpër mur, kurse
ngë pijetoret, shpërthen një valë e téré zérash të tmerr-
shëm. Dritat elektrike janë të rralla me njëra tjetrën, kësh-
tu që, njeriu shpesh herë humbet në errësirë dhe aty
këtu këmba zhytet në gropë uji. Befas, buçiti një zë,
pastaj u dëgjua oshëtimë e një bilbili. Dy a tre veta vra-
pojnë nëpër errësirë; dëgjohen ca zëra: — kapeni hajdu-
tin! Hajduti!

Unë qëndroj në një vend dhe s'dij c'të bëj. Më pushton
një frikë e madhe aq sa më duket se zemra do të më pushojë
nga çasti në çast. Mundchem të imagjinoj gjëra të gu-
ximëshme dhe për këtë më ndihmojnë veçanërisht përra-
llat e nënës. Shkova përpara, me frikë. Befas në një qo-
she, në errësirë, dëgjova një rrënkim. Mbajta vesh; rrën-
kimi i një njeriu që po hiqte shpirt, përhapej ngadalë,
si një gérhitje e lehtë.

— Kush je? — pyeta me një zë që m'u duk se s'ish
imi.

— Ndi...hmë — arritën gjer tek unë këto fjalë të
shkëputura.

Vajta dhe ja, përpara, kam një njeri të shtritur që shtërngon gjoksin. U mundova ta ngrejë në këmbë por ai ish tepër i rëndë dhe trupin e kish të çlirët si një calik vaji. Ahere ja futa dorën në gjoks: e kish të ngrohtë dhe të lagët nga curili i gjakut që i rrithët pa pushim.

— Më vranë, o mik, me të pabesë — tha dhe vura re se sytë e tij shkrepëtinë me një shkëlqim të çuditëshëm.

— Kush?

— S'i pashë, po, me sa m'u duk; ishin me rroba ushtarakë, oh...

Përsëri u përpoqa ta ngrejë më këmbë, po ishte e pamundur. I plagosuri ra përnjëherësh përbys, me faqe në kalldrëmin e skuqur nga gjaku i tij. Rënkoi edhe një dy a tri herë dhe s'u ndie më. Vdiq ashtu pa zhurmë, si një yll që shkëputet nga qielli në një natë vjeshtë.

Unë u largova me vrap dhe kur mbrrita në kafene ja tregova Polkës të gjitha gjërat me një frymë.

— Mos folë me njeri, se na fike të tërëve! — më tha ai me një ton bindës. — Lutju Zotit që s'të ka parë njeri aty, se përndryshe do ta pësoje shumë keq.

— Po ai më tha të tregoj se ata që e vranë ishin ushtarakë...

— Pusho, po të them!

Ish e qartë se duhej kyçur goja. U ula atje mbi një fron të thyer, dhe u përpoqa të largoj nga sytë, atë ske-në të tmerrëshme që më ish ngulitur fort në tru. Polka më solli një çaj dhe më tha duke më përkëdhelur në kokë me dorën e tij:

— Unë të dërgova me Nuzin se më erdhi keq përtë. Me 'të kemi qënë shokë të vjetër. Bashkë kemi bërrë luftën e Shkodrës, atje unë u plagosë në kofshë. Ish rrezik të më kapnin të gjallë. Nuzi më ka ndihmuar më tepër se vëllai jem. Edhe unë tani ja shikoj hatrin, si vëllaut tim, se ka shpirt të mirë. Mos pandeh ti se ata që pinë janë njerëz të ligj?... Më thuaj ti, ku të vejë njeriu përvëç se në mihane. Me se mund të shkohet dita sot? Dhe kur s'ka punë përhapet kopukllëku, doemos që përhapet! Eh, more pëllumb, ti nuk e njeh jetën!...

Heshti dhe pastaj foli shumë për luftrat, për trimëritë e tij e të shkëeve të tij dhe të gjitha këto punë e kuptoja se ai i bënte për të më larguar frikën që vizatohet e qartë në fyttyrën time.

XIII

Dy ditë pas Shën Vasilit, qyteti ra në një çlodhje të thellë. Tërë zemërimi i asaj nate shkatërrimtare filloj të shpërndahet, siç shpërndahet mjergulla nga një diell i fortë.

Po prapserap, unë akoma e ndjej veten të tronditurdhe ajo skena e tmerrëshme e asaj nate, s'më ikën nga mëndja.

Në mesditë, Jemini, po i tregonte dajës dhe Polkës:

— Natën e vitit të ri, e kalova duke lojtur në shtepinë e Lal Krosit. Ishim të gjithë duar të zgjedhura. Tri herë me radhë, o Polkë...

— Po pastaj?

— Pastaj, dreqi më ndihmonte dhe përsëri fitoja shuma të mëdha.

— Po fundi?

— Fundi qe ky: unë fitova 25 napolona, Lal Kroso fitoi mbi 200 napolona, po ashtu fitoi dylberi i Lalës, titoi edhe Musa Juka, nja 7 a 8 napolona. Shumë humbardi Rem Shoshi, Nazmi Peia dhe nia dy tregtarë që kishin ardhur apoçtafat nga Shkodra. Për fjalë të nderit, qimet e kokës të ngriheshin përpëtë me një të hedhur zaresh...

— Po Sefa ç'bëri ashtu me gruan? — e pyeti dajës Jeminin.

— Po pra!...

— Maskaraj! — tha Polka.

Jemini tha me krenari:

— Po unë nuk lashë pa ja marrë karriket dhe kuzet e bakrit...

Polka i ktheu kurrizin me neveri, kurse daja heshti. Jemini vijonte të tregojë:

Kur Sefa kish mbytur tē shoqen, unë isha mbyllur nē dhomë me Kumen. Kumja u tremb shumë, kish frikë se mos më bënин gjë mua... Filloi tē qajë, tē më puthë duar e sy. Pastaj shkova nē polici; aty gjeta Sefën. — E mor pelivan? — i thashë — do tē më japësh paratë, apo tē marr mallin! — Bëj q'të duash — më tha pa më shikuar nē sy...

Nga që s'e duroja dot Jeminin, dilja nē sokak. Punë s'kishim edhe aq, festa sikur i shkundi xhepat e njerëzve. Rrij dhe vështroj çdo gjë me vëmëndje: Qielli është më i kaltërt se çdo ditë tjetër, dielli shkëlqen me një shkëlqim shumë tē kulluar. Në kalldrëm, zbresin me irikë dy harabelë; nē fillim shohin pale mos qëllohen pastaj fillojnë dhe mbledhin me një shpejtësi tē madhe kokrat e grurit e tē misrit — tē mbetura nga dita e pazarit. — Aty pranë derës së kafenesë, matrapazi Riza Kavaja, një njeri që askush s'i zë besë, rreket tē mashtrojë një fshatar. Fshatarit i ka blerë një qyp me gjalpë, po paratë kërkon t'ja japë mangut. Unë çuditem me paturpësinë e këtij njeriu.

— Mbaje dorën — i thotë fshatarit për tē dytën herë, — thuaj një.

— Po hidhe pra lekun që tē them një! — u zëmrua fshatari.

— Tuhat njeri! — përsëiste matrapazi. — Ti thuaj një, pastaj vazhdojmë.

— Mirë pra, një.

Atëherë, matrapazi i hodhi nē dorë lekun e parë dhe vijoi tē numërojë shpejt e shpejtë: dy, tre, katër. —

Po nē tē vërtetë aty një lek ish mangut. Fshatari ja ktheu përsëri, po matrapazi prapë filloi nga e para. Po fshatari s'e hëngri që s'e hëngri.

— S'ja hodhe dot — i thashë matrapazit kur iku fshatari.

— Pse?

— U përpoqe t'i vidhnje një lek.

— Kurse ai më vodhi 8 lekë.

— Po qypi me gjalpë?

— Se mos rrëxoi malet ai për këtë gjalpë! Delet i

ka, i mjel, u merr qumështin dhe ja ku e nxori gjalpin. Kurse neve, për të fituar paranë, na bie bretku. A e dë ç'do të thotë sot një lekë? A e shikon se si sillen njerëzit pa punë? Ja, tek i ke përpara kafenesë. Leku sot është prefekt, t'i vesh dy buaj, s'e tërheqin dot...

Mori me kujdes qypin me gjalpë dhe më pyeti:

- Po ti, a e vjedh ndopak ustani tênd?
- Unë tê vjedh??!
- Pse çuditesh? Mos e quan vehten esnaf!
- Asnjë grosh nuk vjedh unë!...
- Lere atë, a nuk tê pashë një mbrëmje duke e rrotulluar arkën për tê nxjerrë paratë nga vrima? Pse gënjen që s'vjedh?!...

U gëzova shumë që s'kish njeri aty ta dëgjonte, sepse kushdo që tê ish, fjalët e tij do t'i merrte për tê vërteta. S'e zgjata më tê, por ai shtoi:

— Më ke një kafe borxh, në mos po do t'i them us-tajt tênd se ti e vjedh. Dhe duhet ta dijsh, se ustaj do tê më besojë mua dhe ty do tê tê dëbojë si hajdut... Kështu është: edhe djalë tê tê ketë, ka për tê më zënë besë muá dhe jo ty... se njeriu beson atë që i leverdis...

XIV.

Matrapazi më bëri tê flas për ata që sillen pa punë. Qëndrën e kanë tamam aty përpara kafenesë sonë. Këtu shoh shpesh herë tê rrijnë nga mëngjesi gjer në darkë, Nuz Shijaku, Milto Zhukua, Salë Derhem, e shumë tê tjerë që presin tê zejnë punë. Disa ulen këmbëkryq mbi kalldrëm, ca tê tjerë pështeten mbi kazëm, ose me shpatulla në mur. Bilbil Meta, shtrihet sa gjérë e gjatë, dhe fletë deri sa ta zgjojë ndonjë shok.

- Sa vajti ora? — pyet Bilbili duke fërkuar syté.
- Sa i afrohet dymbëdhietës.
- Medet, iku edhe kjo ditë pa punë!...
- Dhe sa tê tjera do tê ikin! — jehon plot vajtim zëri i shokut tê tij.

Të mjerët ata! Ka raste që nuk zënë punë me dorë një javë të tërë. Kur ndonjëri gjente punë, kjo ish ngjarje me rëndësi. Në të shumtën e rasteve, ata punonin dy ose tri ditë në javë; ditët e tjera i shkonin duke kerkuar punë, ose duke bredhur kafeneve sa për të kaluar ditën.

Ndonjëherë, më porositin t'u shpie kafe; si e pijnë, më paguajnë. Plaku Riza Hoxha, më thotë me shaka:

— Mirë, more piçiruk, po kur s'ka punë ç'farë të paguajmë?

— Mos pi kafe — i thotë Nuz Shijaku.

— Po ma do mideja, more Nuz!

Milto Zhukua ja pret, duke e lëvizur metrin me dorë:

— Mideja i do të gjitha, por kush e dëgjon?

— Tamam se njeriu është si ariu! — foli si i penduar plaku Riza: — A ngopet ariu ndonjëherë?

— Po ariu është kafshë — tha Bilbili.

— Aferim që e ditke! — tallet Miltua.

— Edhe ariu ka qënë njeri — vijoi plaku Riza. — Quhej Ali. Punonte si furrxhi dhe një ditë prej ditësh vajti në nevojtore me duar plot brumë; kështu që Allahu e dënoi dhe e ktheu nga njeri në ari...

Kumixhiu Salë Derhemi, një burrë leshator, me duar të forta, tha me zérin e tij të ngjirur:

— Sikur të jetë e vërtetë kjo që thua, qysh tanë do të shkonja në nevojtore me brumë në duar, mjafton që të bëhesha ari; të paktën si ari do të jetoja nëpër pyje...

Nuz Shijaku, i cili, në vënd të xhatetës që la peng, ka veshur një mitan të vjetër, tha si nëpër gjumë:

— Jemi njerëz, po rrojmë më keq se kafshët.

— Kështu e kajeta, — u mundua të zbusë zemrat plaku Riza. — Heqim këtu, për të siguruar një copë vënd atje në xhenet...

— Shpirti ynë s'ka vënd në qill, as në tokë! — vijoi Nuzi me një zë prekës. — Ato që besojmë, janëën dra me sy çelë.

— Shko, mor dinsëz! — i bërtiti plaku. — Ti ke dalë nga feja që kur ke lindur.

— E ke gjetur, për besë! — pohoi Nuzi. — Im atë ka qenë hoxhë.

— Kurse i biri na doli shejtan — ja priti Miltua.

— Bëhu i hajrit, — më këshillonte babaj, — mos gënjë njeri, mos i hyr kërkuj në hak; zoti të jep atë që i kërkon, shko në xhami, duaj nënë e babë, se do të shkosh në xhenet.

— Ç'ta dua xhenetin? — i përgjigjesha unë... — Atje shkojnë vetëm njerëz të urtë, hoxhallarë dhe tregëtarë, kurse në xhehnem shkojnë këngëtarët, pijanecët... Atje pra njeriu s'mërzitet, gjen këngë dhe dashuri.

Bilbili qeshi me ato buzët e tij të përveshura; dikush ja priti:

— Ej shokë, kush vjen në pijetore?...

Asnjeri s'foli. Kumixhiu Salë Derhem u afrua tek unë dhe më pyeti:

— Ç'bën yt atë tanë?

— Pse, e njeh?

— Si s'e njoh! Kemi punuar bashkë kaq kohë. Më parë unë kam qenë usta, po e lashë atë zanat se më binte pasërrëgëlla...

Sala fliste, po unë dëgjoja edhe fjalët e atij që i ftonte të tjerët të shkonin në pijetore:

— Jua them unë se sot asnjeri nuk do të zërë punë, ja, ora vajti njëmbëdhjetë... dje me zor i kapa nja dy lekë; hajde, kush po vjen?...

— A më qëras një gotë? — e pyeti një burrë i gjatë, me bel të hollë dhe me fytyrë të dobët, i cili kish vënë në brez një sqepar me bisht.

— Hajde, po ta jap një, pa meze. —

Sala vijonte të më fliste: — Unë dhe babaj yt kemi punuar në ndërtimin e bashkisë, bashkë hodhëm themellet e ministrive. Kemi ndërtuar edhe shumë shtëpi; është i zoti yt atë, po të shkretin e gjeti rreziku. Pension a i kanë dhënë?

— Jo.

— Po ai u rrëzua nga një ndërtesë shtetore!...

Sa i thashë «po». Sala u grit befas dhe i doli përpëra një gruaje, po më mirë një zonjë plakë, që po vinte, siç dukej, për të kërkuar ndonjë punëtor.

— Me çfarë merreni ju? — pyeti ajo me një zë të dobët.

— Me kinkaleri — u tall Miltua.

— Me çfarë?! — përsëriti pyetjen ajo duke e zgjatur kokën si breshkë.

Nuz Shijaku foli për të gjithë:

— Këtu, zonjë, ke ustallarë, marangozë, xhamaxhij, qërpixhij, kositës bari, me pak fjalë nga të gjitha zanatet. Zotrote për çfarë ke nevojë?

[Plaka nduku pak buzët e saja të vyshkuira, dhe tha si e kredhur në mendime:]

— Mua m'u desh një pastrues nevojtoresh.

Nuzi dhe Miltua u shikuan sy më sy.

— Hajt se po vij unë — tha plaku Riza Hoxha.

Plaka e shikoi me ata syt e saj si turjelë dhe e pyeti:

— Sa do në ditë?

— Hajt, moj motër, se s'prishemi, ose po deshe e marr qesim.

— Vemi e shohim, pra — tha plaka.

— Mirë.

Nuzi i tha Miltos:

— Për fjalë të nderit, isha gati të shkoja edhe unë.

— More vlla, edhe unë atë mendoja. Jo nevojtore, po jam gati të bëj çdo lloj pune, mjafton të quhet pune. Se kur shkoj në darkë në shtëpi, më del përpëra vajza e vogël, m'i kontrollon xhepet, s'len vënd pa më shikuar se mos i kam blerë ndonjë petë sheqeri... Oh kjo botë e mallkuar!...

Polka kish të drejtë kur më thosh:

— Pleqtë duhet t'i nderosh tepër. Pleqtë e kësaj kohë, nuk janë si të të gjitha kohëve. Sot, o pëllumb, është zor të jetosh, pra është zor të mplakesh... A më kupton ku ta kam fjalën? Them është zor të mplakesh, sepse shumica nuk arrijnë të mplaken nga që jeta i pëlcet,

ashlu siç pëlcet gjinkallat ajo vapa e madhe. A më kupton?...

Gjithë pazari, bile gjithë qyteti, aherë, bënte një jetë të cthurur.

Të vinte të pëlcisje sidomos kur shihje tregtarët duke u tallur me të papunët.

— Ej, Nuz, a më mban mbi kurriz katër herë rresht këtu e gjér tek sahati? Po e bëre këtë, do të të jap një grosh, të blesh gjysëm groshi, bukë, gjysëm groshi qofte, se e shoh që po të bie të hollët për të ngrënë. —

Ky që fliste ishtë tregëtar manifature, një burrë rrëth 30 vjeç, trashalujq, kokënj e kish të madhe, flokët, vetullat dhe qimet e faqeve i kishte fare të bardha.

Miltua mbronte Nuzin dhe hidhej kundër tregëtarit:

— Kur je sajuar ti, o Tajar, nënës tënde duhet t'i ketë marrë drithë aparati.

Të gjithë qeshnin, po tregëtar thosh duke nxjerrë një pakon me dollarë:

— A i shikon? Të jap tre dollarë, po të dalësh soka-kut, pa brekë...

— Nemi — i përgjigjej Miltua — hajt, jam gati t'i heq — dhe bënte sikur zbërhente kopcat e pantallonave.

Tregëtar zgërdhihej dhe i fuste paratë në xhep; ahere Miltua i afrohej dhe i thosh ngadalë: — aparati i nënës i ka fajet, pa do të ishe vërtet djali më i bukur i Tiranës...

Nuzi qëshite me lot nér sy.

Po t'i vesh re mirë, edhe tregëtarët bëjnë një jetë të mërzitëshme. Ata janë të detyruar të jetojnë në atmosferën e qelbur të kësaj jete, të bëjnë po ato lëvizje monotonë: në mëngjes çelin dyqanet, çirakët i pastrojnë, fillon tregëtia, pastaj tregëtarët dalin nën tëndet e dyqaneve, tallen me një derdemen të gjorë që e ngacmojnë me fjalë të ndyta, ose ndërsejnë dy çirakë të përlahen fytas me njeri tjerin, ose bëjnë sehir luftën e ashpër që ndizet në mes dy patokëve. Njera nga ato zavitjet e mërzitëshme të tregëtarëve që s'e kam harruar dhe nuk do ta harroj kurrë, ka qenë ajo e rrähjes me ariixhijtë. Ishte

ditë e premte; një grup arixhinjsh zbatohur, me trajsat e tyre në krah, po shkonte nëpër pazarin e vjetër, duke kuvenduar arixhiçë, me zë të lartë. Befas sikur të kishte zbritur nga qilli, ra mbi kurrizin e një arixheshe një dac i zi: arixhesha lëshoi një britmë tmerroni jëse dhe e vërtiti dacin në xhamin e një dyqani: xhami u bë copë copë. Aherë u mblodhën tregëtarët dhe bënë gjyqjin: Si folën deri sa u lodhën, vendosën që arixhijtë të paguajnë një dollar. Të gjithë arixhijtë filluan të bërtasin dhe njeri nga ata, një djalosh zeshkan flokëzi, me mustaqe të holla spic, tha duke vendosur qetësinë tek arixhijtë:

— Mirë zotnia, neve paguajmë xhamin, po macen kush na e hodhi?

— Unë nuk dij kush jua hodhi! — tha këpuctari, të cilil i ish thyer xhami.

Po as ne nuk paguajmë pra! — Tha arixhiu me vendosmëri.

Bardhoshi Tajar, ai tregëtar i manifaturës, iu gurfur arixhiut me grusht. Arixhiu s'lëvizi fare nga vëndi dhe nuk dha asnje shenje frikësimi.

— A nuk keni turp? — bërtiti qeleshxhiu Murat Topalli, — i thoni vehtës esnafë. Po ç'esanfë jeni ju kur nuk dini të shtroni pesë arixhij?!... Dhe i doli ballë për ballë arixhiut të ri.

— Paguaj paratë, arixhi i qelbur! — i bërtiti duke e shkundur për supi.

— Zotnia, na tregoni kush na e hodhi macen në kokë se una paguaj paratë — foli përsëri arixhiu duke u munduar t'i heqë dorën Muratit.

— Pse, borxh ju kemi ne t'ju tregojmë kush jua hodhi macen?!

— Macen m'a hodhët juve! — bërtiti arixhesha.

— Shko, moj lavire, hajdute! — i bërtiti asaj Murat Topalli.

— Hajduta jeni juve — tha arxhiu i ri, duke e shqiptuar keq shqipen.

— Ashtu?! — Qeleshxhiu e pështyu në fytyrë arixhiun e ri.

Arixhiu se çfarë tha me gjuhën e tij dhe nisi të fshijë fytyriën me shpinën e dorës.

— A e dëgjuat si na shau arxhice? — tha Tajari dhe e qëlloi me grusht. Arxhiu i ri, që kish trup atleti, i dha një grusht fytyrës Tajarit që mënt e rrëzoi për tokë. Ahere filloi përleshja. Gratë arzheshë lëshuan poteren dhe u kacafytën me tregëtarët. Një skenë komike ish ajo e Murat Topallit, të cilit i kish mbetur njëra këmbë në shallvaret e një arixheshe dhe arixhesha meazallah se e lëshonte: Murati ecte a s'ecte me një këmbë...

Tutje, Tajarin e kishin rrëthuar tre a katër arixhinj të vëgjël dhe njeri nga ata po e ndukte me dhëmbë në vithet, si gen. Tajari e gjuajti me shqelm dhe fëmija ra si dëng mbi trotuar. Një arixheshë me sy të zgurdulluar, u shkëput nga të tjerët dhe lëshoi kujën për fëmijën e saj; fëmijës i rridhte gjak nga buzet dhe fytyra i ish bërrë e kaltërt, si gur kali...

Arixhiun e ri e kishin venë përfund nja pesë tregëtarë dhe e shkëpën me grushta e shkelma. Mbi këta tregëtarë u derdh një arixhi plak me thikë në dorë. Dikush bërtiti:

— Shpérndahuni se na therën me thika...

Tregëtarët u shpérndanë me një shpejtësi të habitëshme: dikush vrapoi në kafene, një tjetër u fsheh në dyqanin e tij, kurse Tajari, Murati dhe nja dy të tjerë mbeten aty, të kërcënuar nga thika e arixhiut. Arixhiu plak, me buzë të shkumbëzuarë dhe me sy të etur përgjak, u derdh mbi Muratin. Murati u zbyth. Duke u zbythur gjithënjë, ai u pështet pas murit të një dyqani; s'kish kuj shkonte më. Arixhiu ecte me një çap të sigurt me thikën përrpara.

— E theri! — u dëgjua një thirrje plot dëshpërim.

Syt e Murat Topallit, filluan të kérkojnë ndihmë dhe shpëtim. Tajari dhe dy tregëtarët e tjerë s'dukeshin atyre anëve.

Arixhiu i ri, i çliruar nga thonjt e tregëtarëve, vinte verdallë, si i tërbuar, dyqan më dyqan, duke kérkuar të gjejë fytyrën e ndonjërit prej atyre që i kishin shkaktuar aq vuajtje.

Tani arixhiu plak ish fare afér Muratit. Daja im fu afrua arixhiut dhe iu lut:

— Mos, se do tē tē varin, po e vrave!..

Ato sytē e zinj tē arixhiut, tē qarkuan me një tē bardhë tē madhe, u rrotulluan nē një mënyrë që tē shtinin frikën. Polka u fut nē mes, me një guxim tē habitshëm, dhe i tha arixhiut:

— Fale, pash zotin, ka një tufë fëmijë, ankohu nē gjyq pér atë që tē bënë.

Arixhiu qëlloi me thikë mbi kokën e Polkës, por Murati ra më gjunjë. Arixhiu u mat tē qëllojë edhe njëherë, por e pengoi përsëri Polka dhe e ndali britma e një xhandari:

— Xhandarmeria!

Dora e arixhiut ngriu nē ajër. Ai u kthye nga xhandari dhe pa fjalë i dorëzoi thikën:

— Përpara! — dha urdhër xhandari.

— Të gjithë zotnia, edhe ay — bërl me gisht arixhiu duke treguar Muratin.

Xhandari i mbledhi tē gjithë arixhijtë dhe i vuri përpara si një tufë bagëtish. Ajo arixhesha vazhdonte tē qajë, dhe herë pas here i tregonte xhandarit fëmijën e saj, që po hiqte shpirt...

Murati mori frymë thellë dhe tha i çliruar nga një ankth:

— Racë e fëlliçur...

— Po faji ish juajt — i tha Polka. — Tajari ja hodhi dacin...

— E kush e mejtoi se do tē arrinte puna gjer tek thi-ka?! — foli Murati dhe ato syt e tij vështronin akoma me frikë.

XIV.

Babaj më vdiq pa pritur e pa kujtuar. Ai iku prej nesh nē një kohë shumë tē vështirë. Ne ishim tē vegjël, ne nuk kishim asnjë dysh pér ta varrosur. Si t'ja bënim?!!...

Shpesh herë kisha dëgjuar, se princ Tati ish njeri me zemër të mirë dhe se i mëshironte hallexhijntë. Vendosa të kërkoj ndihmën e tij. Për këtë vajta dhe zura pritë përpara lulishtes popullore.

Po bisedoja me një matjan që kishte ardhur për t'u bërë xhandar, kur ja, biefas, pashë princin mbi kalë. Kali i tij, i bardhë, ecte me një çap madhështor. Kjo më tuti, po megjithëkëtë, i dola përpara. Njeri nga rojet e tij, një xhandar me fytyrë të mprehtë, u vërsul mbi mua, dhe më shtyri. S'dij qysh u rrëzova, po shpejt u ngrita më gjunjë. Xhandari desh të më qëllonte përsëri, por princi ngriti dorën lart dhe tha: Mos!...

— Shpëtova — thashë me vete.

Princi zbriti nga kali dhe m'u afrua. Xhandari m'u kanos duke shtremberuar nofullat dhe duke përplasur kamxhikun mbi faqen e çizmave të tij me lëkurë llustrafini.

— Ç'ke, mor djalë? — më pyeti princi dhe më ndihmoi të ngrihem në këmbë. Duart e tij ishin të buta dhe të bardha.

— Më vdiq babaj — i thashë me pikëllim dhe s'dij qysh i mbajta lotët.

— Naltësi! — i thosh xhandari — është nga ata vagabondët e këqinj, lereni këtë maskara se e bën kastile...

— Po mirë, tani ç'kérkon nga unë? — më pyeti princi duke më shikuar me ato syt e tij të gjallë dhe të shpëllarë si kristal.

— Dua të më ndihmosh. Unë dhe nëna s'kemi para për ta varrosur...

— Aha! — tha — s'ke para për ta varrcsur dhe njerin gisht të dorës së djathëtë e shpuri nën hundë dhe e lëvizte sikur t'i binte violinës. Pastaj më pyeti: — Në Bashki, a ke vajtur?

— Jo!

— Përpara duhet të vesh atje, sepse Bashkia është një institucion që ndihmon të varfërit. Shteti ynë që i ndihmon të varfërit, e ka krijuar apostafat këtë institucion, për ju. Shko atje, se do të të ndihmojnë...

Princi e pështeti këmbën e tij mbi dy duart e xhan-

darit dhe kérceu mbi kalë. U. dëgjua trokëllima e pat-konjëve· dhe e zileve që zbukuronin qafën e kalit të tij.

Unë mbeta aty, si i hutuar. Gjer aherë nuk e kisha ndjerë veten aq të rritur. Kur ktheva kokën, nga ana e lulishtes popullore, pashë se si shumë njerëz po më vështronin me interesim...

Vajta në shtëpi pa pikë fryme. Babanë e kishin shtrire në dhomë; e kishin vendosur me kokë nga lindja dhe mbi trup i kishin hedhur një çarçaf të bardhë. Duart ja kishin vënë mbi gjoks. Sytë e tij të qetë, sikur shkëlqenin më shumë dhe buzët i ishin rrudhur. Dukej sikur kish renë në mejtime të thella, sikur po falej, ose sikur po shihte diçka të shejtë, atje mbi tavan, kú e kish përqëndruar shikimin.

Nëna s'qante; ajo pshëretinte herë pas here; dy gra e mbanin për krahësh. Kur më pa mua, filloj të qajë me dënësë: — Eja, o jetim i nënës, eja, o pëllumbi nënës, tanë nëna jote është në duart tuaja, o jetim i nënës!

— O baba, a më dëgjon? — bërtiti motra dhe u hodh mbi trupin e tij duke uluritur.

Unë doja të qaja, po ja se lotët nuk më delnin. Në gjoks më qe formuar një shuk i madh, i idhtë si helmi.

— I shkreti! — thosh një fqinja jonë, një grua e urtë dhe shpirtmirë. — S'pat fat ta shihtë djalin të rritur, me punë e zanat, marshalla, po i bëhet burrë...

— Të gjithë do ta bëjmë atë udhë, fëmijët i lëncim prapa — thosh një plakë që unë s'e njihnjë cila ish.

— Amin! — murmuritnën të tjerat, kurse një burrë thosh si i menduar:

— Jemi calik me frymë e asgjë tjetër. Lum ai që s'u mërzit, lum ai që la kujtime të mira. O zot të qofshim falë!

Nëna dëgjonte dhe këto fjalë sikur e lehtësonin. Më shikonte mua dhe sikur më pyeste:

— Po tanë si do të bëjmë?

E kish mbajtur shpresë se do t'i lidhej pension. Por pensioni nuk iu lidh. Ai vdiq, me fjalën në gojë: — Du-

roni edhe pak, sa keni pritur nuk do të prisni më, pensioni do të më lidhet dhe aherë do të shpëtojmë...

Daja erdhi më vonë se të tjerët, bashkë me Polkën dhe më hoxhën. Polka më ngushëlloi dhe më tha, me një zë pak të ashpër, sikur të kisha bërë ndonjë faj:

— Burrat nuk qajnë, as dëshpérohen, dëgjove? Vdekja është hak pér të gjithë. — Më largoi pak sikur donte të më shihte më mirë dhë vijoi:

— Tani eja të shkojmë në bashki, të paktën ta vrasim pa para, me certifikatë vobekësije.

— Përpara bisedoni me kryeplakun e lagjes — na këshilloi daja.

— Po, po, e dij — tha Polka.

Nuk po zgjatem të tregoj se si kryeplaku të cilin e gjetëm në dyqan të tij duke përkëdhelur një zagar shapash, s'na dha certifikatë vobekësije sepse gjoja sipas fij, ne ishim në gjëndje të mirë ekonomike.

— Po a kâ më të vobektë se këta? — e pyeti Polka.

— Ka me qindra. Hajde të të çoj unë tek shumë familje që e dij që hanë bukë vetëm një herë në ditë. Të paktën ky punon, — tha pér mua — e ëma e këtij po ashtu, bën si bën nëpër gratë zengjina...

— Mos, o Romë, mos hyrë në hakun e fukarasë! — foli Polka i zemëruar dhe iku pa e përshëndetur.

Në bashki ish edhe më keq. Një nëpunës tha se nuk do të merrnim ndihmë edhe sikur të kishim pasur certifikatë vobekësije, pér arësy se fondi ish sosur; aherë Polka u përpinq të hyjë tek kryetari i Bashkisë; kryetari nuk ish aty, ndërsa sekretari i tij i kish thënë Polkës:

— Shko, mor sharlot, mos na bëj vapë..

— Ah, more bir — më thosh Polka udhës — mos u bëfsh pér të shtrirë dorën, se mbarove. S'ka njerëz më të poshtër se këta! Kryetari i Bashkisë Qamil Pepa, është një qen i fëlliur, kushedi tanë se nga bredh, ndoshta është në Kursal duke lojtur kumar ose po dëfren me dylshullvare, do t'i lyeja me benzinë dhe do t'u kisha dheminj...

Fjalët e Polkës më bënин përshtypje të madhe dhe s'dijë sepse në shpirtin tim, ato zgjojnë një ndjenjë të turbullt. Më dukej se atë që s'kish mundësi ta bënte ai, do ta bëja unë, në t'ardhmen.

Kur u avitëm tek shtëpia, Polka nxori qesen, atë qesen pis, e zgjidhi me kujdes grykën e saj, dhe më numëroi në dorë 7 franga:

— Këto janë parat' e mia, jepja nënës dhe ti do të m'i paguash kur të kesh.

— Po në mos paça?

— Dëgjo, në mos paç e në qofsha gjallë unë, s'ka gjë. Në vdeksha, e ti në mos paç, aherë shko e li lyp ku të duash, me ato para të më çelësh Remle dy herë në vit, natën e Kadrit dhe drekën e Bajramit të vogël. Mos harro, ë? Dhe po të kesh mundësi, këndimin të ma bësh me Haxhi Dashin...

Nuk e kuptova në u tall apo në e kish serjozisht. — Po sidqoftë parat e tij na mbaruan shumë punë. Paguam hoxhën, taksën e varrimit dhe unë me dajën vajtëm në vorrezat, dhe bëmë pazarllék me vorraxhinë. Me të ramë në ujdi që varrin ta hapnim të tre dhe vorraxhiut t'i jepnim një pagë, që ishte baras me gjysmën e pagës që merrte pér hapjen e një varri.

Një orë më vonë pasi hapëm varrin erdhixhenazja. Sapo e pashë, m'u muarën mëntë. Gjatë punës pér hapjen e varrit, asnjëherë nuk kisha dashur të besoja se aty, në atë gropë të errët, do të futej babaj im...

Kufoma e babajt kalonte duar më duar. Edhe daja doli përpara dhe zuri radhën pér ta mbajtur mbi sup. Pastaj e zevendësoi Polka. Ky më bëri shenjë të shkoja tek ai.

— Mbaje edhe ti një çikë, se është sevap i madh — më tha.

Zgjata duart dhe me zor e vura mbi sup cepin e tabutit. Eca disa hapa, kur ja, dikush kërkoi të më zëvendësojë.

— Shko tek ai tjetri — dëgjova pas zërin e Polkës, — ky është i biri dhe është mirë ta shpjerë gjer në varr...

Nga që isha i shkurtër, gjithë peshë e tabutit bie mbi muat. Unë pengohesha nga brigjet e vegjël që kanë formuar varret e vjetër.

Hoxha ecën ngadalë me një hap të çlirtë, por të rrëgulltë. Pas tij, shkojmë ne me tabutin. Befas, mua më pushtoi një ndjenjë që s'dija si ta shpjegojë: më vinte një farë frike e pakuptuarshme dhe një diçka, sikur të kisha pirë kushedi sa raki, m'a pret fare fuqinë e trupit. Pastaj ndjeva sikur më pushtuan ethe mbytëse dhe nofulla e poshtme filloj të më dridhej.

U mundova shumë gjer sa arritëm tek varri.

Tabutin e ulëm me kujdes dhe hoxha filloj të këndojë Kuranin. Të gjithë ata që kishin ardhur në xheneze — gjithsejt 12 vetë — u ulën rrëth varrit të hapur dhe dëgjonin në hëشتje. Vorraxhiu ka hyrë në gropë dhe pret të marrë tabutin.

Përpara nesh, shtrihen varret e panumërtë. Unë mendoja: Ja, këtu do të varroset im atë, nesër nëna dhe një ditë tjetër unë vetë. Në këtë tokë të pamëshirëshme, janë kalbur gjyshja ime e dashur, dhe gjithë farë-e-fisi im. Sa dëshiroja që të isha në endë! Shpesh më kish ndodhur që në endë e sipër më kishin therur me thika, bile njëherë edhe më varrosën. Kur zgjohesha e ndjeja veten si njeriu më i lumtur në botë. Por jo! Gjithçka është e vërtetë: në po varrosim babanë.

Tutje, pashë dy shokë të mi, që kishin ardhur të marrin pjesë në varrimin e babajt tim. Ata qëndronin të veçuar nga që u vinte turp të rrijnë me pleq. Njeri nga ata, Xhemali, filloj të avitej dhe dalëngadalë sosi tek unë. Aherë, hoxha, me një gjuhë të shkathëtë dhe të stërvitur, i dha fund ceremonisë. U ngrit, e mbylli Kuranin dhe tha, me një zë jo të zakonshëm:

— I pastë rahmet shpirti, xheneti qoftë i hapur për shpirtin e tij, allarahmetilësën! . . .

Dy a tre burra e ndihmuani hoxhën të ngrejë tabutin. Vorraxhiu e mori trupin e babajt dhe pa asnje kujdes, filloj ta përplasë për të zënë vënd mirë, në dërrasat që ishin vendosur në tokë. Si e mbaroi këtë, doli, dhe

aherë Polka hodhi i pari një grusht dhe. Pastaj hodhën dhe të gjithë të tjerët, duke murmuritur:

— Allarahmetilersën!

Vorraxhiu e hidhte dhenë me lopatë.

— Allarahmetilersën murmurisnin të gjithë, dhe unë lutesha me lot ndërsy: O zot, mos e kalb trupin e babajt tim, ëshët njeri i mirë dhe s'ka bërë asnjë të keqe. O zot, çoje shpirtin e tij në xhenet, atje ku janë engjëjt e mirë, fale, o zot babanë tim!

Daja më tha të hidhja edhe unë një grusht dhe. E mbusha dorën me dheun e zi dhe e hodha. Pashë se si dheu im shkoi e ra mu mbi gjoks, në atë gjoks, ku unë shpesh herë mbështesja kokën time me butësi...

* * *

Kur vajta në shtëpi, menjëherë nxitova për të parë vëndin ku flinte babaj. Vëndi ish i shkretë.

Një arkë vajguri që përdorej si këmbë krevati, ish hedhur në një qosh, tjetra ish zhdukur. Tutiq në parvazën e dritares, shkëlqente kutia prej sërmi e duhanit. Atë kuti duhani babaj e kish marrë në Bullgari, në kohën e luftës Ballkanike dhe mburrej se ja kish dhënë një grua bullgare të cilën e kish shpëtuar nga një ushtar turk i dejur.

Kutia e duhanit ma coptoi shpirtin. Ish e vëtmja shenjë që kish mbetur nga babaj im. Plaçkat e tij të tjetra nuk i shihja asgjékundi, dukej se edhe kutinë e duhanit do të kishin harruar pa e marrë.

Edhe pak, bëhej natë. Qielli ishte i ftohtë dhe i thastë, një tufë patash të egra me zor çanin hapësirën.

Jam ulur mbi gurët e pusit dhe në heshtjen e asaj mbrëmje plot trishtim, rri e mendoj për fatin tim të keq. Nuk shihja asnjë shkëndijë drite në mjergullën e dëndur të mendimeve të mia. Gjithçka po më braktiste, jeta ime po bëhej më e vështirë dhe e ndjeja se nuk kisha mundësi të jetoja si më parë: puna në kafene nuk më ushqente dot, nëna sa vinte bëhej gjithnjë e pazonja për punë, kurse motra ishte akoma e vogël.

Duke menduar, kështu mbi hallet e jetës, më kujtoheshin fjalët e babës që i thosh nënës kur mërzitej shumë:

— E fus në të madhen, s'mbushet; e fus në të voglën, derdhet!

Edhe unë isha tamam në atë gjendje.

Nata që po vjen, bashkë me errësirën, më sjell një frikë, një frikë, një frikë si ajo që më zuri në vorrezat. Do të jepja disa vite ngajeta ime, sikur të mos bëhej natë nja dhjetë ditë rrjesht, gjersa të qetësosheha dhe të dija se ç'do të bëja sot e tutje...

Brodha sa brodha dhe s'mbaj mënd se si u gjeta në shtëpi dhe qysh më zuri gjumi. Të nesërmen u ngrita vcnë, dhe, sa po u zgjova, e ndjeva veten më të lehtësuar, sikur po më largohej mërzija, frika dhe trishtimi.

* * *

Polka më pyeti si i mërzitur dhe më tha:

— Qysh sot fillave të sillsh kështu? Mblidhe veten, tregohu burrë një çikë, si shumë të tjerë dhe kape jetën përfrenash. Duhet të kesh zemër të fortë gur. Njeriut në jetë i ndodhin shumë të këqia. Ajo që të ndodhi dje, mund të të ndodhë edhe nesër. Kështu e ka jeta, biri im. Kush gjëzoi në këtë jallane që të gjëzosh ti!...

Qortimet e Polkës nuk më zëmërojnë; është i vetmi njeri që më do shumë dhe që më flet aqik përf të gjitha gjérat.

— Posi! — vazhdonte ai — tani ti duhet të mendosh, përf të bërë edhe ndonjë punë tjetër. A ke qejfë të shësht meze, vezë të ziera, kikirik ose mish pule?...

— Po, kam.

— Aherë bisedo edhe me nënën dhe fillo sa më parë...

XV.

Dhe ja, një të djelë në darkë, zëri im filloi të buçasë nëpërdhët e Tiranës:

— Kikirik, taze kikirik!...

Eci plot qejf, duke u futur pijetore më pijetore. Shpesh herë më takon të rrij gjer pas mesit të natës dhe të nesërmen jam i detyruar të gjëndem në kafene, pa lindur dielli, por prapë se prapë, puna e re më pëlqen. Njerzit me të cilët kam të bëj, janë të gjithë të mirë, nuk më rrabin, as më shajnë, por shpesh më shikojnë me dhim-suri

— Shko tani, se kemi meze — më thonë ata dhe ma shtyjnë lehtë kanistrën.

— Të lutem, zotni, merrni kikirik, janë të ngrohta, taze...

— Po ja tek kemi! —

Unë nuk flas, por as nuk iki, sepse e shoh tek syt e tyre se puna do të mbarojë në favorin tim. Ka edhe nga ata që nuk mërziten sikur t'u rrish aty në këmbë gjer në të gëdhirë. Aherë unë shkoja në një tavolinë tjeter. Isha betuar me vëvete se nuk do largohesha pa shitur të paktën dy kaushë në çdo pijetore.

Xhiron më të madhe e bëj në kafe «Zorra» dhe «Vera». Në këto kafene unë shkoj gjithmonë në orët e vona, sepse atëherë i gjej njerzit të bërë tapë dhe ata shpenzojnë edhe gros!

Kur dal të shes, punën e filloj nga rruga «mbretnore». Në këtë rrugë gjëndet pijetorja «Ballkan», pasticeria moderne «Bellavenecia», hoteli «Metropol» dhe disa pijetore të vogla, si kuti, ku rrijnë e luajnë bixhoz ca njerëz me sy hajdutësh.

Pronari i pasticerisë «Bellavenecia», një burrë faktekuq, me trup të madh e të mbushur, më ndiqte sepse hyja brënda. E vërteta është se aty asnjëherë nuk kam shitur qoftë edhe një kaush, sepse asnjë nuk blente, po ja se kisha qejf të madh të shihnjë atë lluks që derdhej qosh më qosh, të shihja ato familjet pasanike që uleshin rreth tryezave të kristalta e që hanin pastat me delikatesë, duke i prerë me thika të ndritëshme si flori.

Por pronari i «Bellavenecias» kish edhe një të mirë: kur më ndiqte, nuk shante, siç bënин disa pijeshitës të tjerë që mbanin vetë meze; ai ecte me çapa të shpejta, po të shkurtëra, duke m'u kanosur me gisht:

— Psht! — më thosh, — mos të të shoh më këtu!...

Unë largohesha nga tre a katër metra dhe për inat të tij, rrija aty përpara me një pamje krenare. Ai futej brënda, i zemëruar nga që s'kish q'të bënte.

Një herë se si më zuri në befasi. S'më rrahu, bile u çuditë që më foli urtë:

— Të kam thënë, se këtu nuk bën të vish. Shih si je! Me një veshje të tillë, nuk hyhet në «Bellavenecia»! Këtu vijnë vetëm familjet e nëpunësve të lartë, ti duhet ta dish se, «Bellavenecia» ndryshon nga pasticeritë e tjera. More vesh? Tani qërohu se ndryshe do të thërras policinë!...

Ata syt e tij, u zmadhuan dhe fytyra iu bë edhe më e kuqe.

Për nja tri a katër net, s'u duka më andej. Paštaj përsëri futesha dhe e them haptazi, se sa herë që gjëndesha aty, dehesha nga gjëzimi dhe rrija i mahnitur minuta të tëra. Më dukej sikur isha në një vënd prallor. Aty të bënte për vete pastërtia e madhe, një pastërti e tillë që më mahnistë. Në tavan ishin varur gjela, majmu-në të punuar me sheqer e të veshur me varak: dritat e kuqe, të jeshilta dhe blu i jepnin si bukuri të veçantë dhe mua më duket se njerzit që vinin aty, nuk ishin të zakonshëm; ata flisnin me zë t'ulët lëvizjet i kishin të matura dhe fëmijët gjithashtu ishin të urtë dhe të rregullt....

Kur ikja nga «Bellavenecia», se si më lindte dëshira të rrija duke shitur kikirik, po që nevoja, gjer në të gëdhirë.

Zhurmën e pijetores «Ballkan» e dëgjoja gjer larg. Imagjinoja se do të kish shumë klientë, fytyra të ndryshme më dilnin përpara syve dhe, befas, ndjeja se më shtoheshin të rrashurat e zemrës, kur e përfytyroja veten duke hedhur katër a pesë kaushë në një tavolinë, ndërsa, nga tavolinat e tjera, përplaseshin duar:

— Çuni eja edhe këtu!...

Po sapo futesha brënda, ndodhte e kundërtat. Tmerohesha kur shihja që në tavolihën e parë ishin shprazur kaushë me kikirik.

— Dikush do: tē ketē ardhur pérpara meje — mendaja me kegardhje. E zgjatja kokën nēpér tryeza tē tjetra dhe aty ku nuk kish kikirik, nxitoja shpejt-e-shpejt:

— Urdhéroni kikirik, zotni!

Zakonisht u drejtoħesha atyre njerézve qē mē dukeshin se ishin shpirtmir. Por shumé nga ata talleshin me mua, duke mē lëshuar nē fytyrē atē frysxn e tyre tē qelbur nga alkoli:

— Sa e ke kaushin?

— Një grosh.

— Mē jep tré kaushé një gjysém lekū?

— Nuk bén, zotni.

— Miré pra, shko.

E vështroja nē sy dhe mundoħesha t'i blej mendimfín.

— Ćirri mē?

— Jané taze, zotni, me kripé...

— Sa kokra ka kaushi?

— Njézet kokra, kokra tē zgjedhura. Provojeni nēqofta-se dëshéroni, —

— Iké tani!

Shumé tallet me mua një djalosh syzi, me floké tē zez qē i varen mbi ballé, me një hundé pak tē shtypur. Mē zé nga kanistra dhe mē pyet duke qeshur:

— Mbrémé mē ke dhënë kikirik tē bajatura!

— Né ćvend?

— Né «Metropol».

— Po uné mbrémé nuk isha fare nē «Metropol».

— Po né «Kontinental»?

— Atje kam qené.

— Sigurisht atje do tē m'i kesh dhënë.

Uné e kuþtoj se e ka me tē qeshur.

Ai merr një kaush, e zbraz dhe ma hedh letren mbi kanistér:

— Nesér mbréma do tē ta jap groshin.

— Miré, — i. them uné dhe bëhem gati tē iki, por ai s'mē lë: — Po tē paguaj pra se tē simpatizoj, ti mē pél-
qen sepse ke fituar edukatén e punés. Ajo mua mē mun-
gon!...

Hesht dhe ngre gotén e rakisë, duke ćfryrë.

Një natë ai kish pirë shumë, ish dejur tapë po mendjen s'e kish humbur. Fliste çthurur me një shokun e tij, dhe apo më pa, kapi nja tre kaushë kikirik dhe i hodhi mbi tavolinë.

— Shko, tani! — më tha, dhe ato flokët e tij të zinj ja mibuluan syrin e djathtë. Pastaj i tha shokut të vet:

— Kur mbarova gjimnazin, isha nja tre a katër vjeç më i madh se ky. — U kthyte nga unë dhe më tha me një pamje të rëndë. — Ej, kam mbaruar gjimnaz unë, s'jam si këta të poshtër që sheh rrëth e rrötull...

— Mos bërtit! — e këshillonte shoku i tij.

— Pse mos të bërtas? Për mua janë të gjithë të poshtër, nga më i madhi, gjer tek më i vogli. Jo ti — më thosh përsëri mua — Të tjerët, ti je djalë punëtor, ke edukatën e punës. Pikë. — Piu dhe shtoi: — Dëgjoni këtu. Kur mbarova gjimnazin, vajta tek kryetari i Bashkisë, zoti Qamil Pepa.

— Po ule zënë — i lutej shoku.

— Qamil Pepa e quajnë, apo të themi Qemal Pipa? — dhe qështe duke lëshuar nga goja e tij cikla pështyme. Kamarieri erdhi të më largojojë.

— Mos e prek! — i tha ai studenti. — Ka punë me mua, ti shko atje në banak!

Kamarieri iku dhe studenti vazhdoi:

— Vajta tek Qamil Pepa, që the ti, i thashë: kam ardhur të më emëroni në ndonjë punë. Prit, nuk i thashë kështu; i thashë: Zotni kryetar, mbarova gjimnazin, jam njeri i varfër, por i ndershëm. Prit, nuk i thashë se jam i ndershëm. I thashë: Ju lutem të më ndihmoni, zoti Kryetar, që unë pasi mbarova gjimnazin më nota shumë të mira, të emërohem në ndonjë punë ku ta shihni ju t'arsyeshme. Po, kështu i thashë. Tamam kështu, e mbaj mënd, siç mbaj mënd vjershën e Naimit «O malet e Shqipërisë e o ju lisat e gjatë»... Emëromëni në ndonjë punë...

— C'farë pune mund të bësh ti? — më pyeti kryetari dhe m'u afrua e më zuri për faqesh. Për zotin është e vërtetë ajo që thuhet... Kjo është shumë e vërtetë. Pikë!

Ai kish harruar se unë qëndroja aty në këmbë, dhe kur më pa, më tha:

— Na paratë, shko tani, ruaje edukatën e punës...

Njerëz si ai studenti, njerëz që kanë humbur kuptimin e jetës, unë gjej në çdo pjetore dhe jo vetëm në pjetore. Në kafe «Berlin» dhe në «Kursal» ku zakonisht rri «inteligjenca» e Tiranës, gjen shumë studentë të tillë që kanë mbaruar shkollat dhe që presin dita-ditës të futen në punë; përveç atyre, që degjeneruan nga halli, degjeneruan dhe shumë të tjerë që janë nëpër punëra të mira, si profesorë, juristë, gazetarë e shkrimitarë, të cilët pasi rrjinë një ose dy orë nëpër zyrat e tyre, vijnë e kopardisen nëpër sallonet e këtyre kafeneve, bëjnë nja një orë diskutime të zjarra «filozofike» dhe pastaj ja shtrojnë dhe luajnë poker, xhol, ose dum-dum. Në syt e tyre duhet ai myshku i dembellëkut dhe i plogështisë; mëndja dhe shpirti i tyre janë kalbur dhe zhystur në një jetë të zbratzët dhe pa qëllim dhe tek ata s'ka mbetur dëshirë tjetër vëç bixhozit dhe kurvëllikut. Si shitës nate, unë njoħa shumë gjëra të turpëshme që ndoshta, në tregimet e Polkës, më dukeshin pak-a-shumë të ćuditëshme dhe shpesh herë të pabesueshme. Përpinqesha të bëja kråhasim në mes kafenesë së dajës tim dhe Kursalit. Në të vërtetë njerëzit që vizitonin atë të dajës ishin të veshur keq, kurse në «Kursal» ose «London» njerëzit ishin lluks, serjozë, me pantallona të hekurosura dhe me borselina. Por si ata të dajës dhe të Kursalit kanë një gjë të përbashkët: janë kumarxhij. Bile unë mund të shtoj se ata të dajës janë edhe më të ndershëm, të paktën shumica prej tyre duan punë, por punë s'ka, kurse ata të «Kursalit», të «Berlinit» dhe të kafeneve moderne janë në punë dhe s'punojnë.

Kam njoħur një burrë që shet bajame me kripë. Eshtë i shëndoshë, tullac, me një ballë të gjerë. Kur ecën, duket sikur fle dhe të gjithë e njoħin dhe bëjnë horë me 'të. Por ai eshtë dinak i madh. Jo vetëm që di të shesë me marifet, por mëson aq gjëra të fshehta sa asnjeri nuk ja kalon. Me mua e ka mirë dhe kjo qysh nga koha që i bëra një shërbim të vogël.

Nuk dij në ka familje, sepse e shoh gjithmonë të veshur po me ato rrroba, dimër e verë, nuk dij gjithashtu se ku i shpie paratë, sepse nuk e shoh të shpenzojë as edhe një dysh. Shkurt, është njeri dinak. Kur futet nëpër kafene, nuk u bën reklam aspak bajameve të tij, po prapseprap e thërasin nëpër shumë tavolina:

— Miti!

— Erdha! — përgjigjet ai.

Miti disavë u flet greqisht dhe pastaj e kthen shqip duke e nxjerrë atë gjuhën si të breshkës:

— Sa urdhëruat?

Ka një lugë të vogël kafeje dhe me 'të i merr bajasmet, i vendos në letër dhe ua vë në tavolinë. Kur mbaron së shituri, shkon pranë kamarierit, me të cilin flet hapur (përgjithësisht me kamarierët e ka mirë), bile, me sa shoh, ky bën edhe shumë dallavere me ata.

— Pika i rëntë atij kokëmadhit.

— Cilit? — e pyet kamarieri.

— Ja, atij deputetit të Shkodrës; ai që është me kostum të zi, ja, ai buzëtrashi aty! —

— E shoh, është D.T.

— E shoqja ka vajtur me Zef Serreqin, kurse ky matuf luan poker... .

— Po edhe ai vetë ama, u kënaq me të-shoqen e avokat B.K.

— Djalli s'e merr vesh se ç'bëhet — e tundi kokën e tij të madhe, Miti — Sot, më thanë edhe një gjë tjetër të çuditëshme: sikur dashkan të hapin një... për djem.

— Ç'thua?!...

— Për fjale të nderit po, dhe ai që ma tha, është njeri që nuk gënjen.

— S'e besoj! — kundërshtoi kamarieri.

— Dëgjo Mitin, kështu si të them unë! Bile me sa dij unë, kjo bëhet nga vetë Lalë Krosi... .

Kamarieri mbeti me gojë hapur.

Miti edhe me mua flet pa ndrojtje për gjëra të tilla. Më dukej sikur ay e bënte nga inati që kish për ata njerëz që i flisnin rëndë, ose sepse ai ishte nga ata që

çdo gjë që di, s'rri dot pa e thënë. Të tillë njerëz ka shumë në jetë.

— Qeni, më tha se e shurdhova — ankohej Miti përnjë farë Sotir Martini. — Po kur e sheh të shqoqen me këmbë përpjetë me ambasadorin italian, s'e prish aspak terezinë. Kopuku! Gamotati... ja kthente greqisht. Pastaj i thosh ngadalë kamarierit:

— Shikoje atë gazetarin, Nabil Çika, c'është një pushtai!... Dje thoshte se do të shkruante një kritikë në gazetë për të varfërit kurse sot luan poker me deputetët. Pika që s'i bie! Ja si i fërkohet deputetit, kastile për të shoqen...

— Me sa dijë unë, Nebili ka relata me të shoqen e ambasadorit italian.

— Jo, me atë, dale, si e quajnë? Hë, e quajnë Irina Kok, me atë e ka ujdisur Egrem Bej Libëhova.

Biseda e tyre ndërpritet se dikush përpillas duart. Miti më thotë mua:

— A vemi në kafe «Vera»?

— Sapo u ktheva andej — e gënjej unë.

— Po ç'kishte atje? —

— Asgjë — e gënjej përsëri, sepse po të shkoj tok me 'të, nuk shes asnje kaush kikirik, pasi i ka mystérinj të gjithë.

Ahere Miti ikën vetëm dhe unë vazhdoj punën time.

XVI.

Shitës nate jemi shumë. Mund të bëhem mbi një-qind e kusur djem e vajza. Të gjithë i përngjajmë shumë njéri-tjetrit, jo vetëm nga veshja, por edhe nga fytyra. Fytyrat tonë janë të verdha nga lodhja, dhe pagjumësia. S'është shaka të bredhësh Tiranës gjer në ora dy të natës. Mua vetë më ka takuar të bëj më shumë se 30 xhiro në një natë rrëth-e-përqaq, nga rruga «Mbretnore» tek bulevardi, bashkia, Rruga 28 Nëndori e me radhë. Pa le, kur shkoja larg në kafe «Bilbili» apo «Vera»!...

Me shitësit e tjerë unë kam marrëdhëniet të mira, megjithëse disa prej tyre më shikojnë vëngër. Kur fillova të shes, kishte nga ata që më kërcënuan se do të më hiqin, një dru të shëndoshë, por u zbutën kur u thashë se më ka vdekur babaj.

Shpesh herë piqemi katër a pesë vetë, dhe i tregojmë qyfyre shoshoqit. Vete kjo jetë endacakë të bën çapkën, bile të mëson edhe me vese të këqia. Shumë nga shitësit janë edhe kusarë, kusarë të vegjël lojrash ose paqeta cigareshi.

Në dimër, vemi e pështetemi pas murit të ngrohtë të një furre dhe s'na bëhet të ikim për një kohë të gjatë. Flasim për filmat që kemi parë, për vjedhjet që janë bëre gjatë ditës, për djemt' e pasanikëve që janë aq frikacakë, sa s'bëhet. Shpesh herë harrojmë se jemi shitës dhë fillojimë e luajmë «kusarcë» duke vrapuar nëpër errësirën e pazarit të vjetër, ose duke u fshehur pas drushtave të elektrikut. Shoqëria më këta njerëz më kënaq shumë, s'ka më qejf se sa të rrish me ta, të dëgjosh shakatë e trimëritë e tyre.

Kur lodhemi, dikush propozon:

— A shkojmë ke Bumçi?

Bumç quanin një pasticier plak, një burr i shkurtër dhe i shëndoshë si thes, të cilët i vidhnin tullumba.

— Shkojmë!

Një herë më ngarkuan t'i vidhnja unë tullumbat. Kur kundërshtova, vendosën që unë të kërkova ujë. Kopilat e kishin psikollogjuar dhe provuar se ky plak fetar nuk të largonte asnjëherë pa të dhënë ujë.

Tullumbat ai i mbante në një enë të rrumbullaktë, të vendosur mbi tavolinën e parë, që ishte në formë banaku, pranë derës.

— Ti futu dhe i thuaj: Më jep pak ujë. Po të kundërshtoji, i thuaj, pash zotin më jep se ngordha. Pas teje vij unë — më këshillonte një çun zeshkan, me qafë të hollë dhe me sy të shkathët, që e quajnë Rasim.

— Po mirë, ai do të shohë se do të shohë.

— Sa i trashë bëhesh! — zemërohej Rasimi me mua,

— Ujin ai e mbush në guzhinë, prapa perdes.

E them haptazi, se e pata tē vështirë. U fufat dhe kur hyra, s'kish asnjeri pérveç pasticerit, plakut tē vogël bar dhosh që po dremiste.

— Një çikë ujë — i thashë.

Plaku s'dëgjoi gjë. Një mizë fluracé e guduliste në qoshen e buzëve. Ai lëvizte buzët duke çfryrë pâ fuqi, po miza, përsëri i ngjitej nën hundë.

— Një çikë ujë — përsërita duke i mëshuar zërit.

Plaku u zgjua i trembur dhe nga që nuk më dalloi dot, më mori pér klient.

— Urdhëroni?

— Një çikë ujë po pate mundësi.

Vura re se s'i erdhi mirë, po s'e çfaqi. U ngrit më plogështinë e moshës së tij dhe vajti në guzhinë. Me një shpejtësi të habitëshme hyri Rasimi; djaloshi zëshkan e pështeti kanistrën e kikirikëve mbi bërak dhe i ra me gisht një tullumbi. Tullumbi u rrukullis duke marrë me vete edhe të tjerë.

Mua po më binte të fikët. Plaku më dha gotën e ujit; unë me zor piva gjysmën e saj dhe dolla më shpejtësi. Rasimi qëndronte në prak të derës, i qetë sikur të mos ish ai që dy minuta më parë vodhi tullumbat.

— A e pe? — më pyeti ai duke u krekosur. Ta thashë se ai është si buall; s'dëgjon asgjë dhe vec kësa; asgjë herë nuk është në gjëndje të kuptojë se i mungojnë tullumbat. Tani merre një tullumb, katër të tjerët i hëngra unë me Çetin.

— Merreni edhe këtë — thashë.

— Pse?

— Nuk e dua!...

— Mos tē erdhi keq që tē ruajtëm vetëm një?

— Jo, jo, nuk e kam pér atë.

— Mirë pra, — dhe e hëngri me një kafshatë.

Unë ika pér tē vazhduar shitjen e kikirikëve. Më vinte inat me veten time, pse u ngatërrrova më atëmpér tē mashtruar një plak zemërmirë. Ky ishte i pari faj tië jetën time. Por e shihja se ky nuk është i fundit. Shumë nga shokët e mij, (disa i kam pasur shokë tē vjetër shko-

lle), rrinin përpara reklamave të kinemave, me kurriz të dalë, duke pirë cingare dhe duke vënë në lojë ndonjë malok, të cilil i marrin qeleshen dhe e vërtitin dorë më dorë. Maloku i xhindosur vravonte sa andej këndej pas qeleshes, ndërsa ata qeshnin me të madhe. Nuk ishin të rralla rastet kur vinin xhandarët dhe i mernin përpara «vagabondët» e vegjël dhe i shpienin në karakoll. Dy tri ditë më vonë, ata përsëri i shihje aty, tek filmat e kinemave...

* * *

Atë natë, ja tregova fajin nënës. Vura re, se sytë e saj u njomën me lotë.

— Nuk do ta përsëris më! — i thashë me bindje.

— A betohesh?

— Të betohem!

— Mirë pra, kësaj here po të fal, por po e përsërите, më mirë mos eja në shtëpi, jeto me hajdutët dhe fli në namazja, me ata...

— Po unë nuk ja vodha tullumbat! — u mundova ta zbusja fajin tim.

— Njëlloj éshtë, ti i kërkove újë, shoku yt vodhi. A nuk të vjen keq të vjedhësh një njeri që të jep újë?!... Mos pandeh ti se zoti nuk i ve re këto gjëra? Do të na hedhë ndonjë sémundje në shtëpi dhe do të ngordhim si krimbat. Mos, mor bir, mos e ngarko veten me gjynahë. Fundi i fundit ne nuk jemi më keq se të tjerët. Bile shumica na kanë zili. Asgjë nuk na detyron të vjedhim. Ne bukë kemi. Merr shëmbull Zeltë, Bamtë, Qerajt, të gjithë janë më keq se ne, po megjithë këtë jetojnë me hallallëkun e tyre...

Nëna më foli gjatë mbi të mirat e të këqiat; më tregoi edhe një përrallë shumë të bukur që bënte fjalë përdy vellezër, njeri zemërmirë, tjetri zemërkeq; se si ay zemërmiri kishte gjetur një qese me flori, po ja vodhi zemërkeqi; se si më në fund këtë e therën ca hajdutë të tjerë, ndërsa ai zemërmiri, ish martuar me të bijën e mbretit...

Përralla më pëlqeu shumë. Atë natë në ëndër pashë sikur në lagjen tonë ra zjarr i madh. Flakët ngjiteshin gjer në kupë të qiellit. Im atë, lakuriq, fluturonte përmes flakës. Nëna sikur kish lindur një fëmijë dhe kur e pa babanë, e hodhi fëmijën në tokë. Aherë fëmija u rrit përnjehëresh dhe u zhduk nëpër zjarrin e kuq. Unë, i rrëthuar nga zjarri, përpinqesha të shpëtoja. Po zjarrin s'e kaloja dot. I lutem babajt të më ndihmojë, po ai bën siktir s'më njeh. I drejtohem nënës, e cila për çudi ngjitet edhe ajo drejt qiellit, po as nëna s'më dha ndihmë. Zjarri sa vjen pq ma ngushton rrëthim; ja, u dogj toka nën këmbët e mijë; unë largohem gjithnjë në drejtime të ndryshme; filloj dhe bërtas më sa fuqi që kam, lutem, por zjarri dëndësohet. Befas u pengova dhe u rrëzova në një gropë të thellë. Vetëm ahore erdhi një ndihmë nga qielli dhe s'mbajë mend se si më shpunë atje lart, ku ish një fushë e bukur me lule dhe pemë të gjelbëruara. Hëna ish fare pranë dhe njerëzit ishin të gjithë me fletë. Më thanë që të betohem se s'do t'i tregoj a kurkujt për ato që kisha parë dhe betimi fillonte me këto fjalë:

— Po tregova, më djegjtë zjarri i xhëhenemit.

Pas betimit engjëjt më shpunë nëpër vendet e bukurra. Pashë fëmijë me fletë që luanin disa lojra të panjohura nga unë. Ata më morën në mes tyre dhe më bënë shoqëri; një vajzë e vogël kish një sahat të argjentë dhe kur asaj i shkau nga dora, unë e kapa dhe e fsheha. Asnjeri s'më kish parë. Po ecmim përmes manushaqeve dhe vjollcave, kur befas, një engjëll i rritur na ridaloi të gjithëve.

— Ku e ke sahatin? — e pyeti atë vajzën e vogël.

Ajo hapi dorën. Dora e saj ishte bosh.

— Ta kanë vjedhur, ë?

Disa engjëj fluturonin mbi kokat tona.

— Kush e ka vjedhur sahatin? — na pyeti të gjithëve engjëlli i madh.

Asnjeri nuk foli nga ne. Edhe unë heshta.

Tutje, pas një trandafili, kish zgjatur kokën e tij, ai bumçi, pastiqeri plak, dhe po i kallëzonte me gisht: ai e ka vjedhur, — thosh për mua.

— Mos! — thirra unë dhe ahore ai engjëlli i madh më vërtiti nga qielli në tokë...

U zgjova përnjiherësh. Gjoksi më hidhej përpjetë. Balli më ish bërë qull në djersë... Po zbardhëllonte. Më sa dukej dita do të ish e bukur se nga baxha shoh të shkëlqejnë yjt' e vegjël. Bumçi më dukej sikur përgjonte nga baxha, edhe tani që isha zgjuar...

XVII.

Dy a tre muaj më vonë, u largova edhe nga kafeneja e dajës, për arësy se daja falimentoi. Më erdhi keq përtë, por më keq më erdhi për Polkën, nga i cili unë u ndanya si nga babai t'rim.

— Do të shihemi përsëri! — më tha ai.

— Po, do të shihemi — iu përgjegja unë.

Ndenjëm të dy pa folur një copë herë, pastaj e pyeta:

— Po tani, q'do të bësh?

Polka buzëqeshi me dyshim.

— Kushëdi se ç'ka thënë zoti edhe përmua! — tha duke u menduar. — Ja, do të jetoj si jetojnë edhe mizat e tokës...

— Lamtumirë, pra! — i zgjata dorën.

— Të dëgjoftsha zënë e mirë, — foli ai dhe unë ika.

Atë njeri të mirë unë do ta kujtoj gjithmonë me mirenjohje. Fytyra e tij më del gjithmonë përpëra syve dhe më duket sikur e dëgjoi përsëri atë zérin e tij të urtë që më jepte vetëm këshilla të vlefshme...

XVIII.

Pasi u largova nga kafeneja, u përpoqa të zë ndonjë punë tjeter, një punë që të mos më pengonte si shitës nate. Po punë të tillë nuk gjeta dot. Aherë vazhdova vetëm si shitës nate.

Çdu ditë që kalon, unë futem gjithënë më thellë në shqoerinë e endacakëve të natës.

Shpesh herë me ne bashkohen edhe lypësa; ata janë të shumtë dhe të mërzin; ne i përzejmë nga që kemi frikë se mos bëhen edhe ata shitës dhe kjo natyrisht është në dëmin tonë.

Kur vemi në kafe «Zorra», mblidhemi tok: unë, Xhemal Dibra, shoku im i vjetër, dhe Nusha, një vajzë e vogël 7 vjeçë. Asnjeri s'e di se kjo është vajzë, sepse ftyrën e ka si çun, flokët ja kanë prerë dhe në vënd të fusitanit, mban pantallona.

— Dëgjoni këtu — na thotë Xhemali dhe ata sytë e tij të vegjël si të pulës, lëviznin me dinakëri. — Tani jemi ortakë të tre.

— Po pse të mos shesi sejcili për hesap të tij?

— Sepse mua nuk më lejon të hyj brënda ai kamarieri gërmuq, të cilit i ka dalë shpina si magje. E kam qëlluar një natë me domate në ftyryë dhe ai është betuar se do t'ma marë shpirtin.

Duam s'duam, Xhemali na e mbush mëndjen. Ne kemi interesë nga ai se është i fortë dhe të gjithë shitësit e tjerë ja mbajnë hatrin. Unë futem me Nushen dhe ndahemi në drejtime të kundërtë. Ahengu buçet. Jevgù që i bie kërnetës, e ngrë kokën përpjetë, si rosak, ndërsa jevga, nië gocë e re zeshkane, e heq shaminë e kokës, i shkund flokët e zinj e të gjatë dhe fillon e kërcen, duke u munduar të tregojë gjithë talentin e saj. Ne shkojmë tavolinë më tavolinë. Burrat pijnë raki dhe ftyra u shkëlqen nga gëzimi dhe ndonjëri ngrihet, e kap për dore jevgën dhe kërcen bashkë me të.

Ne gëzohemi shumë kur në kafene vjen shakaxhiu më nam, Kolë Tivari. Sa herë që e shohim Kolën, i shkojmë pranë dhe e lusim të blejë kikirik.

— S'mi do stomaku ato lajthi të egra — thotë ai.
Në qeshim.

— Shko e thirre atë kamerierën, atë faqekuqen — na porosit.

E thérresim dhe kamarjerja paraqitet tek Kola. Kur ajo është fillestare, e re në detyrrën e saj, Kola ja punon

shumë mirë. Mbaj mend se si njëherë, një kameriere që kish ardhur nga Korça, e pandehu Kolën pér kushedi se çfarë. Kola i qëndroi shumë serjoz, i tha tē ulej nē tavolinë dhe e pyeti:

— Pa më thuaj moj bijë, je nga derë e mirë, apo nga derë e keqe?

— Nga derë e mirë! — u përgjegj ajo duke u skuqur pákëz nē fytërë.

— Mirë, pra nē qofsh nga derë e mirë më qeras një dopio raki.

— Me gjithë qejf, — tha ajo e zenë ngushtë nga Kola. Kur ajo iku. Kola na shkeli synë dhe na pyeti:

— Po ju nga c'derë jeni?

— Nga derë e keqe — thamë ne.

— Shkoni, kopila, — bërtiti me tē tallur ai.

Kamarieri gërmuq mundohet tē na nxjerrë jashtë.

— A e do atë tē domates? — e pyes unë.

— Pse, ka ardhur? — pyeti gërmuqi dhe sakaq nē syt e tij flakëroi dëshira e hakmarrjes.

— Ja tek është, atje nē penxhere.

— Thuaj tē vijë tē shesë, se nuk e ngas.

Mirë, po i them, — i përgjegjem unë dhe shkoj ke Xhemali. I kallzoj fjalët e kamarierit, po Xhemali është kopil. I nxjerr gjuhën nga xhami dhe e përqesh. Gungaçi vrapon jashtë, Xhemali zhduket si flutër.

Një natë, Xhemalit i ra ndërmënd një lojë e re, që i nxori telashe gjithë orkestrës. Mori një kokër limon dhe e thithët nga penxherja, lëpihej, i mbyllte sytë sikur i rrënqetëj gjithë trupi, nga thartira e lengut tē limonit. Kjo e ngacmonte tepër kërnetaxhinë. Këtij i mbushej goja terë pështym dhe kur i binte kërnetës, ajo lëshonte ca klithma tē çuditëshme, duke shpérndarë nē ajër cikla pështyme. Sado që kërnetaxhiu u përpooq tē mos e shihte Xhemalin, prapseprapë s'qe e mundur. Xhemali dilte nga penxherja nē penxhere, deri sa, kërnetaxhiu u ngrit dhe bërtiti me zemërim:

— Do ta largoni atë dobiç, apo e lashë kërnetën!

Kamarieri çoi e thirri padronin, një burrë kokë-

madh dhe me ca sy të dalë. Ai na qiti të gjithëve jashtë dhe Xhemalit i tha se e njihte dhe do t'i shkonte me pollic në shtëpi.

— S'është e vërtetë, ti s'më njeh, — i thosh Xhemali.

— Pa më thuaj, si ma quajnë babën?

— Ta njoh babanë, ta njoh, — thosh padroni.

— Oh, ç'më njihke se! Babaj ka tetë vjet që më ka vdekur!

Padroni pa se me një fëmi të tillë nuk i dilej në krye.

— Na lejoni dhe ju të shesim rehat — i tha Xhemali.

— Shisni, po orkestrën mos na e prishni.

— I thuaj atij gungaçit të mos më rrahë.

— Mirë, e porosis unë.

Megjithë këtë, Xhemalit s'ja mbante të hynte brënda. Na çonte neve dhe vetë shkontakte tek dritarja. Kérnetaxhiu vështronte me frikë andej kah ai, dhe Xhemali i shkelte synë se nuk do ta trazonte më.

* * *

Një mbrëmje në këtë pijetore pashë atë gruan, së cilës dikur i binte më qafë kapteri me Velinë. Ish yeshur tamam si ato gratë e liga, me një fustan që i rrinte mbi gjunjë, pinte duhan dhe raki, qeshte më të madhe dhe shkontakte tavolinë më tavolinë. Kur më pa mua, më vështroi një copë herë, përpëliti sytë dhe më tha:

— Shko, nuk duam kikirik.

— Janë taze, zonjë.

— Shko, pra! — më bërtiti nga që donte t'i fliste diçka me rëndësi burrit që kish pranë.

E shikova mu në bebe të syve. Sa shumë kish ndryshuar! Ato sytë e saj, dikur të butë dhe të bukur, duke shin tashti si sy të vdekuri.

— Pse më shikon ashtu? — më pyeti duke tundur kokën si për të trëmbur diçka.

— Se të njoh mirë — i thashë.

— Më njeh mirë? Pse, ty do të të jap hesap unë? —
dhe më shtyu.

— Nuk e besoja se do të bëheshe e tillë! — i thashë
dhe ika.

Ajo u ngrit dhe më zuri nga shpatullat.

— Kush je ti që më flet kështu?

I kujtova njohjen tonë. Ajo ndënji një copë herë pa
folur, i mbylli syt si për të kundruar diçka të largët dhe
foli me habi:

— Si, ti qenke?! Sa shumë ke ndryshuar! Për zotin
s'ë njoha fare!..

— Edhe ti ke ndryshuar.

Më mori nga dora dhe më shpuri në tavolinë. Kapi
nja pesë a gjashtë kaushë kikirik dhe i tha atij burrit që
kishte një hundë të madhe:

— Paguaj paratë.

Ai futi dorën në xhep pa qejf, kurse ajo më tha: —
Po të düash, eja nesër në shtëpinë time, unë banoj, ja,
tek kjo rrugica, pas kafenesë. Numurin e shtëpisë e kam
12. A do të vish?

— Po, do të vij.

— Kur?

— Kur të më dalë siraja.

— Mirë, po eja, kam qejf të bisedoj me ty.

Edhe unë kisha qejf të bisedoj me të. Kështu, një
mbrëmje, ndërsa po shkoja në kafe «Zorra», u ndala tek
ajo. E gjeta në prak të derës, duke pirë duhan. Pak më
tutje, një jevg i dejur po i binte shapripupri një violi-
ne, një jevgë këndonte me gisht ndër veshët dhe prapa
sajë rrin është fëmijë lakuriq...

Kur më pa ajo, më shpuri në një dhomë të vjetër,
po që kundërmonte nga profumi.

— Sa shumë që ke ndryshuar! — më tha përsëri ajo. Je
bërë burrë sërbes, goxha djalë!

— Po ti ku e ke burrin? — e pyeta.

— Ç'burrë? — Ato sytë e saj larushë ishin bërë të
ashpër dhe të çponin si gozhdë.

— Keni qenë e martuar, aherë, apo jo?

— Sa herë jam martuar unë gjer ahore! — tha si pa

të keq se profesioni i ndyrë e kish bërë të patur pëshme.
— Mës e ke fjalën për burrin e parë? aha! vërtet ka që-në i mirë, kam pasur të bëj me shumë të tjerë pas tij, po si ay, nuk gjeta njeri.

Një pikë lot, iu shkëput nga syu i djathtë. Loti u rrokullis nëpër faqen e saj të zbehtë dhe i qëndroi në cep të buzëve. Ajo e lepiu lotin me gjuhë dhe tha me një trishtim të fshehtë:

— Atë e burgosën, kurse mua më rrëmbyen... Më shpunë në Krujë, tek Bazi i Canit. Ish qejfli femnash të bukura. Më mbajti si mantenutë afro një muaj. Pastaj më la të lirë. E ku të shkoja? Burri ish në burg; Bazi më kish thënë se atë nuk do ta shihja më kurrë. I mjeri ai zhduk për shkakun tim!...

Kujtimet e ndezën, fytyra e saj mori ngjyrën e transdafiltë, muskulat e faqës zunë t'i dridhen:

— Ai, Bazi i Canit, ish njeri shumë i keq. Goja i qel-bej sikur t'i kish ngordhur ndonjë qen në bark, por unë them se atij ka filluar t'i qelbet shpirti. Kish tri a katër gra që i mbante si mantenuta. Sa keq që sillej me ne!... Për grua me kunorë kishte ish gruan e Haxhi Qamilit. A e di ç'ka qenë Haxhi Qamili? Haxhi Qamili i kish vrarë vllaun Bazit të Canit... A e pi rakinë?

— Jo.

— Po të duash, po ta mbush një gotë.

— Jo, jo, nuk pi...

Ajo u ngrit dhe vajti e mbushi një gotë për vete. U ul fmbi krevat dhe tha, duke lëshuar një pshëritimë të thallë:

— Tani rroj këtu me një plakë që më ndihmon. Ca kohë ndenja në Durrës, po u mërzita shumë. Ç'të bësh? Po tani jam mësuar, në fillim e pata shumë vështirë. Po ai kapteri me fytyrë si kalë ç'bën tani?

— S'e kam parë më.

— Po Veliu?

— Është bërë tetar.

— Ashtu? — syt e saj sikur shkreptinë — Ai katil bashkë me kapterin u bënë shkaktarë që ma prishën jetën!...

U shtri mbi krevat, nisi te kendojë, po shpejt u ngrit, sikur te zgjohej nga një endër e frikëshme dhe më bërtiti:

— Po ti çdo këtu?! Çou tani, mbushu! Unë rroj ashtu siç më pëlqen!...

U tremba dhe kur dola në oborr, plaka që e ndihte më tha: — Mos u tremb prej saj, është një sëmundje pa rrëzak që i është çpifur dy vjet më parë.

— Aherë kur e rrëmbyen?

— Si duket, po. Ajo nuk e mban mend mirë, por kur i flet për të shkuarën e humbet fare dhe shan sa mundet. Shyqyr që më ka mua pranë, se ndryshe do ta rrashnir brënda, në burg, sepse ajo s'di çfarë flet. Po ti mos kij merak, shko brënda, është e lezetëshme dhe e pastërt....

Ajo shtrigë më kish marrë për myshteri. Ika me zemër te çoptuar. Tek porta, u ndesha me dy djem të rinj thuajse te një moshe me mua. Aherë, m'u kujtuan fjalët e Polkës:

— Vendin e ka mbytur kopukllëku dhe fukaralleku. Zoti e di se ku do te dalim!...

XIX.

Një shitës më lajmëroi te shkoja shpejt në bulevard, në kafe «London», sepse aty ishte një i dejur që blente tërë kanistrën më kikirik. Nxitova si era.

Ish pranverë, po nata ish e ngrohtë, si në gusht.

I dejuri ish ulur jashtë në një karike kashte. Nja 10 a 15 fëmijë e kishin rrëthuar dhe po e vështronin me çudi e simpati. Dy kamarijerë i shkonin vazhdimisht dhe i luteshir:

— Ju lutem, zotni, kaloi ora.

— Edhe pak, thosh ai, pa i shikuar fare.

Pastaj ngrinte gishtin tregues, dhe bërtiste:

— Sillni dy gota birrë.

Unë dhe Nusha i dolëm përpëra me kanistrat e kikirikëve.

— Sa kaushë ke, piçiruk? — më pyeti.

— Njëzet e dy, zotni.

I mori të gjithë me të dy duart dhe i hodhi në tavolinë. Ish i veshur me rroba të zeza, të zhubravitura. E futi dorën në xhepin e jekut dhe më dha një shumë të madhe — rrëth dy franga ari. Pastaj përlau kaushët e Nushës. Nusha qëndronte përparrë tij, si lypëse.

— Si të quajnë? — e pyeti i dejuri.

— Nushë!

— Je djal apo vajzë?

Nusha s'fiste.

— Po folë, moj e mjerë! Ah, të mjerët ju fëmijë, sa mirë që s'dini gjë! Por ja, tek po ju lajmëroj me keq-ardhje se sonte në ora 12, do të bëhet kiameti.

Ne qeshëm.

— Se besoni? — pyeti i dejuri dhe nxori një gazetë:

— A dini të lexoni, ja tek shkruajnë këtu në gazetë... Kamarieri tha me dëshpërim:

— Këto dreq gazeta turbulluan botën!

I dejuri fiste si përgart:

— Bëni qejf sonte, prishni ç'kini, se do të përmbyset bota! Lamtumirë ju njerëzit e mi, ti nënë që je larg meje sonte, nem uratën dhe ti o grua, më fal për zemërimet e kota që të kam shkaktuar!

Piu dy gotat e birrës njera pas tjetrës, pështyu padjtë se ku e hidhte, dhe thëriste:

— Edhe dy gota birrë.

Ne shihnim se si ata dy kamarierët e ripnin atë të mjerë që kish rënë viktimë e lajmeve që përhapnin gazetat aherë. I merrnin shumë para për një gotë birrë, dhe këtë ja thamë të dejurit, po ai qeshi dhe tha:

— S'ka gjë, le të më vjedhin qelbanikët, të paktën të më shërbëjnë. Paratë nuk i ha as qeni, doni para ju? merrni — dhe hidhte në erë ç'gjente nëpër xhepet.

I dejuri posa e kish kënduar gazetën, ish tronditur shumë, kish shitur të gjitha gjërat e tij me vlerë dhe tanë ja, tek i shpenzonte këtu, duke u falur kamarjerëve dhe shitësve. Shumë nga ne, i merrnim përsëri kikirikët që i kishim shitur njëherë, i vendosnim përsëri nëpër

kanistra dhe bënim sikur vinim për herë të parë. I de-juri i blente pa fjalë.

— A nuk është turp që e vidhni kështu? — iu drejtua kamarierëve një djalosh i ri, me trup të lidhur mirë.

Njeri nga kamarierët, një shkurtabiq dhe tullac, tha i prekur:

— Ty s'të duhet se ç'bëjnë të tjerët, vështro veten, djalë i mbarë...

— Veten dij ta vështroj dhe ty të them se nuk është mirë të vidhni një njeri të dejur...

I dejuri thosh duke qeshur me lot ndër sy:

— Të dy palët s'janë në vete. Më qajnë hallin mua, kurse atyre vetë s'u ka mbetur të jetojnë as ethe një orë...

Përmes bulevardit, u duk feneri i një pajtoni. Me që isha i kënaqur nga fitimi i asaj nate, vravova dhe iu ngjita pas. Pajtoni ish i ri, dhe këtë e kuptoja nga sus-tat e buta dhe nga mushamaja e freskët. Dëgjoj zërin e karrocjerit që këndon avash një këngë dashurije, pas-taj kuvendimin e tij me pasagjerin. Pasagjeri, me sa du-ket, ish i dejur, sepse me zor përgjegjej. Kur ky heshte, karrocieri ja fillonte ngadalë këngës:

Gjith ç'ta, bënka, lal, ta bënka mendje,
Do të shkoj e t'mbytem, lal'o, kah Arzenja,
Ububu mor shokë,
Sharroj lala në gjoltore.

Unë qëndroj prapa, mbi hekurin që lidh balestrat. Rreth e qark; është qetësi e thellë; qyteti po flen. Sa mi-rë që edhe unë po shkoj në shtëpi! Jam fare i këputur, sytë më mbyllen dhe shpesh herë lëviz me llahtar nga që më duket sikur po rrëxohem...

XX:

Një ditë vajta në familjen e një pasaniku ku punon-te nëna. Kjo familje banonte në rrugën e Kavajës. Ki-shin një goxha pallat, me dritare të mëdha, me perde të mëdha, të mëndafshta.

Unë qëndronja tek porta se më vinte turp të hyja brënda. Zonja e shtëpisë, një grua me pamje të rëndë, me sy të lodhur dhe me gushë pak të renë, thirri si e trëmbur nga poltroni ku ish ulur:

— Nermin, shiko tek porta qështë ai djali aty!

Doli një vajzë e re, shumë delikate, me gjoksin gjysëm të hapur.

— Çfarë kérkon? — më pyeti duke më shikuar me dyshim dhe me habi

— Është djali im, — i tha nëna me një zë të dobët sikur i kérkonte ndjesë.

— Ashtu?! — pyeti vajza bukuroshe dhe ato syt e saj si të sëmës, u zmadhuan nga gëzimi: — ejani brënda, ejani, mos keni frikë. — Zëri i saj i urt na gëzoi.

— Pa shiko, mama, ç'djalë të lezetshëm që paska! — i tha ajo dhe më vinte rrrotull, sikur do të më blente.

— Veçanërisht sytë i paska të bukur! — foli e ema duke i zbritur shkallët e ballkonit me një hap të rëndë dhe krenar.

— Sy të zgjuar! — shtoi Nermini. — Po dhe hundën e paska të mrekullueshme, apo jo, mama? Shikoje, — dhe ma vuri dorën nën mjekër, ma ngriti kokën pak përpjetë, — fytyra e këtij djali është një harmoni e tere. Nuku, mama?

E ema pohoi me kokë. Pastaj më pyeti:

— A vete në shkollë?

— Jo.

— Përse?

— E lashë kur më vdiq babaj.

— I shkreti! — murmuriti Nermini dhe më mbuloi me atë vështrimin e saj të singertë.

— S'ka gjë, — tha e ema, — fundi i fundit shkolla është për njerëz që kanë, q'i duhet shkolla një fukaraj?!

Nëna më shikonte pa lëvizur nga vëndi. M'u duk se ajo krenohej që kish rritur një djal të mirë.

Nermini se çfarë i tha të iemës në vesh. E jëma më shikoi edhe njëherë nga këmbët gier tek koka, tamam ashtu sic më kish vështruar për herë të parë ai ustai pastiqier, dhe më pyeti: c'punë bën ti tanë?

— Shes natën.

— Uuu! — u shkund, si zog pule Nermini.

— Dëgjo! — iu drejtua zonja nënës sime, — unë dë shëroj që djalin tuaj ta vendos tek një familje pasanike, një familje shumë e mirë dhe e ndershme.

Nëna shtangu nga këto fjalë të mira, dhe tha:

— Bëni sevap për Zotin!

Nermini m'u afrua dhe më këshilloi:

— Aty ti do të kesh mundësi të ushqehesh **mirë**, ndryshe ti do të bëhesh tuburkuloz se je i gjatë dhe i hollë.

— Dokrra! — thashë me vete.

Pastaj më pyeti:

— A ke ngrën bukë?

— Kam ngrënë — i thashë.

— Pse gënjen? — foli ajo me zë të lartë, — unë të kuptoj që ti s'ke ngrënë; buzët e tua janë të thara dhe të bardha.

Veshtrova buzët e saj. I kish të kuqe si shegë, dhe të freskëta si gjeth trandafili.

— Jo, kam ngrënë, — përsërita unë si me turp.

Ajo s'priti dhe vrapi drejt në kuzhinë. Më solli një pjatë me reçel dhe një copë bukë të bardhë. Buzët m'u mbushën me lëng. Stomaku filloj të më kërcasë. Po me gjithkëtë, ngurova ta marr reçelin. Më dukej se po bëhesha një lypës i keq nga ata që e shtrijnë dorën kudo që të ndodhen. Jo, unë asnijëherë nuk kisha lypur!

— Mos ma kthe dorën, se më kthehet burri pastaj! — foli Nermini me një zë të ëmbël dhe të ngrohtë.

Veshtrova nënën. Ajo nuk thosh as po, as jo.

— Merre, pra! — përsëriti Nermini dhe ma afroi pjetën e reçelit.

Aherë unë mora ngadalë pak reçel dhe e hëngra me turp të madh. Nuk di sepse ajo vajzë më turbullonte aqë shumë! Ajo ish e re shumë shumë shtatëmbëdhjet vjeçë. Po dukei tamam si një grua. Gjitetë i kish të plota dhe me maië, sytë të kaltër dhe të butë, qafën të bardhë dhe të shkathëtë si rosë e majme. Ish te thjeshtë, dhe shumë e dashur. Unë kisha njojur shumë fëmijë të tjerë,

djem dhe vajza pasanikësh, po ata ishin kryelartë, egoistë dhe grindavecë. Shpesh ne ziheshim me ta, i rrinjim dhe ua bënë copë-copë rrobat e tyre të reja. kurse Nermini ndryshonte.

Kur erdhi i jati i Neminit, — ky ish një burrë me fytyrë të verdhë — më hodhi një vështrim përvuzës. Me të ish i biri, Skënderi, pér të cilin nëna më kish folur shumë. Ky apo më pa, vrapi tek unë dhe më bërtiti:

— Po ti ç'do këtu ! . . .

Unë e shikova vëngër.

— Me ty flas! — bërtiti ai dhe fytyra iu skuq nga zemërimi.

— Skënder! — thirri Nermini — éshtë djalë . . .

Ai tundi kokën si njeriu që s'di ç'të bëjë pas një zemërimi të madh. Pastaj i vrëjti vetullat dhe vajti në dhomë. Pas një copë here erdhi përsëri tek unë. Vura re, se mundohej të gjente shkak pér të bërë pyetje me se merresha, sa vjeç isha dhe në isha ndopak i fortë. Po unë ndënjë ftohtë.

Si qëndroi një hop pa folur, më tha duke çfryrë:

— Sot patëm gjimnastikë me profesor Gaqo Gogon. Na ka lodhur shumë — dhe u shtriq.

— A e njeh ti Gaqo Gogon? — më pyeti duke u krekosur.

— Jo! — i thashë — po në të vërtetë unë kisha dëgjuar se atë e donte Lalë Krosi pér dylber.

— Si, s'e njeh? Ai éshtë atleti më i mirë në Shqipëri. Ta shohësh sa mirë që na stërvit! Tani unë jam në gjëndje ta kap kundërshtarë dhe ta hedh në tokë, në dy minuta.

E shikova me qesëndi, jo se ish më i vogël nga unë, po sepse me të parë, më qe dukur leckë, kur i thonë fjalës. Ai e vuri re mospërfilljen time dhe foli me kryelartësi.

— Mos ke qejf ta provosh atë që them? Po s'të hodha si klysh tosku. . .

E pashë edhe njëherë po me atë mospërfillje.

— Ke qejf të provohemi? — vazhdoi ai përsëri.

— Dalim jashtë, po të duash, — i thashë ngadalë.

Po ai, befas, m'u hodh në qafë. Më shtrëngoi shumë

në kokë. Nermini i bërtiti të më lëshonte, po ai vazhdon te të përpiqej të më hidhte në tokë. Dëgjova zërin e së jemës: — Jepi Skënder! — Pastaj buçiti edhe zëri i të jatit: — Edhe pak, Skëndo, e hodhe!

Se si më shkuant sytë dhe pashë nënën time, që më shikonte me dhembje. Aherë e përlava ashtu siç dija: një të ngritur peshë, i futa stërkembë dhe plaf në tokë. Sapo e shtriva prapët, e lëshova. Ai, si një kafshë e egërsuar, m'u hodh përsëri. Iu luta të pushonte dhe kur pashë se ai kish qëllim të më rrëxon, e përlava edhe një herë, po kësaj radhe me një taktilë të re: me dorën e djathtë e kapa në kofshën e majtë; ai u përpoq të më heqë dorën, kurse unë n'atë minutë e zura për qafe. Pastaj s'e pata të vështirë ta hidhja në tokë, si deng leshi.

Nermini më duartrokitti, kurse e éma dhe i ati më shikuant me inat. I biri vinte përsëri rrötull meje për t'u zenë rishtazi.

— Lere, Skënder, ai éshtë më i madh se ti. Sa vjeç je ti? — më pyeti e éma me inat.

— Pesëmbëdhjet i thashë.

— Si éshtë e mundur! — kundërshtoi ajo — Skënderi éshtë gjashtëmbëdhjet dhe ti ta hedhësh me aqë lehtësi? Provojuni edhe njéherë.

— Jo, nuk dua — i thashë.

— Domethënë se s'ta mban, ë? — tha Skënderi duke marrë fletë nga kurajua e prindërve dhe mospranimi im.

— Hë, pra, — tha edhe i ati duke u munduar ta fshehë zemërimin. — Nâ u higshe si cub mirdite!

Sa shumë më prekën fjalët e tij! Në syt e nënës simë unë pashë dëshirën e saj, për ta hedhur në tokë atë las-kuriq mëndjemadh. Bëra dy hapa përpëra. Skënderi më qëlloi me grusht nënnofulla. Ndjeva një turbullim në kokë, u largova një hap dhe i thashë:

— Boks kërkon të bëjmë?

Ai s'më foli, po u hodh drejt meje, si ndonjë kaproll. E prita me një grusht të lehtë dhembëve. U hutua shumë. Po të kisha dashur, e kisha gjakosur në vend, pa fjalë. I dhashë kohë të qetësohej. Më vinte keq dhe turp nga prindërit e tij, megjithëse ata rië urrénin dhe kishin qejf

të më shihnin të shtrirë për tokë. Vetëm Nermini qëndronte asnjanëse.

Nëna ime më thosh të mos i bija fort, po në syt e saj dukej edhe dëshira që unë të fitoja.

Skënderi u hodh edhe njëherë më me furi, po përsëri hëngri një grusht të lehtë nën hundë. Isha i bindur se ai s'mund të më bënte asgjë. Atë nuk e shpëtonin dot as mësimet e Gago Gogos, as kurajua e prindërve. Jeta ime ishte një stërvitje e tërë. Pjesën më të madhe të kohës unë e kisha kaluar me lojra të guximshme, me përleshje të forta të cilat më kishin bërë trim dhe të pamposhtur. Dhe ja, tek më dilte një nga ata djemt e pasanikëve që ne i quanim «sum çokollatë» dhe kërkonte të më mundte! Po të mos ishin aty prindërit e tij, do ta kisha bërë të hante pure nja dhjetë ditë rresht.

Si e pa që me grushte s'bënte dot gjë, filloi të më gjuajë me shqelme, si kalë. Unë u largova, po ai më ndiqte pas me shqelme. Aherë një të zenë për këmbe dhe një të rrëzuar. Bëri si kur u vra në kokë dhe filloi të qajë.

— Hajvan! — më bërtiti i jati dhe u largua duke skërmitur dhëmbët.

Ra një heshtje e një si ftohtësi.

E éma e ngriti Skënderin dhe i tha:

— A e provove se kush është më i fortë?!

— Po ai bën hile kur zihet, mama! — foli Skënderi me një zë të trashur nga gulçimi.

— Po ti pse nuk bën hile? — e pyeti Nermini e cila u përpdq të na pajtente.

Po siç po bisedonim, Skënderi më qëlloi me grusht në fytyrë, me të pabesë. Unë s'lëviza fare. Nga hundët, ndjeva se po më kullonte gjak. Ç'të bëja? Skënderi kish ikur dhe me siguri ish kyçur në dhomë të tij, ose do të ish venë nën mbrojtjen e të jatit. I ati po shikonte i gjithëzuar nga dritarja.

Nëna më dha përparsen e saj për t'u fshirë. Nerminit i erdhi shumë keq, kurse e éma, përsériste gjithënjë:

— Tani u bëtë një me një. Të mos i mbetet hatri asnjërit — dhe për të më zbutur, më premtoi se do të më

fuste në punë, tek ajo familja e mirë duke më thënë se atje do të bëja pallë. Nga kjo dhe shkaqe të tjera, unë durova gjithçka.

XX.

Pas dy ditësh unë, nëna ime dhe nëna e Nerminit, vajtëm tek ajo familja. Nëna e Nerminit hyri brënda në një dhomë, ndërsa ne pritëm në sallon. Salloni është i errët dhe bie erë myk. Nëpër mure janë varur tri korniza: busti i Esat pashë Toptanit, një grua gjysëm lakuriq, që vështronte nga qielli, dhe një natyrë mort. Në përgjithësi salloni të fuste në shpirt një diçka të ftohtë dhe të ngjethur.

— Shiko, — më këshillonte nëna ngadalë, — në qoftë se të marrin në punë, duhet t'i fshish ato marimangat atje. Tregohu i pastër dhe i kujdesëshëm...

U çel dera dhe u dëgjua zëri i nënës së Nerminit:

— Ejani brënda, t'ju njoh... — tha ajo.

Ne hymë njeri pas tjetrit, si të hutuar. Unë isha i tronditur se nuk dija, a do të më mbanin në punë.

Dhoma ku hymë, ishte e madhe dhe me oxhak. Pranë një tryeze ku ishin vënë pa kujdes çorape dhe sende të tjera — dy pjata, një këmishë e një çikirik penjë — rrinte një grua e shëndoshë me flokë të lëshuara dhe me ca sy të mëdhenj dhe gjithmonë të hapur shumë; pranë saj ish një grua tjetër, më e re në moshë, me një vështrim të qetë dhe të matur; buzët i kish të holla, syt' e sajë ishin të qeshur dhe shkëlqenin; tutje, në qosh të murit, pranë një rasti me pasqyrë në mes, që ish vjetëruar nga koha, ish një shtrat. Në atë shtrat dukej koka e vogël e një plaku të së-murë, i cili na shikonte me kureshtje duke mos lëvizur asgjë, as qerpikët e syve të tij si frengji, as edhe një muskul të fytyrës së tij plot rrudha.

Gruaja esmère pyeti nënën t'ime:

— Dëshëroni që djali juaj të punojë tek ne?

— Si urdhëroni. Jemi njerëz hallexhinj.

— Mirë, — vazhdoi ajo, — ne do të përpinqemi që t'i

lejmë kohë për të shitur edhe kikirik natën. Zonja Jalldëz (fiste për të jemën e Nerminit) na i ka thënë të gjitha.

— Ju falemenderit — foli nëna me sy të ulur për dhe.

Ndërsa ajo më e reja tha me një zë të butë dhe gjithë gesëndi:

— Si duket çapkëni e nxirka paranë edhe nga guri, — dhe vura re se sytë e saj të qeshur bridhnin nëpër fytyrën time.

Punën e fillova po atë ditë. Brënda dhjetë minutave, mësova se ajo gruaja dyzetvjeçare quhet Makbule, ndërsa tjera, më e reja, Myriban. Të dyja ishin kunata. U habita shumë që ai plaku ish i shoqi i Makbulës. Myribani kish për burrë një njeri me detyrë të lartë në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare. Këtë unë e mësova në drekë. Ish një burrë shpatullgjérë, me fytyrë ngjyrë tulle, dhe me ca sy të lënduar e plot brengë.

Sapo erdhë më qortoi me zërin e tij të vrazhdë:

— Pse s'i ke hequr ato rrasat që janë grumbulluar tek porta?

— Tani do t'i heq.

Më vështroi me ngërdheshje dhe shtoi:

— Apo mos pandeh se të kemi marrë për djalë të bukur!...

Unë s'bëra zë, megjithëse ma kishte ëndë ta qëllaja me fshesën që kisha në dorë.

Nga penxherja u dëgjua zëri tingëlluës i Makbulës:

— Lerë çdo punë dhe shko e pastro atje ku të tha zoti Tofik.

Vajta dhe, si e pastrova, i thashë Makbulës:

— Pastrimi mbaroi, zonjë.

Ajo ja shkrepi të qeshurit duke tundur gjithë tulet e trupit të saj të majme dhe tha me një zë që i përngjiste të lehurit të një qeni:

— Ty të munagon delikatesa. Ti mund të bëhesh çdo gjë, por jo shërbëtor.

Kur fiste, gjuha e saj lëviste me përtim.

Gjatë ditës, unë pastrova shtëpinë (ajo kish katër dhoma, sallconin dhe oborrin e vogël), ndihmova Makbulen në guzhinë dhe dy herë mora shportën dhe vajta në pazar për të blerë patate dhe qepë.

Gjëja më e mërzitëshme në këtë shtëpi ishte shërbimi që i bëja plakut. Plaku ish-njeri i bezdisëshëm dhe lla-fazan. Vuante nga reumatizma dhe nga zemra, dhe ankohej çdo çast se nuk po gjente shërim. Si lodhej së ankuari, kërkonte ta férkoja me kanfur. Dhe unë e férkoja ngadalë, që nga koka gjer tek këmbët. Shpesh herë për shkak të tij, haja të shara nga Makbulja:

— Zjarri u shua fare dhe ti më rri dhe bën lloqe! . . .

— Më tha ta férkoj. . .

— Ta férkosh kur të kesh mbaruar të gjitha punëtët. Plaka zemërohej me vete dhe ajo mjekra e tij e vogël i dridhej ngadalë. Unë shkoja të kryeja ndonjë punë tjetër, por apo hyja në dhomën e tij, ai më urdhëronte:

— Eja m'i férko një çikë muskulat e këmbëve.

E férkoja nga që nuk isha mësuar të kundërshtoja njeri. Si e ndukja mirë e mirë, ai kthehej prapët dhe kuvëndontë me mua. Më shumë mundohej të më mbushte mendjen që ta kisha mirë me ta, me që e quante veten si kryetar të familjes. Po në të vërtetë asnjeri s'ja varte. Të drejtë prone nuk kish, sepse që kurse ish martuar, pasurinë e kishi vënë në emër të të shoges.

— Ti s'ma njeh forcën mua — më thosh ai duke lëpirë buzët e thara dhe të murme — unë kam qënë prefekt, deputet, kryetar bashkije. Ti mos shih ç'thotë ajo shtriga.

— Cila?

— Gruaja ime. Ajo kërkon të marni hakën me mua për hesape të vjetra.

Sa dëshirë kisha të dija cilat ishin ato hesapet e vjetra! Dhe këtë ma tha vetë ai, nga marazi dhe urrejtja që kish për të shoqen. Një ditë, kur isha duke e fërkuar, filloi të flasë ngadalë, duke përpëlitur syt e tij si të përgjumur:

— Një herë e një kohë, ajo e hidhte pikën e lotit sa një grusht përmua. Aherë unë isha prefekt. Më binin në dorë lloj lloj grash të bukura. Ndodhë që nuk kthehesha në shtëpi një javë, të téré. Makbulja qante dhe thosh se do të bëhej verem nga dashuria. Po unë as që e çaja, kokën për të. I dij mirë lotët e grave unë. Gruaja është

si qeni! Tani qan, tani qesh. Po e gjeti rastin, të tradhëton pa një pa dy...

Hodhi një vështrim të kujdesëshëm nga dera dhe më pyeti me një zë të qartë dhe të pakënaqur:

— A e shikon se si ka filluar të më tradhëtojë ashiqare?

— Jo, nuk shoh gjë.

— Mirë, ke për ta parë më vonë dhe do të bindesh për ato që them unë.

Fytyra e tij e zbetë u bë edhe më e shëmtuar.

Një ditë i lidhi duart tek gjunjët dhe më tha gjithë brengë:

— Më duket se duan të më helmatisin.

— Kush?

— Të gjithë. E shoh se jam berë i lepërt në këtë shtëpi; më duket se atje prapa, në dhomën tjetër, kurdisen plane se si të më qërojnë. Vetëm tek ti e kam shpresën. Dhe mos kujto se nuk ta shpërblej të mirën që do të më bësh. Kam qenë deputet dhe prefekt, pra kam ditur të mejtoj edhe për këtë ditë.

Plaku i përpëliti qerpikët e rrallë të syve të tij dhe tha si i lodhur:

— Kam frikë se zeherin do të ma hedhin në gjellë, si Mustafa Qemalit...

— Jo, nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë!

— Ahere më bëj një të mirë ti, sa për të më hequr merakun.

— Çfarë?

— Që ta provosh vetë gjellën time, përpëra se ta ha unë; si thua?

— Mirë.

Në fytyrën e tij u duk një hije gjëzimi dhe siguriye.

XX.

Në mbrëmje, kur mbaroja të gjitha punët, kërkova lejë për të ikur. Dy javët e para s'më penguan, pastaj filluan të ma ndalojnë një gjë të tillë.

— Sonte s'ke si ikën se na vijnë miq — thosh Makbulja.

Miqtë e tyre zakonisht ishin nëpunës të lartë dhëtregëtarë. Ata vinin pas darke. Makbulja dhe Myribani i prisnin me përzemërsi, u bënин kafe dhe çaj dhe mbushnin dy a tri pjata me mollë. Si rrinin sa pinin kafenë e parë, ja fillonin kumarit. Poker luante edhe Makbulja dhe rrallë edhe Myribani. Disa herë ja shtronin me verë.

Detyra ime ishte t'u hiqja palltot miqve, t'i rregulloja mirë nëpër varset, të shkoja të bleja ndonjë gjë që u nevojitej, dhe kur s'kisha punë, Myribani më ngarkonte t'u fshija këpucët miqve. Si e mbaroja edhe këtë punë, shkoja në dhomën e plakut dhe rrija me te. Zakonisht atë e gjeja të mérzitur. Zemra e tij është e përvëluar nga xhelozia dhe nakari. Syt' i lëshoniin xixa, faqet porsi zhele i dridheshin dhe dëgjohej rënkimi i frymëmarrjes së tij, si mace.

— Po luajnë? — më pyet me gojën e tij të vogël, si gojë zhabe.

— Sapo filluan:

— Pranë kujt është ulur Makbulja? — Në zërin e tij cquhej një notë e theksuar cmiri dhe emocioni.

— Më duket se pranë saj është Ali Neprevishta.

— Ah lavirja, lavirja e pabesë! —

— Pse?

— Me atë ka hedhur merak, kurva!

— Po si është e mundur?

— Shko dhe shikoje edhe mjéherë, bën sikur do të marrësh ndonjë gjë në dhomën e tyre... Oh, e pabesa!...

— I mbylli sytë si me mundim, dhe qëndroi ashtu një kohë të gjatë.

Zjarri në oxhak pothuajse është shuar fare. Pranë oxhakut, është kapardisur daci, një dac i zi dhe i majmë, dhe nga që është ngopur, duket se merr frymë me zor. Syt' e tij shëmbëllejnë quditërisht me ato të plakut. Rrija dhe e vështroja këtë kafshë të urtë dhe befas, ajo, sikur e kupton këtë, e rrrotullon kokën e rrumbullaktë me ato faqet gunga, dhe m'i ngul sytë sikur kërkon të më hidhet në fyt.

Heshtja bëhet e gjatë dhe e mërzitëshme. Dëgjohet tiktaku i sahatit të madh, varur në mur dhe, shpesh, befas, na heq vëmëndjen buçitja e të qeshurave të atyre që luajnë kumar në dhomën tjetër. Ahere plaku sikur zgjohet nga një ëndër e llahtarëshme, dhe pyet duke u përtypur për të njomur gjuhën e tij të tharë:

— Sa vajti ora?

— Dhjetë e gjysëm...

— Dhe ata vazhdojnë të luajnë akoma!

— Po!

Ai dëshpërohet më shumë dhe fytyra i bëhet si gur. Pastaj fillon e flet ngadale, si nëpër gjumë:

— Ali Nepravishta po lan borxhet e vjetra me mua. Dikur e shoqja e tij shtrihej si dash mbi krahët e mij. Unë e doja se ajo ish qejfleshë e madhe...

Më vështron me bisht të syrit në e dëgjoj apo jo, dhe vazhdon me një zë që ulej pak nga pak:

— Kur bëhej fjalë për gradimin e Aliut, ministri më pyeste mua, më që unë isha kryesekretar:

«Si të duket Ali Nepravishta?»

«Besnik ndaj mbretit dhe flamurit, shkëlqesi.»

«Është kumarxhi, zaret i luan edhe në zyrë...»

«Cili nuk është kumarxhi, shkëlqesi?» Ministri s'e zgjaste më se edhe ai vetë ishte kumarxhi. Kështu Aliu gradohej pa fjalë. Ai e dinte se unë e përkrahja, prandaj sa herë që më takonte, më thosh me një gjuhë shumë të ëmbël:

«Zotnia juaj keni kohë që s'na keni urdhëruar më në shtëpi!»

— Kam për të ardhur me rastin më të parë, zoti Ali... Dhe shkoja si në shtëpinë time...

Plaku gogësiu duke rënkuar lehtë dhe tha:

— Kështu ishin punët ahere. Këtë e di edhe ai vetë, edhe Makbulja. E kush nuk e di? !...

Befas hyri Meribani. — Shko dhe blij pesë shishe birrë dreher — tha ajo me nxitim. Pi ja e kish sjellë në qejf. Syt' e saj të qeshur dhe të shkëlqyer, rrrotullo-heshin me përtesë. Ajo shkoi pranë shtratit të plakut dhe e tundi ngadale, si një foshnje:

— Mos u mërzit, o gjysh, kështu e ka jeta...

Ai e vështroi si i trishtuar me bishtin e syrit.

— Apo jo? — e pyeti Myribani me një zë edhe më të kthjelltë.

— Për ty nuk çuditem se je e re, po të dalldisë një grua dyzetvjeçare!...

— Kështu e ka jeta, o gjysh, — përsëriti ajo si e menduar.

Kur u ktheva, plakun e gjeta të mbledhur kruspull. Po përgjonte nga një e çarë e derës që ndante dhomën e tij me atë të miqve.

— Shëéet! — ma bëri me gishtin treguës që e pështeti në majën e hundës. — Këtë vrimë s'e di askush, veç teje dhe meje.

U ula galic. Ai e pështeti lehtë dorën në qafën time dhe ma shtyu kokën drejt të çarës. Nga ajo e çarë e vogël, pashë Myribanin ulur karshi; ish e ndezur nga alkoli dhe dashuria. Pranë saj ish ulur gazetari Andrea Lala, nga e majta tregëtari që e njihja vetëm nga mbiemëri «Qosja». Ky ish nji burrë me trup të mbushur dhe me ca sy si të kukuvajkës. Pak më tutje ish ulur Ali Nepravishta me ato sytë e tij prej hajduti. Makbulen s'e shinim dot me që ajo ish fare këtej. Dukeshin vetëm pulpat e trasha të këmbëve të saj që i ngatërronte me dashje me ca këmbë të tjera burri. Kështu katër pulpa fërkoheshin njera pas tjetrës si ata derrkucat që kruhen pas ndonjë trungu peme.

Këtë nuk ja thashë plakut, me që më dukej një gjë shumë e keqe.

Ata folën për Sara Blloshmin që dukej më e re se e bija, folën për një film të ri që do të vinte nga Franca, pastaj biseda kaloi mbi mbrëmjen e madhe familjare që do të organizonte mbreti me rastin e trembëdhjetë vjetorit të hypjes së tij në fron.

— Duhet ta rregullojmë që të vihemë në listë qysh tanë — thosh Myribani e gjuar në kulm, duke ja ngulur gazetarit atë shikimin e saj të ngrrohtë. Po ai, përcudi nuk e përfillte aspak. Prandaj Myribani ngrihej shpesh dhe vinte në guzhinë për të parë në pasqyrë tua-

letin e saj. Disa herë më pyeste si e shastisur:

— Mos vura shumë pudër?

Dhe i fërkonte faqet e saja të buta me pëllëmbën e duarve, mirte poza të ndryshme përpara pasqyrës dhe unë habitesha se si një grua si ajo, e martuar, dashuronte një burrë tjetër, ashiqare dhe pa frikë...

Kur miqtë ikën, Makbulja vajti në guzhinë dhe q'andej u dëgjua britma e saj:

— Pusho aty, shpirtqen! Mjaft më ma ke nxirë zemrën!

— Ah lavire, lavire! — murmuriste plaku.

— Ç'kérkon më nga unë? — mua më dukej se Makbulja i kish vajtur sipër krevatit dhe po e shtërgonte në fyt. — Ti e bluajte tërë jetën time! Tani kérkon të më zhdukësh edhe ajo thërrimet e fundit të gëzimeve të mia!...

— C'gëzime, moj lavire! Po ti je bërë si pastiqë, anuk e sheh veten?

— Gëzimet që më do shpirti! — bërtiste ajo me një zë të mprehtë dhe të paturpshëm.

Tefiku ish gjysëm i dejur, ajo mjekra e tij e shkurtër i lëvizte si mjekër sqapi, i ra me grusht tavolinës dhe bërtiti me një zë të acaruar.

— Sillni darkën!

Makbulja as që lojti nga vendi, kurse Myribani, ja ktheu e zemëruar.

— Mos u përplas ashtu, se s'ta ka frikën njeri!

— Cila po më flet? — pyeti ai dhe flokët iu varën nëpër gungat e kokës së tij të çrrëgulltë.

Myribani vajti në guzhinë. Tefiku u përpooq ta ndjejkë, po si e lëkund një hòp, si kallami në arë, u ul përsëri dhe bërtiti:

— Sillni darkën, ju them!

Myribani më dha një pjatë me makarona, dy vezë të fërguara dhe komposto mollësh dhe ja vura përpara në tavolinë. Ai më zuri nga krahu:

— E, mor djale, si dukesh? — Zërin e kish të lë dhur, po të ashpër.

— Mirë.

— Ti je njeriu më i lumtur në këtë botë! — Kur merrte frymë, gërmazi i fërshëllente, si qyp. — E, a je njeriu më i lumtur apo jo? !...

— S'e di!

Ai më tundi — Shiko ç'jetë bëjmë ne?!

Ishte e para herë që ky njeri fliste me mua. Gjithmonë më kish vështruar me një farë ngërdheshje: ato syt' e tij të lënduar nguleshin gjithmonë si turjelë në fytyrën time.

— Jetën e kemi në dorë, po s'dijmë ta vërtitim — vazhdonte ai me vështrimin e turbullt të hedhur në një qosh të dhomës.

— Pusho pra! — i bërtiti e shoqja nga guzhina.

Ai e lëvizi kokën me përtesë dhe tha me ato buzët e zvogëluara nga alkoli.

— Se mos po gënjej? E vërteta duhet të dalë në shesh...

— Ç'e vërtetë, mor teveqel! — Myribani i vajti fare pranë.

— E vërteta që ne jetojmë kot, dëgjove? Kë jemi hajdutë, dëgjove? Që jemi!... — dhe i ra me grusht tavolinës.

— Mbylle gojën! — iu lut ajo duke e shikuar me nëshirë fytyrën e tij ngjyrë tulle dhe të vrarë nga pija.

— Pse ta mbyll? E vërteta duhet të dalë në shesh, pa frikë...

— Uh! — rënroi Myribani — e dije se fajin e ka ajo.

— Cila ajo? — ai e vështroi vengër me ato syt' e tij të picërruar nga alkoli.

— Ajo lavirja.

— Jo, jo, Andrea! — ja preu ai me një zë hakmarrës dhe e nxori gishtin e madh të dorës në mes të gishtit tregues dhe gishtit të mesëm.

Myribani u skuq dhe ai filloi të hajë, pa shije. Hëngri dy lugë makarona dhe, i mërzitur, e shtyu pjatën me bryl. Pjata edhe pak që duke rënë në tokë, po unë nxitova dhe e kapa.

— Pse s'e le të bjerë?! — m'u kërcënuai ai.

— Sepse nuk është mirë të thyhet — iu përgjegj e shoqja në vendin tim.

— Kisha qejf ta shoh duke u rrokullisur, se ashtu po rrokulliset edhe jeta jonë!...

Fytyra e pastërt dhe e hijshme e Myribanit mori një pamje që të bënte ta mëshiroje.

I shoqi i ngriti qepallat bashkë me vetullat dhe vuri buzën në gaz me trishtim:

— S'e besoni që po rrukullisemi? Keni për ta parë!...
Këto fjalë i tha me bindje të plotë.

XXI

Një të diel pas dreke bëra një xhiro andej nga Shën Prokopi. Atje po mbahej miting. Rreth 200 vetë ishin grumbulluar dhe prisnin të vinin autoritetet që do të mbanin fjalimin.

Xhandarët kishin venë një rregull të rreptë dhe s'leinin asnjeri të shkelte kufirin e caktuar prej tyre.

— Kush do të flasë, zoti xhandar? — e pyeste për t'u tallur një student.

Xhandari, me ca mustaqe të trasha, e vështron te me përqëmim dhe largohej pa bërë zë, gjith tangérlik.

— E kanë të ndaluar të flasin, kur janë në shërbim — hidhej dhe e skjaronte atë studentin një student tjeter.

— Jo more, po mbajnë sekret për autoritetet.

— Mirë, mirë!

— E po ashtu është, de!

Unë akoma s'po kuptoja përsë bëhej ky meting. Disi kush pyeti dhe një tjeter u përgjegj:

— Inaugurohet «Monumenti i Lirisë».

— Monumenti i lirisë?!

— Ashtu thonë, mor shok.

Njeri nga ata studentët hodhi një fjalë, po me zë të ulët:

— Sot e tutje do ta kemi lirinë me pash.

— Se na e garanton monumenti — plotësoi duke qesur ai studenti tjeter.

Disa shikuan me dyshim; nja dy pleq u larguan fare.

Pas pak, banda e Bashkisë filloi t'i bjerë hymnit të

flamurit. Të gjithë nderojnë zogistshe me dorë në zemër. Në këtë heshtje të plotë, kur të gjithë janë të pushtuar nga solemniteti i çastit, një plak i mbajtur nga një grua plakë, ecën përmes turmës, me dorë të zgjatur për lëmoshë. Njerzit e vështrojnë me bisht të syrit, dhe disave u vjen gazi mu në majë të buzëve.

— Ndihmojeni qorrin, për hatër të zotit! — flet plaku me një zë monoton.

— Shëëët — ja bën një nationalist i flaktë — a nuk sheh se po këndohet hymni i flamurit?!

Plaku e këtheu kokën nga ay që i hoqi vërejtjen, ndenji një copë herë ballë për ballë tij, duke ja mbërrthyer ata sytë e verbër, pastaj nisi përsëri lutjen e zakonshme:

— Ndihmojeni qorrin për hatër të Zotit!..

Një hamall i vogël i tha qorrit:

— Kush ta preu syun o xhaxho?

Plaku i gjorë pshërtiu gjithë brengë, dhe tha plot zemërim:

— Osman qerratai, Aristidhi që rrufjani... .

Plasi një e qeshur e befasishme, në fillim nga ata studentët pastaj edhe nga të tjera; disa vajza kafshoni buzët për të penguar gazin. Një oficer xhandarmarije na gërvishë zemrat me atë vështrimin e tij kërcënonjës, dikush u largua fare nga metingu, kurse plaku bëri përrapa, duke e tërhequr atë plakën që e shoqëronte.

Pastaj si pushoi banda, u dëgjua një zë i hollë, po i fortë.

— Po flet ministri i drejtësisë,

Shumë koka lëvizën, njerëzit përpinqeshin ta shihnin. Ministri ja dha fjalën naltësisë së saj, princeshës Rukije. Kjo, me një kapelë të rrumbullakët në kokë, na i hequr dcrezat, megjithëse ishte shtator dhe nuk bente aspak ftohtë, filloi të lexojë fjalimin:

— «Nji eveniment fort i luminushëm asht rasa që po më jepet sot...»

— Paska qenë shkodranë ai që ja ka përgatitur fjalimin, — i tha ai studenti shokut të tij.

Studenti tjetër pohoi me kokë,

I pari, një çapkën djalë, shtoi duke qeshur ngadalë:

— S'po më rrihet më gjatë, më vjen të vjell, a ikim?

— Si të duash.

— Ikim më mirë, m'u zu fryma.

Ata ikën dhe unë admirova humorin dhe guximin e tyre:

Princesha Rukije mbaroi fjalimin, preu shiritin dhe ahene përpara nesh, u eksposua një hark i lartë, me dy këmbë mermeri. Në majën e këtyre dy këmbëve që bashkoheshin, ishte vendosur një shqiponjë me krah të ndeme gati për fluturim.

— C'është kjo? — pyeti një plak që sigurisht e kish sjellur aty kureshtja e turmës.

Asnjë nuk iu përgjegj plakut të gjorë. Unë isha i bindur se të paktë ishin ata që kishin kuptuar përsë ngrihet ky monument.

Turma po shpërndahej, kur Ministri i drejtësisë, tha se princesha u lutet qytetarëve të shkonin për një vizitë në mauzoleumin e varrit «Nanës mbretneshë». Në fillim u duk se pranuan të gjithë, po ja se pak nga pak, njerzit filluan të pakësohen dhe aty nga fundi, kur do-lëm në udhën e Elbasanit, s'kish ma tepër se 50 a 60 vetë; në mes tyre ecte ai plaku dhe prapa tij nja 7 a 8 liparakë të tjerë, që shpresonin se ndofta atje tek varri do të ndanin sadaka.

Tok me ta vajta edhe unë, se më kandisi shoku im i vjetër, Xhemali.

— A e ke parë varrin e nanës mbretneshë? — më pyeti ai udhës.

— Vetëm nga jashtë.

— Po ti s'merrke erë nga kjo botë, o t'u mbylltë! — më fliste ai me dialektin korçarçe. — Ta shohësh nga mbrënda, pastaj të vdesësh. Thonë se janë harxhuar më tepër se 5 miljon franga ari. Natën, varri ndriçohet benda nga pllaka që shndrisin vetveti; thonë se këto pllaka janë punuar apostafat në Australi. Pastaj thonë se mbrenda në varr mbreti ka vendosur një arkë florinj; të jetë e vërtetë, thua?

— Po mbret është ai, gjithçka mund të bëjë.

— Oh, sikur tē kesh mundësi e tē bëhesh mizë, një t'u futur brënda, një tē celur varrin dhe një tē mbushur xhepet me florinj!

Shoku im fliste me aq pasion, sa që më dukej sikur vërtet po bëhej mizë. Sytë e tij larushë, shkëlqenin dhe kjo, nga që ai éndronte gjëra tē mira që ta zbusin zemrën.

Kur vajtém tek varri, oficerët e trupit tē rojës nuk na lejuan tē hynim brënda.

— Dhe ne pér inat, do t'u vjedhim rrushtë. — më tha Xhemali në vesh.

— Pse, ka rrush këtu? — pyeta unë duke shikuar selvitë dhe pemët që rrrethonin kopështin e varrit.

— Megjithë mend që ti s'ditke asgjë, ore! Po ti sikur na arthke nga Amerika, o t'u mylltë!

— Dëgjo, Xhemal, i thashë unë, — po tē na zënë do tē na i nxjerrin pantallonat nga qafa.

— Ehu! — më kundërshtoi ai duke nxjerrë gjuhën jashtë, — ata zagarë, ne lëpyri. Po duhet ta dish, ama, se je duke ngrënë rrush mbreti. Cili nga shokët tanë ka ngrenë rrush tē tillë?

— Mirë — i thashë — hajde tē futemi.

— Dale, dale, — foli më kapadai Xhemali — ka puna punë, duhet tē presim gjersa ajo roja atje, a e sheh? ..

Një kokë xhandari u duk atje në fund tē kopshtit midis dy pemëve.

— Po, e shoh.

— Ja ai xhandari bën roje. Ai i bie rrotull kopështit. Kur tē vijë këtu afér nesh, ne zbresim fshehurazi dhe futemi nga ajo ferra aty. Tek ajo ferra unë prej kohësh kam hapur vrimë tē madhe nga e cila mund tē kalojmë pa pengesë.

Dukej qartë se puna ish në terezi. Kisha tē bëja me një njeri që e kish rrahur këtë udhë edhe herë tē tjera.

Pritëm nja dhjetë minuta, deri sa ai xhandari erdhë aty ku tha Xhemali. Pastaj, ai e unë, barkazi, si zha-pij, u futëm tek ajo ferra; ecëm përsëri barkazi dhe ja, dolëm në kopsht. Ndjejtëm aromën e një vendi që nuk

ish shkelur nga këmba e njeriut dhe një frikë na push-toi të dyve. Këtë unë e dalloja sepse edhe Xhemali, megjithse përpiquej të tregohej trim, prap se prapë ndalej befas dhe mbante vesh: kur mbante vesh, merrte frymë shpejt.

Ecëm sa ecëm barkazi, kaluam nja dy a tre selvij, pastaj mbritëm tek një qarr me trup të trashë. Ngritëm kokat dhe... ç'të shihje! Një rrush i verdhë, rrush tajke, na e bënte me sy.

— A po hypën, a të hypi unë? — i thashë Xhemalit ngadalë.

Ai m'u përgjigj me shenjë, se do të hypte vetë.

— Mirë pra, do të më hedhësh edhë mua! — i thashë gjithënë me zë të ulët.

— Po, po, ma bëri, ai me kokë.

— Mirë.

Pështyu dy pëllëmbët e duarve, dhe një të ngjitur bëri si shqarth.

Unë u shtriva prapë dhe vështroja Xhemalin kur këpuste bistakë rrushi. Sa dëshirë kisha të isha edhe unë atje sipër!

Xhemali filloi të mbushë gjitë. Prit të më hidhte edhe mua, po ai as që u kujtua fare. Doja t'i thoja se ajo që po bënte ai ishte poshtërsi, po kisha frikë se mos më dëgjonin. Nja dy herë fishkullova si beng, po ku dëgjonte ai!

— Kështu e patëm fjalën? — e pyeta kur zbriti.

Ai më bëri shenjë me kokë që deshte të thosh:

— Atje lart ke rrush sa të duash!

Ahere një të hypur bëra dhe ç'të hypur se! U ngjita në majë, atje ku rrushi ish dyllë i verdhë.

Po mbushja edhe unë gjift me bistakë rrushi, kur ja, se si pashë një xhandar që po vinte fshehurazi drejt nesh. Vështrova poshtë. Xhemali rregullonte rrushin: nxirrte një bistak nga gjiu, e shikonte me qejf, pastaj e peshonte me dorë dhe e fuste përsëri në gji.

Xhandari afrohej gjithnjë dhe e kuptova se ai po rrekej të kapte Xhemalin. Ç'të bëja? Ta lajmëroja Xhemalin, aherë gjithë inati i xhandarëve do të derdhej mbi

mua. Pastaj isha i bindur se Xhemali do ta shihte xhandarin dhe do të ikte, po ja se ai ishte aq i hutuar pas asaj pasuriye të madhe që kish venë, sa që s'e dëgjoi fare xhandarin.

Kur xhandari e përlau për veshësh, tamam si ljeprur, unë u dridha i téri. Xhemali nuk qau, as bërtiti, vetém se u pérpoq ta bindë xhandarin se ish hera e parë që vidhite rrush në kopështin e varrit «Nëna mbretneshë».

— Ah, kopil i kopilit! — çfrynte me zemërim xhandari, — hera e parë ë? Po ti na i vole téré rrushtë, he bir kurve!

Xhandari shikoi lart; unë nuk lëviza fare, rrakesha të mos merria as frymë... Kur era tundte gjethet e hardhisë, më vinte t'i këpusja dhe t'i zhgaravisja ato gjethë të mallkuara që po më zbulonin.

— Po ti?! — bërtiti xhandari, duke ardhur rrotull qarrit, — kujton se s'të shoh, more bir kurve?! Zbrit se do të ta marr shpirtin!

Unë vazhdova të hesht. Përpinqesha t'i mbushja mën-djen vetes se xhandari s'më kish parë, po thërriste ashtu kot, sa për të hequr dyshimet.

— Mor, po a ke ndërmënd të zbresësh apo të bres unë me anën e revoles! — bërtiti xhandari me tèrbim.

Kish marrë fund çdo gjë.
— Po zbres! — i thashë me një zë të mekur dhe të dëshpëruar.

— Hajt, pra, shpejt!

— Ja.

Çdo hap që bëja poshtë, më dukej se më shpinte drejt një zjarri të madh. Filluan të më dalin djersë dhe trupi të më dridhej. Të kisha mundësi të shpëtoja. Po qysh? E vrisja mendjen gjithësesi, po s'gjeja rrugëdalje. Xhemali më shikonte si ndonjë lypës i keq.

Frika se xhandarët me siguri do të më ngordhnin me dru, më detyronte t'i jepja kurajo vetes për të shpëtuar.

— Duhet të mos dorëzohem në asnijë mënryrë! — thashë me vete — keq se keq, le të bëhet më keq!

Zbrita fare afër tokës. Xhandari ish vetém në këmishë.

pa armë dhe e têrhiqte rrrotull Xhemalin sa andej këtej dhe mua më thosh duke më vështruar me ata syt e tij tê ndezur nga têrbimi:

— Sa më shumë tê vonohesh, aq më keq për ty!

— A do tê më rrahësh? — e pyeta

Xhandari skërmite dhëmbët. Aherë një tê hedhur bëra në tokë; nja një sekondë mbeta aty si pa mend, po shpejt u ngrita dhe t'ua dhashë këmbëve nëpër zabelin e vogël! Aq shumë rendja, sa thoja se thembra më takonte tek qafa.

Prapa shpinës, dëgjoja ca hapa tê rënda dhe një frymë si prej kali tê lodhur. Aherë një fuqi e çuditëshme më bëri gati tê fluturoja, ferrat dhe hendeqet i kapërceja me aq lehtësi, a thua se kisha susta tek këmbët. S'guxoja ta këtheja kokën pas për tê parë sa larg e kisha lënë xhandarin, nga frika se mos humbisja një hap dhe shpejtësinë. Duke vrapuar, befas, nga e majta, pashë kokën e Xhemalit që herë dilte qartë, herë mbulohej nëpër dushqet. Pra kish shpëtuar edhe Xhemali! O Zot! Sa frikë e madhe! Xhemali ma kish kaluar, ai kish qënë më i shpejtë se unë, dhe veç kësaj, xhandari më ndiqte vetëm mua, sepse inatin e kish tek unë...

Vrapova ashtu pa pikë fryme dhe nuk mbaj mënd sa kohë zgjati dhe nuk dij qysh isha futur në një shtëpi fshatari dhe një grua shpirtmirë më shpëtoi duke më fshehur pas magjes së bukës.

XXII

Po fillonte viti 1939. Isha i zveshur dhe pa punë. Jetë më qe bërë derr. S'kisha me se tê merresha dhe nga kjo bridhja lirisht qosh më qosh, nga «Shallvarja» në «namazgja», nga «namazgjaja», te kopështi i «Duhijes». Në këto vënde luhej bixhoz. Shumica e atyre që luanin ishin tê rinj; kish edhe pleq, bile edhe xhandarë. Xhandarët që donin tê luanin, e hiqnin kapelën qysh larg, për tê treguar se ata e quanin veten civila. Po, po,

shpesh herë, kur humbisnin paratë, nxirnin nagandat përpara dhe bërtisnin duke zgurdulluar sytë:

— O na jepni ç'kemi lenë, o s'ju bën zoti derman, për flamur:

Të rintjtë dashje pa dashje, për t'i shpëtuar sherrit, detyroheshin t'u kthenin paratë. Xhandarët largoheshin, dhe po t'i ndiqje pas, i shihje që shkonin në një vënd tjetër, për të lojtur përsëri.

Të rintjtë e vazhdonin bixhozin gjer sa errej. Kishte raste kur çonin dhe blinin qiri dhe kështu loja shtyhej gjer vonë. Pastaj shpërndaheshin nëpër shtëpitë e tyre. Ata që kishin humbur, s'u jepej të shkonin në shtëpi, po sorollateshin nëpër pazar, futeshin nëpër kafenera dhe të mjerët ata, binin viktima të lehta për çdo ligësi dhe poshtërsi. Ja kështu e fillonin jetën e tyre sa e sa të rind dhe pas disa vjetësh, i shihje vagabondë me patentë, hajdutë të rrezikshëm dhe të degjeneruar...

Po bridhja pa punë, duke menduar me vete se si do ta kaloja këtë dimër të egër që po afronte, ose, siç e quanin dimërin tregtarët, «zabitin e fukarasë», kur befas, ballë për ballë meje, pashë ustanë tim të parë, pastiqierin dinak. Ekte kokëulur, si i shastitur, me duar në xhepe, duke çfryrë hundët nga që i kish renë gripi. S'më pa, po unë i fola:

— Po ku je, more kapedan! — tha me habi dhe më përqafroi. — Qënke bërë më i gjatë se unë për besë...

Syt' e tij i binin rrotull fytyrës sime.

E pyeta si jetonte, me se merrej, si ja shpinte.

— Unë kam dy muaj që u lirova. A e di se kam qënë në burg?

— Po.

— Ç'të bësh, disa herë njeriu s'e ka në dorë rrotën e fatit të tij. Nejse, unë s'jam pishman për asgjë që ndodh. Ajo që i ndodh njeriut, ka qënë shkruar që të ndodhë. Ç'të bësh, more kapedan! Tani shpresoj të hap ndonjë kafene të vogël ose të ikij fare këtej, se me sa duket na e la shëndenë ky vënd i qelbur.

— Ku do të shkosh?

— Nga sytë këmbët, prapa lekut. Për mua një lloj

është, Shqipëria, Bullgaria, Turqia, ku lot leku, atje më ke mua.

Heshti një hop dhe unë pata kohë ta vështroj mirë: Sytë i ishin futur thellë, fytyra i ish mprehur dhe shëmtuar.

— Po familjen këtu e ke?

— Oh, ç'më pyet për familjen! Më duket se kam një mal në kurriz.

I tha këto fjalë duke e zvogëluar gojën e tij si gojë zhabe.

— Hajde, po vje, të hedhim nga një kupë? — më tha duke krojtur kokën.

I kundërshtova, po ai m'a priti:

— Ehu, sa ka jeta! Mos pandeh ti, se do të dalësh pa u largur nga ajo? !...

Më futi krahun sikur të më kishte shok dhe u përpotoj të më marrë me vehte. Si e pa që s'qe e mundur, e zvogëloj atë syrin e tij të majtë dhe iku me duar në xhep, duke u kollitur dhe duke belbëzuar diçka me vete...

Mua m'u kujtua Polka, fjalët e tij mbi jetën, mbi njerzit dhe dallaveret, pastaj ai studenti që kish humbur fillin e jetës, dhe atje, në qosh, më dukej se përgjonte xhandari Veli, me ato sytë e tij prej qeni, duke u përpjekur të kapë autorët e letrave që shanin ministrat, pastaj se si më shkoi mendja tek ajo gruaja që xhandarët e detyruan të bëhej kurvë, mu kujtuan të papunët që prisnin orë të tëra se mos gjenin punë, Jusufi, dhoma e tij e vogël, biseda e trishtueshme që patëm përmbrëtin dhe më në fund, fytyra e ngërdheshur e Makbulles dhe fjalët e Tefikut: po rrokulliset jeta jonë! ..

Ustaj e ktheu kokën nga unë dhe diç murmuriti.

— Ç'thoshte?

Sigurisht shante jetën!....

Fund i pjesës së parë